

MARTIN FIRMANO

Kardinali shqiptar, organizatori i kryengritjes më të madhe për çlirimin e Arbërisë (1493-1499)



Nga Prof. Dr. Irakli Koçollari

JULIAN BARNES FITON ÇMIMIN PRINCESHA E ASTURIAS

(fq. 11)

SHËNIME MBI LIBRAT

Letërsia si matematikë:
një libër ushtrimesh për
intelektin e njeriut

Nga Minella Aleks

(fq. 8)

A shtu si matematika, edhe letërsia kërkon abstraksion. Një ekuacion matematikor nuk përshkruan një objekt konkret, por një marrëdhënie universale. Po kështu, një personazh letrar nuk është vetëm një individ i veçantë, por një model përmes të cilit shqyrtohen sjellje, konflikte dhe ide që tejkalojnë kufijtë e një historie të vetme.

Romantizmi shqiptar në
studimet e Rexhep Qosjes

Nga Ymer Çiraku

(fq. 10)

Studiuesi Rexhep Qosja ka arritur që ta interpretojë nga shumë rrafshet letërsinë shqipe: në sinkroni dhe në diakroni të saj, në zhanret dhe profilet e spikatura krijuese, duke dëshmuar një zotërim si rrallë kush tjetër.

Mbi romanin *Droja* të Andreas Dushit

ME DROJËN PRANË

Nga Rubensa Ndreca

(fq. 13)

Ajo që më bëri më shumë përshtypje nuk ishte vetëm historia që tregohet, por mënyra si vështrohet bota. Më dukej sikur po hyja në mendjen e një fëmije që përpiqet t'u japë kuptim gjërave që janë më të mëdha se ai: vdekjes, Zotit, ndarjeve, mungesës, padrejtësisë.

Mbi romanin "Gora pa zogj", pjesë e trilogjisë "Atje ku dielli lind dy herë" të shkrimtarit Namik Dokle.

Frika dhe vdekja,
simbol dhe metaforë


Nga Reshat Fazli

(fq. 5)

Fol me shpirtrat
e të parëve të tu

Nga Fatbardh Amursi

(fq. 22)



Ekspozita "Ikonat e Shqipërisë – Thesaret e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës" në Muzeun e Arteve të Bukura, Chambéry

MAGJIA E ARTIT IKONOGRAFIK SHQIPTAR NË FRANCË

Nga Ylli Drishti

Pikërisht në këtë hapësirë prestigjioze, ikonat shqiptare vendosen në dialog me traditat e mëdha artistike të Europës, duke dëshmuar vlerat universale të trashëgimisë sonë kulturore.

(fq. 6)

PANAIRI I LIBRIT NË PRISHTINË edhe nesër. Ju mirëpresim.

DHIMITËR POJANAKU boton
në italisht "Zaret e fundit"

Nga Irma Kurti


(fq. 19)

90-vjetori i vdekjes së Maksim Gorkit

KTHIMI NË SORRENTO:

Mbesa e Maksim Gorkit
mbi Stalinin, gjyshin e saj
dhe dashurinë

(fq. 20)



BIBLIOTEKË

Ag Apolloni

(fq. 14)

Vetëm vdekja nuk gënjen

Jani Malo

(fq. 15)

Lakuriq

Orin Maxhari

(fq. 16)

Të paftuarit

Roland Gjoza

(fq. 23)

Ana Dolce & Gabbana

Arben Mexsi

(fq. 18)

Karikatura e së shtunës


Përkthimi i ekzilit: piktura
murale dhe letërsia, Kosova në
ngjyrat e kujtesës arbëreshe në
Pallagorio të Kalabrisë
Nga Federica De Bastiani

(fq. 12)

Libri shqip në SHBA
& KANADA

Dërgesa të shpejta
dhe të sigurta

www.albibris.al



Qëndresa e madhe e popullit shqiptar kundër invazionit Osman, nën udhëheqjen e Heroin Kombëtar, Gjergj Kastriotit - Skënderbeut la gjurmë të thella jo vetëm në kancelaritë europiane, të cilat përjetonin aso kohe me ankth fushatat e përgjakshme osmane që avanconin drejt zëmrës së kontinentit, por për më tepër edhe në vetë ndërgjegjen e popullsisë shqiptare, ballkanase dhe më gjerë. Të frymëzuar, të kurajuar dhe të bindur në fuqinë e qëndresës së tyre, shqiptarët vazhduan edhe mbas pushtimit Osman luftërat dhe përpjekjet e tyre për çlirim prej zgjedhës osmane.

Një nder to, ndoshta më sinjifikativja është përpjekja për një kryengritje të madhe, e mbështetur në mënyrë të fshehtë edhe prej mbretërive europiane, që zë fill në vitet 1493.

Ishte Philippe de Comines, këshilltari i Mbretit të Francës, i cili në librin e tij "Kujtime...", të botuar në vitin 1539 ekspozoi për herë të parë një numër dëshmish dhe dokumentesh për një Kardinal shqiptar (Albanese), i cili kishte organizuar një kryengritje ndër më të madhatë kundër pushtimit osman. (1)

Fatkeqësisht, për të është shkruar fare pak, për të mos thënë aspak. Dokumentacioni arkivor për këtë ngjarje mjaft të rëndësishme është ruajtur nën sekrecinë më të madhe për dy tre shekuj, në fondet e "Këshillit të Dhjetëve"- Venedik. Për shkak të prapaskenave të rrezikshme madje kriminale që u përdorën ndaj udhëheqësve kryesorë arbërorë të kësaj kryengritjeje, dokumentacioni dhe informacionet që pasqyrojnë tërë peizazhin e kësaj ngjarjeje të madhe është mbajtur në fshehtësi të madhe nga ky institucion i rëndësishëm dhe i veçantë i Republikës së Venedikut, të paktën për tre shekuj.

"KËSHILLI I TË DHJETËVE"

Na duhet të sqarojmë që në fillim se ç'ishte ky "Këshill", mbasi me të, me funksionet që ai kryente dhe vendimet që ai ndërmoi ndaj kësaj kryengritjeje të madhe të arbërorve në fundin e shekullit të XV, lidhen pasojat e dhimbshme që shoqëruan fatet e hidhura të popullsisë shqiptare dhe më gjerë.

"Këshilli i të Dhjetëve" ("Consiglio dei Dieci") ishte një nga institucionet më të rëndësishme, në mos më i rëndësishmi i Republikës së Venedikut për gati pesë shekuj të dominimit të fuqisë të kësaj Republike. "Këshilli i të Dhjetëve" thërrijet kështu, pasi ai përbëhej nga dhjetë anëtarë, të cilët ishin të zgjedhur nga radhët e aristokracisë venecjane që gazonin dhe njiheshin për emër, tradita fisnikërie, besnikëri dhe kontribute të veçanta ndaj interesave të këtij vendi. (2)

Ajo strukturë u krijua në vitin 1310 dhe kishte në kompetencë të mbronte shtetin nga - kryengritjet që mund të kërcënonin Venedikun, - tradhtitë e brendshme dhe të jashtme politike, - komplotet dhe kërcënimet konspirativë. "Këshilli i të Dhjetëve" kishte aq kompetenca dhe fuqi sa me të drejtë konsiderohej pushteti i vërtetë i kësaj Republike. Mbledhjet e saj zhvilloheshin në fshehtësi të plotë dhe vendimet që merreshin nga ky Këshill mbaheshin sekret. Askush nga këshilltarët nuk kishte të drejtë të nxirrte apo përhapte informacionet apo vendimet që merreshin në këto mbledhje. Vendimet e shkruara mbaheshin të mbyllura për tërë institucionet e Venedikut, për dekada dhe shekuj me radhë, për shkak të rëndësisë dhe kompromentimit të rëndë publik që ato mund të kishin.

Pikërisht me këtë "Këshill" dhe vendimet e tij lidhen fatet e kësaj ngjarjeje që trajtojmë më poshtë.

PËRGATITJA E NJË KRYENGRITJEJE TË MADHE ARBËRORE

Menjëherë mbas pushtimit të Mbretërisë së Napolit, në vitin 1484, nga ushtritë franceze, prej Mbreti i Francës, Karli i VIII, ky i fundit pati idenë e organizimit të një

MARTIN FIRMANO KARDINALI SHQIPTAR ORGANIZATORI I KRYENGRITJES MË TË MADHE PËR ÇLIRIMIN E ARBËRISË (1493-1499) Nga Prof. Dr. Irakli Kocollari

kryqëzate të madhe antiosmane, me qëllim çlirimin e tokave të Ballkanit dhe Europës nga pushtimi turk. (3) Nën këtë dëshirë, që ishte e pranishme aso kohe edhe në oborret e tjera mbretërore të Europës, një numër përfaqësuesish të familjeve fisnike shqiptare, të cilët kishin emigruar në Itali dhe kryesisht në Mbretërinë e Napolit ndërmoren një numër aksionesh me karakter politik dhe diplomatik për të frytëzuar idenë e çlirimit të vendit të tyre - Arbërisë. Ndër ata, që shquhen qartë në dokumentacionin e shumtë të arkivave europiane, sikundër në Mbretërinë e Napolit, atë të Vatikanit, të Venecjas, të Parisit, Gjermanisë e gjetkë, është padyshim Gjon Kastrioti, Kostandin Arianiti, Mërkur Bua, Muzakajt, Kladhat, etj. (4)

KARDINALI MARTIN FLAMINIO ORGANIZATOR I KRYENGRITJES

Por, njoftimi i parë për organizimin e një kryengritjeje të madhe në territoret e Arbërisë qendrore, bëhet i njohur aty rreth viteve 1494. Ideologu, frymëzuesi dhe organizatori i saj ishte një Kardinal shqiptar me emrin Martin Firmano. Dokumentet na bëjnë me dije se ai ishte Kardinal i Durrësit, madje ato theksojnë qartë se "ai ishte një shqiptar". (5)

Po ky dokument duke folur për situatën në territoret e Arbërisë nën sundimin Osman, bën me dije se "...popullsia shqiptare e këtyre vendeve (Arbërisë) mbante kontakte dhe merre lajme për përpjekjet e Mbretit (të Francës) për mbështetjen e kësaj kryengritjeje, përmes miqve që ata kanë në Venedik dhe në Pulja, me të cilët ata komunikojnë me shkrim". (6)

Jo vetëm kaq, por Kardinali shqiptar me këtë mision të shenjtë pati shkuar edhe në Itali dhe kishte marrë kontakte me familjet fisnike shqiptare të vendosur atje dhe kishte punuar për t'i bindur dhe tu bënte thirrje atyre të mbështesin idenë e kryengritjes së madhe dhe më tej ti bashkangjiten asaj. (7) "Sepse shumë nga ata ishin të gatshëm të ktheheshin në vendet e tyre në Ballkan, mbasi ishin bij dhe nipër të shumë zotërve dhe njerëzve të famshëm të atyre viseve, sikundër djali i Skënderbeut, djali i Arianitit (Gjergj Arianitit)...etj." (8)

Në këtë fushatë mobilizuese, dokumentet arkivore na bëjnë me dije se Martini kishte blerë dhe grumbulluar një sasi të madhe "shpatash, shqytash dhe shtizash, për tua shpërndarë atyre me të cilët ai ishte në marrëveshje", pra kryengritësve shqiptarë. (9)

Historiani, burri i shtetit dhe diplomati francez, Philippe de Commines, që jetoi ato vite dhe ndoqi nga afër zhvillimet në Arbërinë e asaj kohe, në veprën e tij "Memoires", flet për gjithë përpjekjet e bëra për organizimin e kryengritjes dhe situatën në Arbëri me hollësi. Vetë Commines kishte takuar këtë vit, strehuar dhe mbajtur të fshehur në banesën e tij, në qytetin e Venecjas, një ndër mbështetësit dhe bashkëorganizatorët e kësaj kryengritjeje Kostandin Arianitin, prej të cilit kishte mësuar mjaft hollësi, që ai i shkruan në ditarët e kujtimeve të tij. (10)

KOSTANDIN ARIANITI DHE ROLI I TIJ NË KRYENGRITJEN ARBËRORE

Kostandin Arianiti ishte i biri i princit të njohur arbëror Gjergj Arianiti (1456-



1530) dhe vëllai i Donika Kastriotit, gruas së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Kishte lindur në Durrës, por në moshë fare të re u detyrua të emigrojë në Itali së bashku me familjen pas pushtimit të territoreve arbërore nga forcat osmane. Shumë shpejt fitoi reputacion dhe u bë i pranishëm në kancelaritë e territoreve italiane dhe atyre europiane të fundit të shekullit të XV dhe fillimet e shekullit të XVI, si një diplomat, ushtarak dhe interlokutor me mjaft autoritet dhe i rëndësishëm në zhvillimet jo vetëm italiane por edhe ato europiane të këtyre dekadave. Shërbeu si këshilltar i Papëve të Vatikanit, i Perandorit gjerman Maksimilian, apo mes republikave, Dukateve dhe Mbretërive italiane të kohës. Ndërmjetësoi në realizimin e një numër marrëveshjesh, traktatesh dhe aleancash të rëndësishme ku u pleksën fuqitë më të mëdha europiane të shekujve XV-XVI. (11)

U evidentua kudo si një diplomat dhe politolog me shumë autoritet dhe eksperiencë.

U përfshi në shumë prej lëvizjeve të mërgatës shqiptare në Itali dhe më gjerë për çlirimin e territoreve arbërore nga pushtuesit osmanë.

Burimet arkivore bëjnë me dije se në fund të shekullit të XV, aty rreth viteve 1490 u lidh me Kardinalin shqiptar të Durrësit, Martin Firmano, në përpjekjet e përbashkëta për të mobilizuar familjet fisnike shqiptare të emigruara në Itali, të ktheheshin në tokën amë për të marrë pjesë në kryengritjen e madhe për çlirim.

Nga një numër dokumentesh të Arkivit të Këshillit të të Dhjetëve duket qartë se policia e fshehtë e Venedikut e shqetësuar dhe e trembur për rolin e tij e ka ndjekur dhe survejuar nga afër tërë lëvizjet dhe kontaktet që ai ndërmerre nëpër territoret italiane dhe më gjerë. Një numër raportesh të hartuara nga policia venecjane rriëfejnë survejimin intensiv dhe të afërt që i bëhej këtij diplomati (12)

VEPRIMTARIA E FSHEHTË E MARTIN FIRMANOS PËR ORGANIZIMIN E KRYENGRITJES

Kardinali, Martin Firmano, për muaj me radhë, përgjatë misionit të tij nëpër territoret italiane dhe më gjerë, kishte nxitur dhe mobilizuar shqiptarët e emigruar nëpër territoret italiane, të ktheheshin në tokën arbërore për të marrë pjesë në kryengritjen e afërt. "Ai u kishte folur shumë vetëve, - bëjnë me dije dokumentet arkivore, të cilët ishin të gatshëm të ktheheshin në vendin e tyre në Ballkan, sepse ata ishin bij dhe nipër të shumë zotërve dhe njerëzve të famshëm të atyre viseve, sikundër të Skënderbeut, nipat e zotit Kostandin Arianiti...etj." (13)

Dokumentet bëjnë me dije gjithashtu se ai kishte grumbulluar edhe ndihma financiare. Të gjitha lëvizjet e tij, Kardinali i kishte bërë në fshehtësi të plotë, duke iu shmangur syrit të venecjanëve.

Për ti shërbyer misionit të tij të rëndësishëm, në përpjekjet për të gjetur aleatë dhe ndihma, Firmanoi kishte shkuar gjer në oborrin e Mbretit të Francës dhe kishte takuar



edhe vetë Karlin e VIII. Duke njohur prirjet e Mbretit frëng dhe synimet që ai kishte për çlirimin e territoreve të Ballkanit dhe Europës prej zgjedhës osmane, Firmano i kish treguar monarkut francez tërë planin për kryengritjen shqiptare. Në mbështetje të këtij misioni që kishte ndërmarrë Kardinalit shqiptar, Karli VIII i kish dhënë atij një sasi prej 40 000 dukatësh. (14)

Duket qartë që me to, Firmano veç të tjerave kishte blerë një sasi të madhe armatimi për nevojat dhe të mbështetur kryengritjen. Dokumentet arkivore na njoftojnë gjithashtu se kjo sasi armatimi ishte imbarkuar në dy anije të cilat qenë ankoruar në portet e Venedikut.

Të gjitha përpjekjet për organizimin e kryengritjes, Kardinali Firmano, i cili shërbente në atë funksion në qytetin e Durrësit, i kryente në fshehtësi dhe konspiracion të plotë, që të mos mësonin asgjë autoritetet venecjane, të cilat aso kohe kishin në duart e tyre këtë qytet. (15)

Por, Kardinalit shqiptar i duhej që të ruhej jo vetëm nga venecjanët, që aso kohe ishte në duart e tyre Durrësin, ku ai qëndronte si Kryepeshkop, por edhe nga autoritetet turke të cilat kishin nën pushtim dhe kontrollonin tërë territoret arbërore, krahinat, qytetet dhe fshatrat përtej Durrësit dhe më gjerë. I duhej të vepronte kështu pasi Firmano e dinte fare mirë që kishte një Aleancën Turko – Venecjane për të ndihmuar dhe mbështetur njëri tjetrin.

TRAKTATI TURKO - VENECJAN

Pas vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, ushtritë osmane kishin shtrinë ofensivat e tyre të suksesshme dhe kishin pushtuar njëra pas tjetrës pothuaj tërë territoret ballkanike. Në vitin 1477 përmes operacioneve të tyre të pandalshme, duke plaçkitur, grabitur dhe shkatërruar gjithçka, turqit i qenë afruar Istrias dhe Friulit. Tymi dhe flakët e zjarreve, që ata kishin ndezur mbi pyjet dhe fshatrat e këtyre anëve, tanimë dukeshin qartë me sy të lirë edhe nga kulla e kambaniles, në Sheshin e Shën Markut, në Venecia. (16)

Të tmerruar nga rreziku që afrohej pa u ndalur, venecjanët, "Këshilli i të Dhjetëve", i mbledhur me urgjencë kishte vendosur të gjente një zgjidhje oportune, ti bënte lëshime për gjithë çfarë kërkonin agresorët.

Në këto rrethana, në vjeshtën e vitit 1478, venecjanët që tanimë shihnin qartë se ndodheshin nën kërcënim të drejtpërdrejtë dhe rrethana të disfavorshme luftime, kërkuan menjëherë prej Sulltanit të nënshkruanin një marrëveshje paqeje, që në thelb ishte një Traktat nënshtrimi. Tanimë, turqit superiorë në avantazh ushtarak dhe politik imponuan hartimin e një "And name", në favor të interesave të tyre.

Ky dokument, "Traktati" i shkruar në gjuhën greke, që mban datën 25 janar 1479, në emrin personal të Sulltan Mehmetit II, nënvizonte:

"Unë, Sundimtari i Madh dhe Emiri i Madh, Sulltan Mehmet bej, biri i Sundimtarit të Madh, të ndjerit Murat bej...meqënëse zotërimi ka pasur më parë dashuri dhe miqësi me zotërimin shumë të shkëlqyer dhe shumë të lartë të Venedikut, prapë dua të kemi miqësi të re dhe të bëjmë betim për siguri të mirë..."

... Askush prej njerëzve të Venedikut të mos guxojë t'u shkaktojë dëme zotërimeve të mija (Territoreve që tanimë ishin të pushtuara nga turqit) as njerëzve të mij... Nga ana tjetër Venediku detyrohet t'i dorëzojë zotërimin tim kështjellën e quajtur të Shkodrës në Shqipëri... (17)

Sikundër shihet nga ky dokument, venecjanët patën pranuar tërheqjen nga qëndresa dhe dorëzimin e qytetit të Shkodrës dhe për më tepër kishin premtuar të mos lejonin që në territoret e pushtuara nga turqit (në Arbëri dhe më gjerë) të kryeshin veprime konspirative apo kryengritje që do të kërcënon autoritetet turke të pushtimit.



TRADHËTIA DHE ARRESTIMI I KARDINALIT

Ndërsa dy anije të ngarkuara armatim, me një numër luftëtarësh arbërorë në bord dhe bashkë me ta edhe Kardinali, Martin Firmano (apo Martin Durrsaku - sic gjendet shpesh i shkruar në dokumentet e kohës) dilnin nga portet e Venecjas drejt brigjeve arbërore të Durrësit, policia venecjane në shërbim të "Këshillit të të Dhjetëve", kishte ndaluar dhe bllokuar me të shpejtë ato dhe vetë Kardinalin shqiptar. (18)

Nga kontrolli i ushtruar me imtësi mbi anijet e Kardinalit dhe mbi vetë atë ata, policia i kishte gjetur Firmanos një sasi letrash dhe korrespondence, të cilat zbulonin tërë planin, organizimet, kërret e kryengritjes dhe mobilizimin e shqiptarëve për luftimet që bëheshin gati të nisnin atë kohë.

Menjëherë mbas kësaj ngjarjeje, të befasuar dhe tronditur autoritetet venecjane, "Këshilli i të Dhjetëve", "pati dërguar me urgjencë korjerë nga turqit, në bregdetin dalmat që ti njoftonin për komplotin - kryengritjen e madhe që ishte përgatitur kundër tyre prej shqiptarëve". (19)

Kapiteni i anijes të ngarkuar me armatim, sikundër bën me dije dokumenti i shkruar nga de Comines, ishte një shqiptar, cka tregon se në këtë ndërmarrje dhe organizim ishin përzgjedhur dhe përfshirë vetëm shqiptarë. Mbas kishte konstatuar lëvizjet e policisë venecjane, dhe ndalimin e e Kardinalit, kapiten shqiptar kishte njoftuar me të shpejtë Kostandin Arianitin, bashkëorganizatorin e kryengritjes së madhe, mikun e afërt të Firmanos. "Nëse nuk do të kishte bërë këtë. Arianiti do të ishte kapur rob..." sqaron Philippe de Comino, por ai mundi të largohet në fshehtësi dhe mbriti në Pulje." (20)

REAGIMI I TURQISË DHE VENECJANËVE KUNDËR KARDINALIT "RREBEL" TË DURRËSIT DHE KRYENGRITËSVE SHQIPTARË

Mbas qenë informuar për gjithë mobilizimin dhe organizimin e kryengritjes, turqit kishin marrë masa urgjente në terrenin shqiptar, në krahinat rreth Durrësit dhe gjithë Shqipërinë. Nga informacionet e tyre, ata kishin mundur të mësonin se "ai, Arqipeshkvi i Durrësit kishte ngritur rreth 30 000 shqiptarë në Shqipëri... që të çliroheshin nga robëria e turqve..." (21)

Nga ana tjetër Venecjanët në situatat e krijuara, kishin sqaruar palën turke, pranë Portës së Lartë se "ata asnjëherë nuk kishin pasur qëllim të mbështesnin këta kryengritës dhe as Kardinalin rebel shqiptar". (22)

Edhe më tej, më datë 5 Mars 1495, "Këshilli i të Dhjetëve" i dërgonte Dozhëve të Venedikut

(Kuvendit) një informacion të hollësishëm, sqarues, ku e bënte me dije për "aktivitetin e rrezikshëm" të Kardinalit shqiptar të Durrësit. Në këtë informacion shkruhej: "Po ju bëjmë me dije për marveshjet skandaloze, të pabesa, dhe të rrezikshme të Martinit, Arqipeshkvit të Durrësit, nxitës i popullsisë, në dëm të situatës tonë të mirë... Prandaj, i kërkuam këtij Këshilli të arrestohet dhe të mbahet i mbyllur në burgun tonë më të fshehtë dhe mbasi të bëhet kjo, të vendosni se si duhet të veprohet më tej me këtë çështje..." (23)

Për të dhënë edhe një herë prova të marrëdhënieve miqësore dhe të sinqerta ndaj Perandorisë Osmane, venecjanët më datë 7 Mars 1495 kishin marrë vendim dhe urdhëruar arrestimin e Kardinalit shqiptar, Martin Firmano. Vendimi që ishte shkruar atë ditë, thosh: "të arrestohet Arqipeshkvi, Martin Firmano për shkak se ka tentuar të pushtojë qytetin e Krujës..." (24)

Dhe menjëherë pas kësaj, Kardinali, i cili ishte ndalur në qytetin e Venecjas "u kap dhe u fut në hekurë". (25)

Propozimi për arrestimin e një Kardinali, ishte sigurisht një akt ekstrem, që do të sillte pasoja jo vetëm në opinionin e Venedikut, por edhe më gjerë. Në botën kristiane të asaj kohe, ndjeshmëritë ndaj institucionit dhe autoritetit të kishës katolike ishin tepër të mëdha. Ato qenë delikate, sepse preknin raporte delikate, për më tepër kur bëhej fjalë për ndëshkimin e një përfaqësuesi nga hierarkia e lartë e papatit. Në ato rrethana kërkesa e "Këshillit" për arrestimin e Kardinalit ishte votuar nga Dozhët, por me diferencën e një vote, propozimi për arrestimin e Martin Firminio ishte hedhur poshtë. (26)

MASA PËR NDALIMIN, KONTROLLIN DHE IZOLIMIN E KARDINALIT PREJ KRYENGRITËSVE SHQIPTARË

E megjithatë ky "Kardinali i rrezikshëm" "duhej mbajtur nën kontroll të rreptë, së bashku me kapelanin dhe shërbëtorin e tij," nën një izolim të plotë në fortesën e portit të Venecjas - Lindo. Por, duket qartë se dëshira dhe përpjekjet e Firmanos nuk ishin ndalur. Pikërisht, më datë 6 Mars të vitit 1495, në errësirën e një natë, "arqipeshkvi i Durrësit u kap nga rojet, policia venecjane, ndërsa ai kishte hipur në një grip (anije) dhe largohej nga qyteti..." Me këtë rast "Këshilli", kishte dhënë urdhër urgjent, që ndalonte daljen dhe largimin e të gjitha anijeve dhe barkave nga porti i qytetit.

"Këshilli" kishte urdhëruar të zbrisnin menjëherë Kardinalin nga anija me të cilën kish tentuar të largohej, dhe "të kontrollohej kudo nëpër trup me kujdes hollësisht, ti merreshin të gjitha dokumentet që ai kishte me vete... Mandej, të gjitha ato shkresa që ai ka të shqyrtohen me kujdes dhe vetë ai të pyetet

për të mësuar shkakun e përpjekjeve të tij për tu arratisur dhe në cilin vend donte të shkonte..." (27)

Po ashtu, "Këshilli" kishte urdhëruar që: - a. të bëheshin verifikime dhe të hetoheshin të gjithë burrat e tjerë që kishin qenë në anije me Kardinalin se çfarë përfaqësonin ata dhe cilët ishin planet e tyre,

- b. të merrej në pyetje vetë Kardinali shqiptar dhe të sqaroheshin motivet se përse ai në fshehtësi ish përpjekur të largohej (arratisje),

- c. të sqarohesh nga Kardinali se ku kish tentuar ai të shkonte, cili ishte destinacioni i tij?

- d. Asnjë nga të sipërpërmendurit dhe as anija në të cilën ishte imbarkuar Kardinali të mos lejohej të largohej nga porti i Venecjas, pa urdhërin e atij "Këshilli". (28)

Mbas të ishin sqaruar "tërë veprimet e rrezikshme" të Kardinalit, "Këshilli" duhej të vendoste që ta mbante shqiptarin kryengritës "të izoluar, në një dhomë të tijën, nën mbikqyrjen e rojës".

Bashkë me këto masa, "Këshilli i të Dhjetëve" kishte urdhëruar që të ndaloheshin, të merreshin në pyetje dhe të hetoheshin të gjithë udhëtarët e tjerë, që ishin kapur në bordin e anijes, së bashku me padronin e gripit (anijes). (29)

Por, në një informacion tjetër të Arkivit të Venedikut që mban datën 6 Mars 1495, i cili është gjetur në këto fonde prej historianit të njohur Kostandin Sathas, thuhet se: "Arqipeshkvi i Durrësit, Martin, i cili po vinte prej Mbretit të Francës dhe që kishte marrë me vete edhe letrat e tij, më datën 6 Mars 1495 ishte arrestuar". (30)

Më datë 7 Mars 1495 mbasi plicia kishte kryer tërë veprimet dhe verifikimet policore, "Këshilli i të Dhjetëve" kishte lejuar pronarin e gripit (anijes) së bashku, me udhëtarët e tjerë të nisnin udhëtimin për në destinacionin e parashikuar, përveç Kardinalit shqiptar, kapelanit dhe shërbëtorit të tij. Vendimi i "Këshillit", i kësaj date shkruan: "Këta të tre të qëndrojnë këtu, të ruajtur mirë, brenda në kështjellën e bregdetit - Lindo, dhe të presin aty gjer në daljen e vendimit të këtij Këshilli." (31)

REPRESION I ASHPËR I VENEDIKUT MBI KARDINALIN KRYENGRITËS

Por, veprimet policore dhe ato represive ndaj Kardinalit kryengritës, nga ana e aparatit shtetëror dhe policisë së Republikës së Venedikut nuk ishin mjaftuar me kaq. Cdo të bëhej më tej me Arqipeshkvin e Durrësit, Firmanon? Venecjanët për t'i treguar edhe më tej Perandorisë Osmane servilizmin dhe zellin e tyre në shërbim të interesave të saj, në një mbledhje të Këshillit, të datës 8 Mars 1495, deklarorin: "Nuk është në interesin e Venedikut dhe aq më pak në interes të çështjes së krishtërimit, që Arqipeshkvi i Durrësit (Kardinali) të largohet nga ky qytet (i Venecjas). Prandaj, të merret vendim nga ky Këshill që ky Arqipeshkv të thërritet dhe në praninë e krerëve të këtij Këshilli ti drejtohet atij me fjalë të rënda, sikundër e lyp puna, për ta përbuzur atë për skandalin dhe dëmin që ai ka shkaktuar me përpjekjet për trazira. Veprimet e tij i kanë sjellë dëm krishtërimit dhe do të sillnin pasoja të rënda paqes së mirë që ne kemi me Sulltanin." (32)

E thënë me fjalë të tjera, Venediku kishte shprehur hapur qëndrimin se për interesat e tij, ai është i gatshëm të sakrifikoje jo vetëm një Kardinal shqiptar por edhe një popull të tërë të robëruar, fatet dhe lirinë e tij të humbur, madje të ndëshkonte pa mëshirë fate dhe jetë njerëzore.

Së fundi, "Këshilli i të Dhjetëve" për të shuar me çdo kusht përpjekjet për realizimin e kryengritjes të shqiptarëve të përgatitur prej Kardinalit arbëror, në bashkëpunim me fisnikët arbërorë të emigruar në Itali, dhe krerët e tjerë të familjeve nëpër hapësirat arbërore, me "vendim" të veçantë urdhëronin: "T'i jepet urdhër i ashpër dhe i fortë, me indinjatë dhe kërcënim, Kardinalit të Durrësit, se me vendim të këtij "Këshilli" nuk duhet të largohet nga Venediku pa urdhërin dhe lejen tonë dhe posaçërisht të këtij "Këshilli". (33)

IZOLIMI I PLOTË, KONTROLLI POLICOR DHE NDALIMI I KONTAKTEVE ME KRYENGRITËSIT

Aq shqetësuese ishte bërë situata për venecjanët, nga përmasat e organizimit të kryengritjes shqiptare prej Firmanos, sa një ditë pasi “Këshilli” kishte marrë vendimin e mësipërm, më datë 9 Mars 1495 ishte detyruar të rimerrte një vendim dhe të argumentonte nevojën e ndalimit dhe të kontrollit të “Kardinalit rebel”. Në vendimin e kësaj date, “Këshilli” urdhëronte: *“Sa për Venedikun aq edhe për punët e krishtërimin nuk bën që Arqipeshkvi i Durrësit të largohet nga ky qytet... prandaj nesër në mëngjes ai të sillet në praninë e krerëve të këtij “Këshilli”... dhe Princi ynë i nderuar ti thotë fjalë të ujdësura mirë me qëllim që ai të detyrohet të përbuzë gabimin e tij dhe të ndalojë lëvizjet e kurdësura, që i sjellin rreziqe krishtërimin dhe paqes që ne kemi me Sulltanin. Në fund ti jepet urdhër i prerë, që me vendin të këtij “Këshilli” atij i ndalohet të largohet nga qyteti i Venecjas”.* (34)

Sikundër shihet, për interesa të tyre dhe të pushtuesve osmanë, venecjanët synonin të shkëpusnin me çdo kusht Kardinalin shqiptar nga komanda dhe kontaktet e tij me kryengritësit shqiptarë, të cilët prisnin në qytetin e Durrësit udhëheqësin e tyre dhe bashkë me të armatimin e blerë në perëndim! Me këtë veprim venecjanët kërkonin ti hiqnin “trurin” kryengritjes dhe bashkë me të ti jepnin një goditje të rëndë vetë luftëtarëve të saj.

Me këto akte represive të ndërmarra nga Republika e Venedikut në bashkëpunim me turqit, venecjanët kishin mundur të frenonin një kryengritje të fuqishme të shqiptarëve, e cila përlloragiste një forcë goditëse të mobilizuar prej rreth 30 000 luftëtarësh dhe që shtrihej pothuaj në tërë territoret e arbërisë mesjetare duke filluar nga Durrësi dhe që zgjerohej në Krujë, Lezhë, Shkodër, Berat, Korçë, Gjirokastrë, Thesali dhe më në jugë akoma. (35)

Kështu, Kardinali shqiptar ishte izoluar në qytetin e Venedikut dhe ishte vënë nën një kontroll të rreptë policor, për të parandaluar çdo akt të mundshëm të arratisjes apo të vendosjes së kontakteve me kryengritësit në territoret e Arbërisë.

Në një dokument sekret të Arkivit të Venedikut, një analizë e veçantë për këtë ngjarje, bëhet fare e qartë se përse duhej ndaluar kthimi i Arqipeshkvit (Kardinalit) të Durrësit, Martin Firmanos në territoret e Arbërisë. Në të thuhet: *“Venecia kishte arsye serioze për të parandaluar një kryengritje të krishterëve, sepse rrethanat politike të kohës e detyronin më shumë se kurrë Italinë (Venedikun) të qëndronte në marrëdhënie të mira me Turqinë. Ishin këto arsye që udhëhoqën “Këshillin e të Dhjetëve” në lidhje me arrestimin e këtij kryepeshkopi. Por, në vitin 1499 rrethanat ndryshuan dhe Venecia, në mes të luftës me Turqinë, u detyrua t’i drejtohej kryepeshkopit për të njëjtin qëllim, që vite më parë e kishte aq shumë frikë.”* (36)

KARDINALI SHQIPTAR - NGA KRIMINEL NË SHPËTIMTAR PËR VENEDIKUN!

Kjo gjendje e rëndë kërcënuese, kontrolli dhe pse jo terrori ndaj Kardinalit shqiptar do të vazhdonte gjatë. Vetëm gati pas katër vitesh rrethanat për kryengritës do të ndryshonin, por edhe në këtë rast jo për bamirësinë apo zemërgjerësinë e Venedikut. Zhvillime të papritura politike dhe ushtarake kishin ndodhur dhe papritur ky Kardinal i padëshirueshëm, madje i rrezikshëm tanimë, do të thërritej për ndihmë për nevojat akute dhe interesat e Venedikut.

Më datë 13 Qershor 1499 Venecja kishte marrë lajme tronditëse, se forca të shumta të ushtrisë turke ishin nisur nga Stambolli, në dy drejtime, njëra drejt bazave (qytete-fortesa) në More (Peloponez) dhe tjetra drejt Qytetit të



Durrësit, që gjer atëherë ishte nën zotërimin e venecjanëve. (37)

Sigurisht, Venediku e dinte fare mirë se repatet e pakta në numër, të garnizonit të saj në kështjellën e Durrësit, nuk mund ta mbronin dot këtë qytet nga ofensiva barbare osmane. Në këto rrethana “Këshilli i të Dhjetëve” ishte mbledhur me urgjencë për të gjetur një rrugë shpëtimi! Venecjanët kishin konkluduar se rruga e vetme e shpresës ishte Kardinali shqiptar që gjer atëherë ishte ndëshkuar, përndjekur, nëmur, izoluar dhe kërcënuar për tu vrasur nga vetë ata.

Të mbledhur nën një shqetësim serioz, vendimi i “Këshillit” ishte: *“Të dërgohet Martini shqiptar, Arqipeshkvi i Durrësit, i cili adhurohet në këto vende, ku ka ndjekur të shumtë dhe ti jepet me vehte 50 dukatë...”* (38)

Mbrenda po këtij muaji, më datë 28 Qershor 1499, “Këshilli” i alarmuar ishte mbledhur përsëri dhe kishte vendosur: *“Që Arqipeshkvi i Durrësit, i cili gjer tani qëndron këtu në Venedik, në bindje të vendimit të këtij “Këshilli”, të datës 9 Mars 1495, tanimë të lihet i lirë... Dhe meqë ai mund ti sjellë shumë dobi Shtetit tonë (të Venedikut) veçmas në territoret e Durrësit dhe të Ulqinit, të thirret... dhe aty pasi të lavdërohet... të dëgjohej për propozimet e dobishme për të mirën e shtetit tonë...”* (40)

Pak ditë më pas, më datë 2 Korrik 1499, në proces-verbalin e mbajtur nga ky “Këshill” shkruhet: *“U mbarua puna me Arqipeshkvin e Durrësit, i cili po shkon në Durrës”.* Duket qartë se paria e Venedikut tanimë ishte kënaqur që Kardinali kryengritës po shkonte në vendin ku kërcënoheshin interesat e saj, një njeri me influencë që mund të mobilizojë njerëz që do të përballonin rreziqet e frikshme. (41)

Pak ditë mbasi ka mbërritur në Durrës, më datë 24 Korrik të vitit 1499, Kardinali shqiptar, duket se menjëherë është vënë në lëvizje për të mësuar për zhvillimet në atdheun e tij të dashur. Në dokumentet e historianit venecjan Marino Sanudo ruhet një letër që Firmano u ka dërguar autoriteteve venecjane përmes të cilës i vë në dijeni se Sulltani me forca ishte gjashtë ditë larg Durrësit dhe në koordinim me planet e tij ishin gjithashtu edhe Pashai i Rumelisë, pashai i Anadollit dhe një pjesë e flotës osmane që pritet të afrohej nga deti drejt Durrësit. Kjo situatë e rëndë kish detyruar shumë fshatarë të krahinave të Arbërisë qëndrore të kërkonin strehim në qytetin e Durrësit... (42)

NJË AKT KRIMINAL NDAJ KARDINALIT SHQIPTAR KRYENGRITËS

Në fondin e dokumenteve të Arkivit të Senatorit Malipiero gjendet një tjetër dokument që hedh dritë mbi zhvillimet e mëtejme rreth kërcënimeve osmane mbi qytetin e Durrësit, si dhe për vetë fatin e Arqipeshkvit, Martin Firmano. Informacioni i shkruar më datë 6 Gusht 1499 bën me dije për një ngjarje tepër tronditëse. Në të thuhet:

“Republika e Venedikut (Sinjoria), dy muaj më parë ka dërguar Ipeshkvin Martin Firmano nga Durrësi, në Shqipëri, për ti nxitur ata popuj kudër turkut. Ky Ipeshkv, më datë 6 Gusht 1499, duke qënë në pallatin e Durrësit, me bajlin (Ambasadorin venecjan) Vido Diedo, konstatoi se ishte hematisur. Menjëherë pas kësaj ai mori në dorë pendën dhe i shkroi Sinjorisë (Këshillit Venecjan), sepse e ndjente se do të vdiste... dhe për këtë porosiste edhe nipat e tij.” (43)

Megjithëse në atë gjendje tepër të rëndë, nën efektet e helmatisjes, që vazhdonte ta rëndonte shëndetin e tij, Firmano ky shqiptar me shpirtin e tij të pashuar të revoltës, vazhdonte të punonte në terren për organizimin e kryengritjes. Kështu, më datë 7 Gusht 1499 Martin Firmano gjendjet i rënduar në një fshat në rrethet e Tiranës, i rrethuar nga burra të moshuar të këtyre krahinave *“të cilët jo vetëm kundërshtonin dhënien e haracit Sulltanit por ishin bërë gati të coheshin kundër pushtuesve osmanë...”* (44)

Duke ndjekur me shqetësim operacionet plaçkitëse të trupave të kalorësisë osmane në fshatrat përreth Durrësit si dhe kërcënimet serioze që i afroreshin vetë qytetit, Firmano megjithëse në një gjendje tepër të rënduar shëndetësore, u bën thirrje banorëve kryengritës t’i japin ndihmë Durrësit për të mos rënë në duart e turqve. Dhe si amanet të fundit ai i drejtohet Sinjorisë që të caktojë në vendin e tij, në funksionin e Arqipeshkvit të Durrësit, nipin Gjon Marinin. Mbas kësaj Kardinali kryengritës ka dhënë shpirt! (45)

KUSH E HELMOI KARDINALIN KRYENGRITËS???

Në një informacion që mban datën 8 Gusht 1499, të shkruar nga bajli venecjan i Durrësit, drejtuar “Këshillit të të Dhjetëve” në Venedik shkruhet: *“Sot më datën 8 Gusht, arqipeshkvi i Durrësit vdiq. Ai qëndroi i sëmurë vetëm gjashtë ditë. Kjo vdekje ka qënë një dëm i madh për qytetin e Durrësit sepse ai kishte pas vehtes shumë përkrahës...”* (46)

Po kush ishte autori apo autorët e vrasjes së këtij arbërori kryengritës, të këtij Kardinali që nuk u nënshtroa gjer në frymën e tij të fundit duke u përpjekur dhe luftuar për çlirim të Shqipërisë prej zgjedhës turke?

Në një informacion që gjendet mes dokumenteve të “Arkivit të Maliperos” shkruhet se *“Ata që e kanë helmuar janë: Arqidhjakoni (Archidiacono), një Kanonik (Canonico) dhe një Gjakua (Zago), të cilët janë arrestuar dhe do të dërgohen në Venecja për tu gjykuar...”* (47)

Dokumenti jep edhe një hollësi të rëndësishme për aktivitetin e Martin Firmanos, i cili tregon se ky arbëror me të mbërritur në Durrës kishte filluar punën për riorganizimin e kryengritjes me shqiptarët e tij kundër pushtimit Osman. *“Brenda dy muajve ky Arqipeshkv kishte mbledhur 6 000 shqiptarë, të cilët qenë të gatshëm dhe i shkonin atij pas. Këta do të kishin ngritur në këmbë gjithë vendin kundër Turqisë... Prandaj për vdekjen e tij është hidhëruar i gjithë vendi!”* - përfundon informacioni. (48)

Sigurisht, të akuzuarit qenë arrestuar dhe dërguar në Venecja për tu gjykuar. Gjyqi i tyre është shtyrë dhe zvarritur për shumë kohë, madje vjet! Gati tre vjet nga koha e arrestimit, më datë 4 shtator të vitit 1502, *“gjykatësi komisioner, i ngarkuar nga Selia Apostolike”, i ka shpallur të pafajshëm dhe i ka liruar personat e dyshuar për vrasjen e Kardinalit kryengritës!!* (49)

Po kush ishin vrasësit e Kardinalit, që gjer në momentin e fundit nuk u ep së luftuari për kryengritjen e madhe shqiptare kundër pushtuesit turk?

Në një letër dërguar patriarkut të Venedikut, Thomas Donatus, nga një informator anonim që mban pseudonimin “Hadriani”, më datë 5 shtator 1502, ai shkruan se *“...është vërtetuar dhe besohet nga rrëfimi i të burgosurve se ata e kryen një krim të tillë, por jo me nxitjen e turqve... prandaj kjo çështje duhet të vazhdojë të hetohet...”* (50)

“REQUIEM AETERNAM – “PREHJE E PËRJETSHME” KARDINALIT MARTIN FIRMANO QË U SAKRIFIKUA PËR LIRINË E ATDHEUT TË TIJ - ARBËRISË

Por, cilido që të ishte vrasësi apo vrasësit e Kardinalit Martin Firmano një gjë është e sigurt, se vrasja e tij kishte motive politike. Qëndresa, rezistenca dhe përpjekjet e tij të pandalshme për organizimin e një kryengritjeje mbarëbërore kundër pushtimit Osman ishin shqetësimi dhe tmerrri për vetë pushtuesit lindorë por edhe për venecjanët. Mobilizimi i një force prej rreth 30 000 forcash arbërore ndoshta është e vetmja në historinë e trojeve të Arbërisë mesjetare me këto përmasa.

Kontaktet e Firmanos me Mbretin e Francës, me krerët e familjeve fisnike arbërore të larguara në perëndim, mbas vdekjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, koordinimi i kësaj lëvizjeje me një prej figurave të shquara arbërore Kostandin Arianitin dhe Gjon Kastriotit, blerja e armatimit të nevojshëm për forcat kryengritëse, shtrirja e këtij mobilizimi nga Arbëria qëndrore, në Durrës, në veri në Ulqin, në jug në Thesali dhe gjer tek arbërit e Peloponezit, përbënte një fuqi unike luftarake, si asnjëherë më parë dhe më pas, kundër perandorisë turke. Vetë Kardinali, Martin Firmano ishte truri dhe shpirti i frymëzimit dhe mobilizimit të kësaj kryengritjeje. Nëse nuk do të eliminoheshin përmasat e kësaj kryengritjeje, ajo do të ishin fatale për pushtuesit dhe për aleatët e tyre.

Duke ofruar dhe bërë të njohur këto dokumente dhe aktin e këtij Kardinali të pamposhtur, pionier të përpjekjeve për lirinë e Atdheut të tij – Arbërisë, do të ishte në nderin tonë, të qytetit të Durrësit, të Shqipërisë, por edhe të vetë kishës që ky hierark patriot, që u sakrifiku për këtë mision të shenjtë, të nderohej dhe të rreshtohej në altarin e heronjve pse jo të shenjtoreve të lirisë.

Romani "Gora pa zogj" i shkruarit Namik Dokle, pjesë e trilogjisë "Atje ku dielli lind dy herë. – Saga e Gorës", na vjen nga një botë e veçantë, nga hapësira e Gorës, nga "fundi i botës", marginalizuar nga një jetë plot mundime, të vështirë dhe të rëndë dhe, për çudi, pikërisht asaj jete i japin vlerën e njerëzore.

Duke lexuar romanin ndihet një fluturim nëpër kohë, gjë që përshfaqet edhe nga kompozimi i brendshëm i tij, në të cilin hapësira dhe koha shpërhapen në atë mënyrë, që në asnjë fazë të tekstit autori nuk ndalet gjatë, sikur të ketë drojë se mos ndonjë segmenti të subjektit i jep më tepër vëmendje dhe, kështu, ia merr një segmenti tjetër, jo më pak të rëndësishëm.

Në këtë mënyrë, si një lëvizje e pandalshme në një ekran të gjerë, përftohet pamja dhe portreti i një populli, i goranëve, në gjithë perspektivën dhe rrokullimat e kohës; fati i tyre dhe qëndresa në kushtet më të rënda. Në fund të romanit, në këtë shtresëzim të rrëfimit dhe mjedis të çuditshëm, gati-gati magjik, kuptohet jo vetëm karakteri i goranëve, por edhe përpjekja e tyre mbrojtëse përballë rrapëllimave të reja të kohës, në atë pjesë të fatit që i ka vendosur drejtësia kozmike.

Kur bëhet fjalë për kompozimin e jashtëm të veprës, vihet re që autori nuk i ka kushtuar shumë vëmendje shtresëzimit të tij, gjë që është dalluese për romanet romantike dhe realiste, *ndërkohë që është përqëndruar në mjeshtërinë artistike të prozës, duke gdhendur personazhet me një individualizim stilistik, u ka dhënë rëndësi shenjave bashkëkohore të rrëfimit, nëpërmjet të cilave vepra ka përfutur një përmbajtje të plotë të romanit modern.* Duket që autori Namik Dokle u ka dhënë përparësi dallimeve psikologjike dhe morale të personazheve të tij, gjë që është konceptimi i sotëm i botës së letrave, bindja se ngjarjet janë vetëm skena dhe qerthulli, ndërkohë që drama e vërtetë zhvillohet në thellësitë e brendshme të qenies njerëzore dhe morale.

"Rrjedhat e reja" kanë sjellë "kohën e re", idenë e demokracisë, por bashkë me pamjen e shëmtuar të saj, ndërkohë kemi edhe një linjë ngjarjesh anarkike, që do të kushtëzojnë dyshimin në drejtësinë e përvojave të deritanishme, në themelin e të cilave qëndron mençuria popullore... Tashmë janë shfaqur kundërtësitë: "Ti je gjarpër, por unë jam iriq, prandaj nuk ta kam frikën, nuk më bën dot asgjë!", thotë diku Çopur Çabraku. Shfaqen kështu forca të reja në kohë të reja, të ashpra dhe pa arsye, por të fuqishme dhe sipërmarrëse. Njeriu i zakonshëm nuk i kupton ato, por i pranon, jo me dëshirë, por se nuk ka ndonjë mundësi tjetër, madje në këtë distopi ngjarjesh dhe shfaqjesh të karaktereve kërcënuese, përshfaqet pasqyrimi i një gjendjeje të re, që akoma nuk është pasqyrim i drejtpërdrejtë, por kuptohet që tashmë në skenë kanë hyrë aktorët e botës bashkëkohore, të frikshëm, të suksesshëm dhe të kudondodhur.

Nëpërmjet tyre autori ndërton trekëndëshin e parë të romanit, pirustinë e veçantë: "Çopur Çabraku – Rroftë Hoxha – Jallman Xhimshiti". Është trekëndëshi që shpërfaq zymtësinë e ditëve dhe fatkeqësi të reja. Pa këtë trekëndësh do të krijohet përshtypja e një Gore të paqte dhe të qetë, që do të mbetet në kohërat e utopisë, ndërsa

Mbi romanin "Gora pa zogj", pjesë e trilogjisë "Atje ku dielli lind dy herë" të shkruarit Namik Dokle.

Frika dhe vdekja, simbol dhe metaforë

Nga Reshat Fazlli, Prizren

ky trekëndësh i ndryshon dimensionet, subjekti bëhet realist, ndërsa rrëfimi magjik në përballje me besimin popullor dhe kodin e sjelljes tradicionale. Personazhet e të rinjve, me sjellje të paskrupullta, krijojnë rreth vetes botën e tyre të vogël, kronotipe vetjake, që bëhen përmbajtje e re, sistem i ri në mjegullat e demokracisë. Ky trekëndësh përbën vdekjen e civilizimit, pirustinë ku zharitet njerëzorja, vdekjen e karakterit, madje edhe pa satirizimin e tekstit apo parodizimin e rrëfimit, por vetëm me përpjekjen e njëmendtë që të jetë i tillë.

Bazamenti i këtij trekëndëshi është Çopur Çabraku, ky "biznesmen i suksesshëm", madje i shikuar edhe si lider popullor, imponues i fatit të të tjerëve, ai që blen çdo gjë që mund të blihet (dhe duket që gjithçka mund të shitet). Është qenie e gjallë e kohëve të reja, por i vdekur si njeri, dhe e vetmja gjë që ka arritur me sukses vetjak, është hajnia e pulave, të tjerat ia solli koha, të

cilën njerëz si ai e kapën për fyti. Ai është i zbuluar krejtësisht, në frymë dhe tekst: tek ai gjithçka thuhet hapur dhe me zë të lartë, bota e tij e brendshme, skicimet e jashtme, dukja dhe veprimet janë në një rrafsh. Vështrimi i vetvetes prej tij përputhet me atë që të tjerët shikojnë tek ai, shoqëria, bashkëpunëtorët; aq sa ne zemërohemi me ta, po aq sa edhe me të adhuruarim prej tyre. Këta janë ai soj njerëzish që shfaqen, ngrihen deri në lartësitë e paturpësisë, trazojnë tokën dhe qiellin, qëllonë si rrufetë nga lart, lëshojnë zjarr dhe djegin gjithçka rreth vetes. Në fund ngelen pa gjurmë, shkretia mbetet pas tyre që të na paralajmërojë për një kohë të gjatë.

Përkundër këtij trekëndëshi simbolik, në roman kemi një tjetër, që përfaqësohet nga Ismen Kallabaku, Petrit Kallabaku dhe Hasime Xhimshiti. Do të thoshim që është trekëndëshi i personazheve klasike. Më i skalituri më duket ai i Hasimes, heroina që dinte gjithçka për luftën,

por që ishte e papërgatitur për jetën e ashpër të paqes. Në luftë ishte e aftë që të sakrifikoje edhe jetën për shokun, për shoqen, ndërsa në paqe nuk ishte e aftë të dashuronte, ishte e trembur dhe më shumë i frikësohej mosbesimit në vetvete sesa vdekjes. Ashtu edhe mbetet, e vetmuar, gati e çmendur në mes të katër mureve të ftohta, sepse, ashtu siç ka shkruar Mesha Selimoviç në romanin e tij "Kështjella": "Lufta është e ashpër, por e ndershme, siç ndodh të kafshët. Jeta është e ashpër, por e pandershme, siç ndodh mes njerëzve". Deri edhe çmenduria e Hasimes vetëm sa tremb Çabrakun në egërsinë e tij dinake.

Personazhet e trekëndëshit të dytë janë të vetmet që diqysh kundërvihen ndaj "sjelljeve të reja", të cilat as vetë ata nuk mund t'i zbulojnë. Ky simbol përfaqëson majën e jetës së goranëve, të asaj jete të dikurshme të Gorës, ku janë përkundur të parët tanë, Gorën, me të cilën u dashuruan dhe e duan më shumë sesa veten, i kthehen e i rikthehen asaj, për ta mbrojtur nga gjuhët e këqija, njëlloj sikur të ishte kopshti i parajsës dhe jo vendi i shkrepave dhe bërlinave, i gurëve dhe rrëpirave. Edhe pse prej kohësh, siç shkruan autori, "është prerë me shpatë", ajo jeton të njëjtën jetë në dy anë, jetën e vet autentike. "Një trup, por dy sundues...", ndërsa fati i njëjtë. Kjo e bën romanin një përkatësi të Gorës unike.

Simbolika e vuajtjes në romanin e Namik Dokles është epifonema "vdekje". Veprimi i saj godet dhe kërcënon të gjithë personazhet, të gjithë ata njëlloj janë të vetëdijshëm, të gjithë bartin vdekjen si shenjë paralajmëruese, në shtëpi, në punë, në marrëdhëniet me miqtë dhe të tjerët. Kjo përshfaqet më shumë dhe përmendet më shpesh. *Jo pa arsye, autori ka përzgjedhur frikën nga vdekja, nga përmbytja, nga braktisja si simbol dhe metaforë, që dominon romanin.* Është frika e Ismen Kallabakut se mos humbet fëmijët, frika e Andritit, se kurrë nuk do ta gjejë dashurinë e humbur të jetës (dhe vritet pa e gjetur, edhe pse pranë saj). Frika e Hasimes, në atë jetë që i ka mbetur, që tashmë e ka humbur heroinën brenda vetes duke dënuar me vdekje shoqen e saj më të mirë. Është edhe frika e Çopur Çabrakut, që duke u zhytur në keqbërjen e vet mund të humbasë pasuritë.

Dhe më në fund, është edhe frika e vetë autorit se mos Gora do të boshatiset, do të mbetet pa jetë, pa njerëzit që po e braktisin, apo që vdesin aty të vetmuar dhe, më dhimbshëm akoma, ta marrin në dorë batakçinjtë dhe fajdexhinjtë duke i shkaktuar kështu një vdekje kolektive.

Frika si simbol i romanit përbën edhe anën lirike të rrëfimit, është dialogu i brendshëm i personazheve dhe monologu i brendshëm i autorit, që përshkon veprën në tërësi. Platoni thoshte që "dashuria është e bukur, por vdekja është superiore..." dhe për këtë arsye, tragjeditë mbeten më gjatë në kujtesë dhe nxisin katarsisin. Bukuria e dukshme e veprimit qëndron në mendimin psikologjik dhe vdekjen si dy gjëra të pashmangshme...

Në romanin e Namik Dokles, Gora, për kushedi të satën herë, përjeton fatin e vet shekullor, nëpër kohërat që parakalojnë përpara saj. Kohët kalojnë, por trishtimi dhe brengat ndryshojnë vetëm formën dhe stilin, ndërkohë që mbeten njëlloj therëse, njëlloj të dhimbshme. "Gora pa zogj" jo vetëm që na zbulon mjeshtërinë letrare të autorit, por është edhe një vepër që, sigurisht, i sjell vlerë të re letërsisë.



Ekspozita “Ikonat e Shqipërisë – Thesaret e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës”
Muzeu i Arteve të Bukura, Chambéry

MAGJIA E ARTIT IKONOGRAFIK SHQIPTAR NË FRANCË

Nga Ylli Drishti
Historian & Kurator Arti

Më 13 qershor ora 11.00 në Muzeun e Arteve të Bukura i Chambéry-së, në Francë, u zhvillua ceremonia e hapjes ekspozitës: “Ikonat e Shqipërisë - Thesaret e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës”. Në këtë ceremoni mori pjesë një delegacion shqiptar i përbërë nga përfaqësues të turizmit dhe të institucioneve vendore, të kryesuar nga Kryetari i Bashkisë së Korçës, **z. Sotiraq Filo**, Pjesëmarrja e tyre i dha kësaj ekspozite një dimension të veçantë institucional, duke nënvizuar rolin e bashkëpunimit kulturor në prezantimin dhe ruajtjen e trashëgimisë së ikonografisë shqiptare. Hapjen e ekspozitës e përshëndeti Kryetari i Bashkisë së Chambéry **z. Thierry Repentin**, Ambasadori i Shqipërisë në Francë, Paris **z. Dritan Tola**; Kryetari i Bashkisë së Korçës **z. Sotiraq Filo**; Drejtorja e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë **znj. Fjoralba Prifti** dhe homologu i saj Drejtori i Muzeu i Arteve të Bukura të Chambéry **z. Nicolas Bousquet**. Ky event kulturor i veçantë u shoqërua nga “Kuarteti i Harqeve i Filarmonisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë (Tiranë)”.

Nga 13 qershori deri më 15 nëntor 2026, Muzeu i Arteve të Bukura i Chambéry-së, në Francë, do të mirëpresë ekspozitën “Ikonat e Shqipërisë - Thesaret e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës”, një nga ngjarjet më të rëndësishme të diplomacisë kulturore shqiptare në

Evropë gjatë këtij viti. E organizuar në kuadër të partneritetit ndërmjet qyteteve të Chambéry-së dhe Korçës, si edhe në frymën e afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, ekspozita sjell për publikun francez 49 ikona të rralla të shekujve XIV-XX, të përzgjedhura nga fondi i pasur i Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës. Përmes tyre, vizitorët ftohen të zbulojnë një trashëgimi artistike dhe shpirtërore të Ballkanit, ende pak të njohur në Francë.

Një traditë ekspozitash shqiptare në Francë

Kjo ekspozitë vazhdon një traditë të rëndësishme të prezantimit të trashëgimisë shqiptare në Francë. Në vitin 1974, në Petit Palais të Parisit u organizua ekspozita monumentale “L’Art albanais à travers les siècles” (“Arti shqiptar në shekuj”), e cila prezantoi 612 objekte nga historia dhe arti shqiptar. Më pas, në vitin 1993, Muzeu Kombëtar Marc Chagall në Nicë çeli ekspozitën “Trésors d’art albanais: icônes byzantines et post-byzantines du XIIe au XIXe siècle”, kushtuar ekskluzivisht ikonografisë shqiptare. Një tjetër prezantim i rëndësishëm u zhvillua në vitin 2004 në selinë e UNESCO-s në Paris.

Ekspozita e Chambéry-së përfaqëson kulmin e këtij dialogu kulturor. Nga rreth 6400 ikonat që

ruhen në Korçë janë përzgjedhur kryevepra të ikonografisë shqiptare: ikona bizantine, vepra të Onufrit, të vëllezërve Zografi, të Konstandin Jeromonakut, Kostandin Shpatarakut, Mësues Konstandinit dhe mjeshtërive anonime që kanë formësuar historinë e artit kishtar shqiptar.

Një urë kulturore mes Chambéry-së dhe Korçës

Historia e kësaj ekspozite lidhet ngushtë me bashkëpunimin e nisur ndërmjet Chambéry-së dhe Korçës. Në vitin 2020, Bashkia e Chambéry-së vendosi të krijojë partneritete me qytete të vendeve candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ndërsa Korça u përzgjedh për shkak të afërsive kulturore, historike dhe identitare që ndan me qytetin francez.

Marrëveshja zyrtare e bashkëpunimit u nënshkrua në vitin 2024 dhe ka sjellë tashmë projekte në fushat e kulturës, turizmit, arsimit, shkëmbimeve universitare dhe rezidencave artistike. Organizimi i “**Sezonit Shqiptar 2026**” në Chambéry përbën momentin më të rëndësishëm të këtij partneriteti, ndërsa ekspozita e ikonave shqiptare është padyshim ngjarja e saj qendrore.

Në dosjen zyrtare të ekspozitës, kryetari i Bashkisë së Chambéry-së, **Thierry Repentin**, e cilëson

ardhjen e ikonave të Korçës si “një ngjarje me rëndësi ndërkombëtare”, duke theksuar se ato përfaqësojnë një thesar të mirëfilltë evropian të artit bizantin dhe pasbizantin.

Dy muze, një dialog evropian

Ithemeluar në vitin 1980, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar në Korçë ruan një nga koleksionet më të mëdha të ikonografisë në Ballkan, me mbi 8200 objekte muzeore dhe rreth 6400 ikona. Ai është rezultat i përpjekjeve të jashtëzakonshme për shpëtimin e trashëgimisë fetare shqiptare gjatë periudhës së ateizmit shtetëror dhe sot konsiderohet një nga institucionet më të rëndësishme të kulturës shqiptare.

Nga ana tjetër, Muzeu i Arteve të Bukura i Chambéry-së, i vendosur në kryeqytetin historik të Savojës, zotëron pas Luvrit koleksionin e dytë më të madh të pikurës italiane në Francë. I restauruar tërësisht në vitin 2012, ai është shndërruar në një qendër moderne ku dialogojnë arti historik dhe krijimtaria bashkëkohore evropiane.

Pikërisht në këtë hapësirë prestigjioze, ikonat shqiptare vendosen në dialog me traditat e mëdha artistike të Evropës, duke dëshmuar vlerat universale të trashëgimisë sonë kulturore.

Një projekt me përmasa ndërkombëtare

Përgatitja e ekspozitës kërkoi rreth gjashtë muaj punë intensive nga specialistët e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës, Genti Proko, Romeo Kallço, Genti Postoli - nën drejtimin e drejtoreshës Fjoralba Prifti. **Ekspozita pati mbështetjen** e Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme të Francës, të përfaqësuar nga Ministri **z. Jean-Noël Barrot**, **Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit** të Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministri **z. Blendi Gonxhja**, si dhe Bashkisë së Korçës, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **z. Sotiraq Filo**, si dhe nga një komitet shkencor ndërkombëtar



ku marrin pjesë studiues të Muzeut të Luvrit, universiteteve të Athinës dhe Tiranës dhe specialistë të njohur të artit bizantin.

Ekspozita ka përfutur mbështetjen e çmuar të Ambasadës së Francës në Shqipëri: Shkëlqesia e Saj znj. **Catherine Suard**, Ambasadore e Francës në Shqipëri dhe stafi i ambasadës; Shkëlqesia e Tij z. **Dritan Tola**, Ambasador i Shqipërisë në Francë, si dhe znj. **Megi Bode**, Sekretare e Parë e Ambasadës së Shqipërisë në Francë dhe stafi i saj.

Komisarët e ekspozitës janë: Nicolas Bousquet, drejtor i muzeve të Chambéry-së dhe Fjoralba Prifti, drejtoreshë e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës

Projekti u mbështet nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit e Shqipërisë, Ministria Franceze e Kulturës, ambasadat e të dy vendeve, si dhe nga një komitet shkencor ndërkombëtar ku marrin pjesë studiues të Muzeut të Luvrit, universiteteve të Athinës dhe Tiranës dhe specialistë të njohur të artit bizantin.


Ekspozita shoqërohet nga një katalog dygjuhësh frëngjisht-shqip, botuar nga shtëpia prestigjioze botuese Silvana Editoriale e Milanos, i cili pritet të mbetet një referencë e rëndësishme për studimet mbi ikonografinë shqiptare.

Përtej ekspozitës.


Përtej ekspozitës “*Ikonat e Shqipërisë, thesar i Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës*”, Muzeu i Arteve të Bukura i Chambéry-së ka ndërtuar një program të pasur aktivitetesh kushtuar kulturës shqiptare. Vizita në muze të komentueshme, konferenca, punëtori krijuese për fëmijë, takime me ikonografë, koncerte dhe mbrëmje tematike do t’i ofrojnë publikut mundësinë të zbulojë historinë, artin dhe traditat e Shqipërisë në formë të ndryshme.

Sezoni kulturor shqiptar do të shtrihet gjatë gjithë vitit 2026 me konferenca mbi historinë dhe integrimin evropian të Shqipërisë nga filozofja **Lea Ypi**, një fundjavë të dedikuar kinemasë shqiptare, pjesëmarrjen e artistëve dhe ansambleve shqiptare në ngjarje të rëndësishme kulturore të Chambéry-së, si dhe koncerte me emra të njohur ndërkombëtarisht si **Tedi Papavrami**. Programi do të kulmojë me ekspozitën kushtuar fotografit të madh shqiptar **Gjon Mili** dhe projekte bashkëpunimi artistik mes të rinjve të Korçës dhe Chambéry-së, duke forcuar dialogun kulturor ndërmjet dy qyteteve dhe dy vendeve.

Në këtë mënyrë, “Ikonat e Shqipërisë” shndërrohet në më shumë se një ekspozitë arti: ajo është një dëshmi e fuqisë së kulturës për të ndërtuar ura dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes popujve, duke e vendosur trashëgiminë shqiptare në qendër të hartës kulturore evropiane.



Avec le soutien de



MUSÉE DES BEAUX-ARTS



+ d'infos sur www.chambery.fr

Në librin "Kohë e pamjaftueshme", Helena Kadare rrëfen një episod domethënës nga procesi krijues i Ismail Kadesës. Një muaj pas botimit të romanit "Piramida" në Francë, shkrimtari, duke e shfletuar librin, zbuloi atë që e konsideronte një defekt serioz në strukturën e veprës. Sipas tij, diçka kishte prishur harmoninë e brendshme të romanit. Për disa ditë me radhë ai u mor me problemin me përkushtimin e një inxhinieri që kontrollon qëndrueshmërinë e një ndërtese. Flinte keq, zgjohej natën dhe rikthehej vazhdimisht te teksti. Më në fund shpalli se e kishte gjetur shkaku: "Njëri nga krahët kishte lëshuar bark." Të nesërmen shkoi te botuesi francez dhe i shpjegoi problemin. Edhe pse libri ishte botuar tashmë në një tirazh të madh, pas korigjimit u ribotua nga e para.

Ky episod ngre një pyetje interesante: nëse ndërtimi i një godine mbështetet mbi llogaritje matematikore dhe parime gjeometrike, në ç'mënyrë mund të flitet për matematikë në letërsi?

Në shikim të parë, letërsia dhe matematika duken fusha të largëta nga njëra-tjetra. Njëra merret me emocionet, imagjinatën dhe gjuhën; tjetra me numrat, formulat dhe abstraksionin logjik. Megjithatë, në thelb ato ndajnë një tipar të përbashkët: të dyja ndërtojnë struktura. Matematika krijon sisteme aksiomash dhe marrëdhëniesh logjike për të shpjeguar universin. Letërsia krijon modele të simuluar të jetës njerëzore për të kërkuar dhe zbuluar të vërtetën mbi natyrën e njeriut, konfliktet morale dhe kuptimin e ekzistencës.

Ashtu si matematika, edhe letërsia kërkon abstraksion. Një ekuacion matematikor nuk përshkruan një objekt konkret, por një marrëdhënie universale. Po kështu, një personazh letrar nuk është vetëm një individ i veçantë, por një model përmes të cilit shqyrtohen sjellje, konflikte dhe ide që tejkalojnë kufijtë e një historie të vetme. Të dyja disiplinat i kërkojnë mendjes njerëzore të imagjinojë atë që nuk mund të preket drejtpërdrejt.

Të dyja testojnë kufijtë e mendimit. Të dyja kërkojnë intuitë, imagjinatë dhe aftësi për të zbuluar modele të fshehura. Jo rastësisht, Albert Ajnshtajni shprehej se: "Logjika do t'ju çojë nga A në B; imagjinata do t'ju çojë kudo." Pikërisht imagjinata është ura që bashkon matematikën dhe letërsinë. E çliruar nga kufijtë e së zakonshmes, ajo e çoi veprën e Ismail Kadare drejt horizonteve të pafundme të krijimit artistik. Përmes veprës letrare, Kadare emancipoi rrënjësisht vetëdijen kulturore të shoqërisë shqiptare. Mbështetësit e kësaj pikëpamjeje janë të paktë në Shqipëri. Përballë një shumice kundërshtuese që shpesh e imponon debatin me ashpërsi, ata mjaftohen ta përmbledhin rëndësinë emancipuese të veprës së tij me një pohim të vetëm: "Të paktën, Kadareja na mësoi si të lexojmë." Por sa të vërtetë ka ky pohim, në të vërtetë? Emancipim do të thotë, akti ose procesi i çlirimit të dikujt nga kontrolli, pushteti ose autoriteti i një tjetri. E kundërta e emancipimit – indoktrinimi, trushplarja ose procesi i skllavërimit.

Kur flitet për rol çlirimi nga kontrolli i një autoriteti (emancipues) të letërsisë së Kadesës, pyetja themelore është: cilat ishin "armët" që ai përdori? Shumë lexues e studjues e konsiderojnë Kadarenë një shkrimtar të vërtetë që në pasqyrimin e përvojës njerëzore, duke i dhënë asaj një vlerë universale. Si për çdo shkrimtar është një mënyrë për të hetuar natyrën njerëzore, fatin, të keqen, dashurinë, kujtesën dhe misteret e historisë njerëzore.

Mendoj se një faktor i rëndësishëm në formimin e këtij vizioni ishte përvoja e tij në Moskë. Atje ai u përball me tradita të fuqishme letrare, por edhe me mekanizmat e censurës shtetërore. Për një shkrimtar të ri, ky ishte një mësim i dyfishtë. Nga njëra

Letërsia si matematikë: një libër ushtrimesh për intelektin e njeriut

Nga Minella Aleksa

anë njihje letërsinë e madhe ruse; nga ana tjetër shihte sesi pushteti përpiquej të kontrollonte krijimtarinë. Veprat e rëndësishme të letërsisë ruse kishin kaluar përmes përplasjeve të ashpra me censurën. "Shpirtrat e vdekur" të Gogolit ishte penguar disa herë nga censura cariste, ndërsa "Mjeshtri dhe Margarita" i Bulgakovit mbeti i pabotuar për dekada në Bashkimin Sovjetik. Këto përvoja i treguan Kadesës se si pushteti përpiquej të kufizojë imagjinatën dhe se si letërsia zhvillon strategji për t'i mbijetuar këtij kufizimi. Paradoksisht, shumë prej çësorëve që vepronin në Tiranë ishin formuar në të njëjtën kulturë politike dhe intelektuale lindore. Ata njihnin të njëjtat metoda kontrolli dhe mbështeteshin në të njëjtën logjikë ideologjike. Për këtë arsye, marrëdhënia midis shkrimtarit dhe çësorës u shndërrua në një lojë komplekse inteligjence, ku secila palë përpiquej të parashikonte lëvizjet e tjetrës.

Armët e tij nuk ishin armë politike

në kuptimin e zakonshëm të fjalës. Ishin krijesa të imagjinatës së tij të pakufishme, instrumente letrare me precizion të jashtëzakonshëm, të ndërtuara për të depërtuar aty ku gjuha e drejtpërdrejtë nuk mund të mbërrinte. Përmes tyre ai krijoi hapësira lirie brenda një sistemi që synonte kontrollin e mendimit. Vetë Kadare ka pohuar se në Moskë kuptoi më mirë se si nuk duhej të shkruante. Kjo mund të tingëllojë paradoksale, por pikërisht përballja me kufijtë e imponuar nga censura e ndihmoi të zhvillonte mënyrat e tij të tërthorta të shprehjes. Alegoria, simboli, miti dhe nënteksti u bënë instrumentet-armët, përmes të cilave ai mund të komunikonte me lexuesin pa ju nënshtruar plotësisht gjuhës zyrtare të regjimit.

Ato nuk ofrojnë gjithmonë përgjigje të gatshme; përkundrazi, kërkojnë interpretim, krahasim, deshifrim dhe reflektim. Kjo bën që të funksionojnë su ushtrime të inteligjencës.

Nëse matematika mëson si të arsyetohet, letërsia e madhe mëson si të kuptohet njeriu. Kur këto dy cilësi bashkohen, lind ajo formë e kulturës që nuk prodhon thjesht informacion, por vetëdije.

Kur "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" u botua në Francë në vitin 1970, ai u shndërrua në një ngjarje të rëndësishme letrare. Vepra depërtoi përmes perdes së hekurt dhe dëshmoi se letërsia autentike mund të lindte edhe në kushtet e izolimit më të skajshëm politik. Lexuesit dhe intelektualët francezë u habitën, që një autor i ri nga Shqipëria e mbyllur e Enver Hoxhës të kishte krijuar një roman me vlera universale, krejtësisht të dallueshëm nga modelet propagandistike, që zakonisht identifikoheshin me vendet komuniste.

Në Shqipëri, pritsmëria zyrtare ishte krejt tjetër. Sipas normave të realizmit socialist, lufta duhej të paraqitej si një epopë triumfi, heroizmi dhe fitoreje ideologjike. Partizanët duhej të ishin figura të idealizuara, ndërsa historia duhej të rrëfehej sipas një skeme të qartë morale dhe politike. Kadare zgjodhi një rrugë krejt të ndryshme. Në vend të një heroi shqiptar triumfues, ai vendosi në qendër një gjeneral italian, të ngarkuar me detyrën absurde të mbledhjes së eshtrave të ushtarëve të rënë. Në vend të lavdisë së luftës, ai ofroi atmosferën e zymtë të varrezave, baltës, shiut dhe kujtimeve të kalbura nga koha.


Në roman nuk ka beteja heroike. Lufta nuk paraqitet si aksion ushtarak, por si një makth burokratik dhe ekzistencial. Gjenerali përfaqëson njeriun e formuar nga propaganda, krenaria kombëtare dhe mitet romantike të luftës. Ai nuk është domosdoshmërisht fajtor; është produkt i kulturës dhe ideologjisë që e ka formësuar. Mirëpo, ndërsa përballet me realitetin grotesk të misionit të tij – me kufoma të dekompozuar, me kujtime mizorish dhe me armiqtësinë e heshtur të vendasve – bindjet e tij fillojnë të shëmben njëra pas tjetrës. Romani e çmonton gradualisht iluzionin e lavdisë ushtarake, duke zbuluar pas saj vetëm shkatërrim, absurditet dhe degradim moral.

Një nga arritjet më të mëdha të veprës është arkitektura e saj e brendshme. Kadare ndërton një ekuilibër të rrallë midis realizmit të zymtë dhe një poetike moderne, ku peizazhi, atmosfera dhe simbolika fitojnë po aq rëndësi sa vetë ngjarjet. Lexuesit më të vëmendshëm dalluan se romani funksiononte në dy nivele njëkohësisht. Në sipërfaqe ishte historia e kthimit të të vdekurve në atdheun e tyre. Por nën të shtrihet një rrjet alegorish politike, refleksionesh mbi fajn historik dhe kritikash ndaj mënyrës se si pushtetet manipulojnë kujtesën kolektive.

Pikërisht këtu qëndronte forca subversive e romanit. Kadare nuk e sulmonte drejtpërdrejt sistemin. Ai ndërtonte një ekuacion letrar me disa të panjohura, i hapur për interpretime të ndryshme. Lexuesi mund ta lexonte si një roman për luftën, por mund ta lexonte edhe si një reflektim mbi pushtetin, propagandën dhe raportin e individit me shtetin. Kjo shumëkuptimësi e largonte veprën nga dogma ideologjike dhe e afronte me letërsinë moderne europiane.

Shumë lexues mbetën të habitur nga fakti se po lexonin një roman për luftën, por nuk gjenin luftë në kuptimin tradicional të fjalës. Shkrimtari e zhvendoste vëmendjen nga fituesit te viktimat, nga heronjtë te të vdekurit, nga triumfi te dështimi. Përmes letrave, kujtimeve dhe rrëfimeve individuale, ai shqyrtonte pasojat njerëzore të konfliktit. Tragjedia mishërohej te viktimat, ndërsa humori i zi shënjestronte pompozitetin e gjeneralit dhe iluzionet që ai përfaqësonte.

Ndërsa misioni përparon, gjenerali transformohet. Përballë pafundësisë së varreve, krenaria e tij fillon të zbehët dhe zëvendësohet nga dëshpërimi. Po jetonte



një realitet të përmbysur. Ai kupton se lufta nuk prodhon lavdi, por plagë që vazhdojnë të ekzistojnë shumë kohë pas përfundimit të saj. Në këtë mënyrë, Kadare me nëntekst dëshmon se luftërat nuk mbarojnë kur nënshkruhen traktatet; ato vazhdojnë të jetojnë në kujtesën individuale dhe kolektive të brezave. Si meditim universal mbi fatin njerëzor.

Përmes një lenteje ekzistencialiste dhe alegorike mes rreshtave, romani shpreh gjithashtu një kritikë të fshehur ndaj çdo sistemi që e redukton njeriun në funksion të shtetit. Jeta individuale shndërrohet në material të konsumueshëm për makinerinë politike. Hierarkitë ushtarake, gradat dhe dekoratat humbin kuptimin përballë faktit universal të vdekjes. Në fund mbetet vetëm një "ushtri e vdekur", një masë anonime njerëzish të shndërruar në statistika.

Një element veçanërisht i rëndësishëm është fakti se Kadare shmang vështrimin e drejtpërdrejtë mbi Shqipërinë komuniste. Ai e filtron të gjithë historinë përmes syve të një të huaji, një gjenerali italian. Nuk mund të thoshte se jetojmë në diktaturë, lexuesve u tregonte se si funksiononin diktaturat e tjera europiane, sillte paralele me fashizmin e Musolinit dhe nazizmin hitlerian dhe i linte ata të nxirrnin vetë përfundimet.

Në thelb, Kadare e vendoste lexuesin përballë një dileme ekzistencialiste: të mbetej një subjekt pasiv, i nënshtruar ndaj sistemit dhe logjikës së tij, apo të përpiquej të afirmohej si individ i lirë, me dinjitet, ndërgjegje, të drejta dhe përgjegjësi në shoqëri. Kjo zgjedhje nuk shpallej drejtpërdrejt, por buronte natyrshëm nga alegoritë, simbolet dhe nëntekstet që përshkojnë veprën e tij.


Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e lexuesve arriti t'i përthithte plotësisht këto shtresime filozofike. Për këta lexues, veprat e Kadaresë nuk ishin thjesht romane, por ushtrime të lirisë së mendimit, zbulesa të mundimshme për të vënë në dyshim realitetin e imponuar nga pushteti.

Me romanin "Përbindëshi", intensiteti i kritikës së Kadaresë ndaj sistemit totalitar rritet ndjeshëm. Gjuha alegorike bëhet më e mprehtë, simbolika më e dendur dhe nënteksti politik më sfidues. Nëse në "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur" kritika fshihej kryesisht pas reflektimit mbi luftën, kujtesën dhe absurditetin e historisë, te "Përbindëshi" fokusohet më qartë te mekanizmat e frikës dhe kontrollit politik.

Përmes personazhit Gent Ruvina, Kadare ndërton një nga metaforat e tij më të fuqishme për natyrën e pushtetit. Kur Ruvina pohon se kishte krijuar "diçka midis realitetit dhe ëndrrës, midis së përkohshmes dhe të përrjetshmes", ai nuk përshkruan thjesht një objekt të jashtëzakonshëm, por një mekanizëm simbolik që tejkalon kufijtë e një epoke të caktuar historike. Kali prej druri, i frymëzuar nga miti i Trojës, transformohet në një makinë universale të frikës. Me këmbët të mbështetura në mit dhe me kokën të kthyer nga moderniteti, ai mishëron aftësinë e pushtetit për të ricikluar të njëjtat metoda kontrolli në forma të ndryshme historike.

Përbindëshi ushqehet nga ankthi kolektiv. Ai nuk ka nevojë të përdorë gjithmonë dhunë të hapur; mjafton prania e tij e paqartë dhe kërcënuese në periferi të qytetit, për të paralizuar mendimin kritik. Në këtë kuptim, kali prej druri bëhet metaforë e çdo sistemi që prodhon vazhdimisht frikë, pasiguri dhe armiq imagjinare për të justifikuar zgjerimin e kontrollit mbi individin. Të mos harrojmë se "Zeusi" në Tiranë përgatitej për luftën kundër burokratizmit, të fshirjes së burokratve me fshesë të hekurt, nënkupto intelektualët. Po shkohej drejt një bote gjithnjë e më të mbyllur dhe autoritare.

Vepra ulexua si mbrojtje e individualitetit kundër projektit ideologjik të krijimit të "njeriut të ri".



Në sfond dallohej pamja ciklike e historisë. Kadare sugjeron se koha nuk zhvillohet gjithmonë si një vijë e drejtë progresi. Përkundrazi, ajo ngjan me një rrotë që rikthen vazhdimisht motive, modele dhe përvoja të ngjashme.

Fryma subversive ishte e rëndë. Pas pak ditësh erdhi bllokimi. Mendoj është me vlerë të theksohet se gjurmët e studimeve të Kadaresë në Moskë sugjerojnë një njohje të mirë prej tij të parimeve të psikologjisë së Carl Jung-ut. Koncepte si "arketipet", "subkoshienca kolektive", apo figurat simbolike që përsëriten në mite dhe histori, mund ta ndihmojnë lexuesin t'i kuptojë më thellë disa shtresa të tekstit. Nëse lexuesi zotëron këto baza jungiane, alegorisë Kadareane i shton një shtresë interpretimi më shumë, leximi pasurohet si përjetim i thellë emocional. Sa më shumë interpretime lejon një simbol, aq më gjatë jeton ai në kulturë. Kali i Trojës te Kadareja nuk jep një përgjigje; ai shumëfishon pyetjet.

Në vazhdim pa dritën e botimit "Kronikë në gur", "Eskili ky humbës i madh" etj, etj. Me veprën letrare të Kadaresë, kultura shqiptare po përjetonte një betejë njëherazi imagjinare dhe reale, një konflikt sa simbolik aq edhe konkret, një përplasje titanësh në fushën e ideve dhe të përfytyrimit.

Me romanin "Pallati i Ëndrrave", Ismail Kadare ndërtoi një nga alegoritë më të fuqishme të mbikëqyrjes totale në letërsinë moderne shqiptare. Mesazhi i tij është se tirania arrin formën e saj më ekstreme kur shteti nuk kontrollon më vetëm veprimet e qytetarëve, por depërton deri në territorin e fundit të privatësisë njerëzore: nënndërgjegjen. Në këtë univers, ëndrrat nuk i përkasin më individit; ato trajtohen si dëshmi të mundshme kundër shtetit. Përmes kësaj metafore, Kadare paralajmëron dhe lexuesi nënkupton terrorin totalitar, absurditetin e pushtetit absolut dhe dhunën psikologjike që ushtrojnë diktaturat mbi mendjen njerëzore.

Romani shpalos gjithashtu mekanizmat me të cilët perandoritë dhe regjimet autoritare ruajnë pushtetin e tyre. Ato synojnë të kontrollojnë kujtesën kolektive, të deformojnë të vërtetën dhe t'i shkëpusin individët nga identiteti i tyre historik. Kadare tregon se sa lehtë një njeri i zakonshëm mund

të korruptohet nga një sistem tiranik dhe të shndërrohet gradualisht në një instrument të shtypjes. Burokracia mbikëqyrëse e shtetit paraqitet si një labirint i pafund dhe i padepërtueshëm, ku askush nuk arrin të kuptojë plotësisht qendrën e pushtetit, por të gjithë i nënshtrohen asaj.

Kadare e fragmenton forcën politike të diktaturës në mekanizma abstraktë, pothuajse matematikorë. Ashtu si një matematikan që ndërton një formulë të re, ai organizon rrëfimin me logjikë të rreptë, simbolikë të saktë dhe arkitekturë narrative të kontrolluar. Për pasojë, shtypja nuk shfaqet kryesisht si shpërthim emocionesh apo konfliktesh individuale, por si funksionim mekanik i një sistemi që zbaton rregullat e veta me saktësi të pamëshirshme.

Kështu ndodh dehumanizimi i dyfishtë: humbet humaniteti si i shtypësit, ashtu edhe i të shtypurit. E keqja banalizohet dhe shndërrohet në rutinë administrative. Sistemi vepron si një makinë logjike që teston vazhdimisht kufijtë e moralit, qëndrueshmërisë dhe besnikërisë njerëzore.

Kadare i zhvesh ngjarjet nga teoritë e ndërlikuara politike dhe i redukton ato në marrëdhënie të pastra shtypjeje. Nën presionin e vazhdueshëm, individët fillojnë të humbasin orientimin ndaj së vërtetës. Ata deformojnë realitetin, krijojnë rrëfime të rreme dhe fundosen në paranojë. Vetë nënvetëdija kolektive bëhet objekt monitorimi. Aparati shtetëror i përkul personazhet derisa ata të dorëzohen, të bëjnë kompromise ose të përfundojnë në izolim ekzistencial. Revista "Letërsia Botërore sot" (WLT) e nominoi për "Çmimi Neustadt" (Nobeli amerikan) me këtë motivacion: "Askush që nga Kafka nuk është thelluar në mekanizmin infernal të pushtetit totalitar dhe ndikimin e tij në shpirtin njerëzor në një thellësi aq hipnotike sa Kadare".

Nuk mendoj se një lexues "gabon", sepse nuk i pëlqen letërsia e Kadaresë. Mendoj se gabon ai që anashkalon subjektivitetin e artit. Subjektiviteti i shijes letrare formohet nga ndërthurja e tri elementeve: aftësia e tekstit për të ngjallur emocione të forta, sfondi kulturor dhe përvojat unike të jetës së individit. "Në rastin e letërsisë së Kadaresë

pas termit "subjektivitet" mendoj se fshihet edhe një shkallë pamundësie për të kuptuar nëntekstet e stilit kadarean. Nuk është e lehtë t'i thuhet një "lexuesi entuziast" se nuk e ka kapur thelbin e një krijimi letrar. Pse?, sepse i vë në dyshim aftësitë abstraguese-imagjinative me pasoja kuptimore të dyshimta. Sepse truri i njeriut përpunon vetëm atë që është i përgatitur të deshifrojë; po nuk e kuptoi truri, syri mbetet i verbër. Shikon mëndja, jo syri, thotë populli. Për rrjedhojë, reagimi i vërtetë emocional shpërthen instinktivisht vetëm atëherë kur teksti kuptohet plotësisht. Kjo përbën edhe "aksiomën" e parë të letërsisë: Një nga aksiomat e pashkruara të letërsisë është se jetëgjatësia estetike e një veprë nuk mund të reduktohet në suksesin e saj tregtar. Një libër mund të pushtojë vitrinat pa pushtuar mëndjet. Realiste është të thuash se, reagimi i fortë zbulon aspektet më personale dhe unike të lexuesit, vlerat, kujtimet, traumat, dëshirat, frikërat dhe përvojat e tij. Prandaj, shpërfilla e një veprë klasike thjesht sepse "nuk më pëlqen", shpesh tregon një dështim për të rrokur mjetet stilistike, kontekstin historik, dimensionet filozofike, simbolike dhe psikologjike. Kultivimi i shijes së mirë është një proces aktiv që kërkon angazhim dhe mësim. Librat klasikë i mbijetojnë kohës sepse tejkalojnë prirjet individuale dhe prekin të vërtetat universale, duke e kthyer vlerësimin në një ndërthurje të përjetimit personal me meritën objektive. Kadareja është përfaqësuesi tipik i kësaj letërsie: ai të lodh, të sfidon dhe kërkon një involvim të lartë intelektual, duke përjashtuar plotësisht argëtimin pasiv. Një nga tiparet që kritika i ka vënë re shpesh te vepra e Ismail Kadare është prania e "fundeve të hapura", të paqarta ose që lënë fije të qëllimshme të pazgjidhura. Fundet e palidhura përbëjnë "kurthin" e magjepsjes që autori ngre për lexuesin. Personazhet, ngjarjet dhe simbolet nuk përfundojnë gjithmonë në një përfundim të qartë, sepse synimi nuk është qetësimi i lexuesit, por vazhdimi i shqetësimit të tij. Fundet e palidhura te Kadareja pasqyrojnë një botë ku historia, pushteti dhe fati njerëzor rrallë japin përgjigje përfundimtare. Vepra si Pallati i Ëndrrave, Prilli i Thyer, Kronikë në Gur, Piramida, Doruntina, etj, nuk mbarojnë në faqen e fundit, mbarojnë kur lexuesi ndalon së interpretuari. Këtu qëndron Enigma dhe Mrekullia e veprës së Kadaresë.

Ashtu si në matematikë, edhe në letërsi, sa më e lartë të jetë shkalla e kompleksitetit, aq më i kufizuar priret të jetë publiku që e ndjek. Duhet mbajtur parasysh se ajo që na prek thellë në një libër, flet po aq për ne, sa edhe për librin. Shitësit e rrallë që në jetë janë marrë vetëm me shitjen e librit, një prej tyre thoshte: "Kur dikush thotë: 'Kam shitur mijëra kopje, unë pyes veten...sa prej tyre janë kthyer si dhuratë e padëshiruar për Krishtlindje?' Ka një vlerësim të pranuar në nivels studjuesish të letërsisë se, letërsia elitare në Perëndim vlerësohet jo më shumë se sa midis 2-4 përqind të shitjeve të përgjithëshme të librave. Arsyja gjendet te aksioma: 'Vlera e një veprë nuk matet nga numri i lexuesve, por nga thellësia e gjurmës që lë tek ata'. Shumë lexues ndjekin autorët siç ndjekin modën: sot i adhurojnë, nesër i harrojnë. Nuk është për një stinë. Na pëlqen apo jo, letërsia e Kadaresë mbetet një ekuacion kompleks. Ajo tërheq ata që duan të eksplorojnë anën gri dhe të errët të njeriut, e jo thjesht ndarjet bardhezi. Që të hysh në botën e tij surreale, të duhet një "hartë" e përbërë nga gjuha ezopike, historia ballkanike dhe mitologjia klasike. Vetëm kështu mund të ecësh në territorin ku historia shkrihet me legjendën. Sa më shumë e lexon Kadarenë, aq më shumë shtohen të panjohurat e ekuacionit. Koha tregoi se betejën me çensurën e fitoi shkrintari.

Është e vështirë të ketë një problematikë nga letërsia shqipe, që të mos ketë tërhequr vëmendjen dhe të mos jetë shqyrtuar me kompetencë e thellësi nga kritiku i shquar, Rexhep Qosja. Ky studiues, ka arritur që ta interpretojë nga shumë rrafshet letërsinë shqipe: në *sinkroni* dhe në *diakroni* të saj, në zhanret dhe profilet e spikatura krijuese, duke dëshmuar një zotërim si rrallë kush tjetër, të formacionit mjaft dinamik e asimetrik të kësaj letërsie.

Ka botuar disa libra me studime dhe kritikë letrare, nga të cilat, mund të veçojmë: "Dialogë me shkrimtarët" (1968), "Kontinuitete" (1972), "Panteoni i rralluar" (1973), "Shkrimtarët dhe periudha" (1975), "Anatomia e kulturës" (1976) etj. Në këto përmbledhje ka jo pak studime, ku herë pas here shqyrtohen dukuri substanciale të frymës së periudhës së romantizmit në letërsinë shqipe, vështruar ky romantizëm në raportet e tij me poezinë popullore dhe me romantizmin evropian. Ky interesim i ngulët për këtë periudhë letrare, duket se buron nga bindja e studiuesit për rolin dhe misionin e madh të këtij formacioni letrar dhe përtej letrar, si pritëse dhe përthithëse e vlerave të mëdha të mëparshme (qysh nga Buzuku, Budi, Bogdani, Variboba) - dhe pastaj si përcjellëse dhe mjaft ndikuese për zhvillimet e mëvonshme letrare.

Por ky përkushtim i R. Qosjes për studimin e romantizmit në letërsinë dhe në kulturën shqiptare, duket se ishte i lidhur ngushtësisht edhe me kushtet e Kosovës aso kohe. Mesazhet identitare, kulturore e letrare të romantizmit rilindas, sigurisht, që gjenin këtu mjaft jehonë dhe referenca domethënëse dhe studiuesi pati intuitën, guximin dhe marrjen përsipër me tendencë të këtij projekti madhor shkencor. Nuk ishte një projekt thjesht dhe vetëm klasifikues i dukurive dhe profileve letrare të Rilindjes Kombëtare, por para së gjithash, ishte një Projekt Njohës, Krenarie dhe Ndikues mes shqiptarëve, rreth atyre vlerave historike, që tashmë natyrshëm merrnin dhe kishin tingëllimë dhe energji aktuale.

Kështu studiuesi po përgatitej dora dorës për realizimin e veprës së tij jetësore, "ROMANTIZMI" (vëllimi I-II-III, 1984-1986), si pjesë e Historisë së Letërsisë Shqipe, të cilën, kishte projektuar ta realizonte në trajtë tërësore viteve më pas. Por dihet se situatat e vështira të krijuara për Kosovën, veçanërisht në fund të viteve '80-të e në vazhdim, atë, ashtu si dhe mjaft intelektualë të tjerë, do ta shtynin për angazhime të tjera, të cilat, ai i dëshmoi me aktivitetin e tij mjaft aktiv politik e shoqëror. Dhe sidomos do të angazhohej me përgatitjen dhe botimin e një mori librash, me analiza dhe ese të thella e të mprehta politike, të cilat, patën rol mjaft të rëndësishëm - për ta bërë të njohur ndërkombëtarisht çështjen e Kosovës, para dhe pas çlirimit të saj.

Pra, në vargun e çështjeve të trajtuara letrare, R. Qosja i ka kushtuar interes të posaçëm periudhës së "Letërsisë Romantike", duke parë dhe vlerësuar njëherazi atje: zgjim të vlerave të larta artistike dhe zgjim të shpirtit nacional të popullit shqiptar. Romantizmit shqiptar, studiuesi i është referuar në vijimësi dhe gjerazi, duke u ndalur në çështje të rrafshit teorik, por edhe në analiza referuese - mbi vepra të shumë autorëve si: Jeronim De Rada, Zef Serembe, Ndre Mjedja, Andon Zako Çajupi, Pashko Vasa, Filip Shiroka etj. Duhet të kujtojmë se penës së tij të begatë, i takojnë edhe dy vepra të njohura monografike - rreth krijimtarisë së dy prej përfaqësuesve më të shquar të këtij drejtimi letrar: Naim Frashërit (1986) e Asdrenit (1972). Këto studime të gjera monografike, mbeten pa mëdyshje në fondin e studimeve letrare shqiptare - si modele të analizave dhe të sintezave të thella shkencore. Por njëherazi, ato mbeten edhe referenca të forta për çdo studiues tjetër, që do të kishte rastin t'u drejtohej

ROMANTIZMI SHQIPTAR NË STUDIMET E REXHEP QOSJES

Nga Ymer Çiraku

këtyre dy ikonave të ndritura të letërsisë shqipe, Naimit dhe Asdrenit.

Është tashmë e njohur se *Romantizmi* në letërsinë shqipe, ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, të cilët, janë ndalur sipas rastit: në premisa të rrethanave të lindjes së tij, të kontakteve e ndikimeve që ai pati prej rrjedhave romantike të letërsive të tjera europiane, të kryqëzimeve e bashkëpraninë, që ai shfaqti me rryma të tjera letrare, të zhanreve zotëruese dhe të caqeve kronologjike të zgjatjes së kësaj dukurie - në rrjedhat vijuese të letërsisë shqipe etj. Janë një varg studiuesish, të cilët, janë marrë në kohë të ndryshme me këto problematika, ku mes tyre, mund të veçohen: Eqrem Çabej, Arshi Pipa, Dhimitër S. Shuteriqi, Jorgo Bulo, Matteo Mandalà, Floresha Dado, Ali Xhiku, Shaban Sinani...etj.

R. Qosja arrin që t'i bëjë një sintezë integrale misionit, funksionit dhe rolit që mbarti romantizmi shqiptar: si vlerë estetike, gjuhësore, por edhe si vizion filozofik, etik, si dhe mjaft frymëzues dhe ndikues për aksionet e lëvizjes së madhe kombëtare rilindase. Dhe sikundër ai thekson, qysh në hyrjen e veprës së tij të njohur *Historia e letërsisë shqipe*: "Me gjuhën, me gjinitë, me llojet dhe me format, me ligjësitë metriko-ritmike të vargut, me prirjet e saj, me funksionin e saj themelor kombëtar, letërsia e romantizmit shqiptar, objektivist, është mëma e madhe, në të cilën derdhen rrjedhat më të rëndësishme të së shkuarës letrare dhe kulturore dhe prej së cilës, dalin parimet bazë të së ardhmes letrare dhe kulturore në gjuhën shqipe..." (R. Qosja, *Historia e letërsisë shqipe*, vëll. I, Toena, 2000, f.9)

Këtu ai pajtohet me pikëpamjen, të cilën e kishte parashtruar dikur edhe Çabej, brenda konceptit të tezës së tij të njohur mbi periodizimin e letërsisë shqipe përmes funksionimit brenda zhvillimit të saj të "qarqeve kulturore". Sipas kësaj teze, romantizmi i periudhës së Rilindjes Kombëtare, shfaqet si një qark i përbashkët i literaturës nacionale, ku shkrihen e bashkëveprojnë fuqitë e moçme të qarqeve "parakombëtare" - të cilat, derdhen në mënyrë kohezive, në lumin e Letërsisë Nacionale të shekullit të XIX-të (E. Çabej,

Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, MÇM, 1994, f.55)

Është me interes të theksohet se R. Qosja, këtë proces letrar, pra romantizmin e letërsisë shqipe, e shqyrton edhe me një rol/mision paravajtës, domethënë, që ai do të ishte fort i lidhur me zhvillimet e mëpasme të letërsisë shqipe. Çka do të thotë, se, autorët që do të vinin më pas, do t'i kishin përherë referenca të forta frymëzuese e ndikuese veprat më të shquara të këtij formacioni letrar, sikundër ishin ato të De Radës, Naimit, Ndre Mjedjes... Ky raport nuk do të ndihej vetëm me autorët më të afërt vijues për nga koha, por edhe me ata më të mëvonshmit. Dhe nuk do ta dëshmonin këtë marëdhënie thjesht dhe vetëm disa motive të rimarra prej asaj plejade krijuesish, apo rikujtesa e këtyre personaliteteve letrare, nëpër tema e kredo poetike. P.sh. në fillim të viteve '60-të të shekullit të kaluar, kur dogmatizmi soc-realist kishte nisur t'i sofistikonte territoret e veta të hiperideologjizuar, nuk ishin të rastësishme, veç të tjerash, edhe referencat nga modelet estetike të romantizmit, me tundimin për t'i patur dhe ndjekur ato me tendencë si modele estetike. Veçanërisht ishte e dukshme kjo në vlerësimin që i bëhej një autori si De Rada, dhe sidomos kryeveprës së tij "Këngë të Milosaos", e cila, rikujtohej qartazi dhe me tendencë si vepra më novatore e letërsisë shqipe dhe se metaforë e "dritares së hapur përkundrejt detit..." (I.Kadare). Duke përcjellë kështu nënkuptueshëm, filozofinë e nevojës së marrëdhënieve e kontakteve mes kulturave dhe jo zbatimin e doktrinës së izolimit dhe mbylljes ndaj tyre, sikundër predikohej nga ideologjia e kohës. (shih: I. Kadare, Duke lexuar Milosaon, gaz. Drita, 6.12.1964)

Edhe një autor modernist bashkëkohor si Martin Camaj, i cili krijoi një model unik në letërsinë shqipe, ku harmonizohet moderniteti dhe bota arkaiko-mitologjike, sikundër e kanë vretur studiuesit, përcjell gjithsesi në veprën e tij, diçka prej "dikujt". Dhe konkretisht nga romantizmi rilindas, poetika e Camajt duket se ka shenja të thellësisë e lashtësisë së fjalëve dhe kuptimeve (prej De Radës), ka kulturën filologjike dhe shijen klasike (prej Mjedjes),



ka dhimbjen e thellë të Zef Skiroit dhe ndjenjën e lënduar të Zef Serembes. (Sh. Sinani, *Historia e letërsisë shqipe*: Çështje të hapura, Naim, 2015, f. 278)

Është me mjaft interes në këtë vepër të gjerë studimore të R. Qosjes, shqyrtimi i romantizmit shqiptar si një formacion letrar, jo vetëm mjaft dinamik e mjaft ndikues në jetën e shoqërisë shqiptare, por që shfaq edhe një tipologji me variacione estetike, çka buron prej ndikimit të mjedisve, ku ajo letërsia krijohet dhe receptohej. Dihet se për rrethanat e njohura të vështitërsive e pengesave nën pushtimin shekullor otoman, letërsia shqipe e Rilindjes, u krijua kryesisht në kolonitë e shumta shqiptare, nëpër vise të ndryshme të botës, prej nga vinin rrjedhimisht edhe specifikat estetike dhe pasuruese të saj, nën ndikimin e letërsive dhe kulturave vendase. Sikundër konkludon studiuesi: "...Kolonja e Arbëreshëve të Italisë e pasuron rrjedhën e letërsisë shqipe me tipin e romantizmit folklorik dhe veçoritë romantike europiane, Kolonia e Stambollit me racionalizmin dhe iluminizmin, Kolonia e Bukureshtit dhe Kolonia e Kajros me tipin e realizmit të ndrojtur, kurse kolonia e Sofjes me tipin e romantizmit publicistik". (R. Qosja, vep. e cituar, f.43)

Sigurisht, që formacionet letrare nuk janë të ngrira, ato evoluojnë dhe rimodelohen sipas ligjësisë të brendshme të vet këtyre formacioneve. Autori, ashtu sikundër lindjen dhe formimin e romantizmit e shikon te kolonitë shqiptare, po atje e shikon edhe çintegrimin e tij, domethënë lindjen e dukurive të reja posromantike. "Kjo dëshmon, - thekson ai, se struktura ideore dhe stilistike e një letërsie - sikundër edhe e artit përgjithësisht - përbëhet në kohë, por s'mund të jetë as pa vulën e faktorëve kulturorë dhe shoqërorë, që, më në fund, kanë të bëjnë me hapësirën". (po aty)

Brenda konceptimit të romantizmit si proces dinamik, studiuesi arrin të klasifikojë edhe rrjedhat e tij letrare - përmes dy etapave të njohura historike. Dhe konkretisht: etapa para dhe pas *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*. Ky klasifikim, në pamje të parë mund të ngajë si i nisur kryesisht prej premisash jashtëletrare, por në fakt, funksionon brenda përmbajtjes që rrezatoi letërsia shqipe e Rilindjes Kombëtare, e cila, krahas funksionit letrar, njëherazi ishte edhe ideologji kombëtare. Dhe kuptohet se, në strukturën "ideoforme" të kësaj letërsie, Lidhja e Prizrenit, me programin dhe aktivitetin që pati, do të linte edhe këtu gjurmë dhe do të kishte ndikimin e vet substancial dhe aspak periferik.

Në këtë vepër të gjerë studimore, bie në sy se romantizmi shqiptar, shqyrtohet jo me prirjen për nga parashtrime vlerësimesh dhe konkluzione të përgjithshme teorike. Kjo do të ishte një rrugë disi komode dhe pse jo, në vështrim të parë - do të kishte efekt sugjestionues/përshtypjebërës, pikërisht për shpalosje informacionesh globale, të cilat, nuk mungojnë për t'i qëmtuar ato nëpër literaturat e shumta qarkulluese. Por studiuesi ndjek një rrugë tjetër, më të vështirë për nga kahjet hulumtuese, por që bëhet më rezultativ e më bindës për tezat e ofruara. I fortifikuar me formim të thellë teoriko - letrar, ai qaset me përkushtim në tërë procesin e gjerë letrar shqiptar,



et Rexhepi

në tekste dhe kontekste, në prirje dhe individualitete, në autorë të shquar dhe ata minorë (por që ama këta krijojnë sfondin përgatitës dhe nxitës për të tjerët), në mitet dhe ç' integrimet e miteve romanike, në tipologjinë zhanrore dhe në diversitetin e ndikimeve prej kulturash të ndryshme – perëndimore e lindore.

Rol mjaft të rëndësishëm i njeh kësaj letërsie, në përpjekjen obsesive të autorëve të saj për të ashtuquajturin “*estetizmin romantik të gjuhës shqipe*”, si pjesë e projektit nacional rilindas - për të gjetur te kjo gjuhë shtyllën e fortë, e cila, do të siguronte dhe do të ruante fort themelet e *Njësisë së Kombit*. (po aty, f.154) Dhe është i njohur vlerësimi venerues e sublimues i shumë poetëve për gjuhën shqipe, duke e vlerësuar atë, si nga më të lashtat mbi dhë, më të bukurat dhe deri thuhet si *gjuhë perëndije* (N. Frashëri, Gj. Fishta, L. Poradeci, D. Agolli, I. Kadare, Xh. Spahiu...)

Vazhdon ende të mbetet pjesë e debatit shkencor - fryma dhe fizionomia e romantizmit shqiptar, ku janë hedhur teza e pikëpamje për karakterin “*përafërues*” - apo dhe “*largues*”, rreth raporteve të letërsisë romantike shqipe me romantizmin evropian. Ka patur ndikimin e vet këtu edhe ndonjë paragjykim i nisur nga premisa “*etnocentriste*”, për ta interpretuar letërsinë shqipe si të vetmjaftueshme e për për pasojë me vlera veçse tërësisht origjinale, sepse ajo u krijua vetëm brenda kornizave të burimeve të saj autonome (!) Por një vështrim i tillë “*ishullor*” i kësaj letërsie, nuk mundet kurrsesi që t' i sjellë *a priori* prestigj asaj, sikundër mund të mendohet në një vështrim të parë semplist. Përkundrazi, vlerat letrare e kulturore të popujve, veçse rriten e pasurohen - nga komunikimet e ndërsjellta mes tyre. Izolimimet, vetkufizimet konservative e refraktare, veçse do t' i atrofizonin ato gradualisht, që mund të shpinin pastaj deri në shuarje të tyre.

Studiuesi shpalos në studimet e veta një qëndrim koherent, lidhur me “*pikëtakimet estetike*” të romantizmit shqiptar me atë evropian. Ai polemizon me të dy prirjet e skajshme të historianëve të romantizmit shqiptar. Pra, si me ata që e kufizojnë letërsinë romantike shqipe si imitim të letërsive romantike të disa gjuhëve evropiane, ashtu edhe me ata, që pohojnë se ajo letërsi, është shfaqur dhe është formuar stilistikisht, jashtë çdo kontakti e marrëdhënieje me to. Për konceptin e drejtë të këtij studiuesi, “*veçoritë e përbashkëta*”, fare qartazi dëshmojnë lidhjet përvijuese të letërsisë shqipe me letërsinë evropiane. Kurse “*veçoritë origjinale*”, dëshmojnë se edhe shqiptarët, megjithëse një popull i vogël dhe i shtypur gjatë histories së tij, ata janë përpjekur dhe ia kanë arritur me sa ua kanë lejuar kushtet, që ta pasurojnë me veprën e tyre - thesarin e madh dhe të përbashkët të letërsisë dhe të kulturës së popujve të Europës. (R. Qosja, Historia e letërsisë shqipe, vëll. I, Rilindja, f. 379)

Veçoritë e përbashkëta me romantizmin evropian, nga aspekti i përmbajtjes tematike dhe kuptimore, studiuesi i sheh para së gjithash, te përjetimi emocional i realitetit nga autorët romantikë shqiptarë, tek kthimi i tyre në të shkuarën, tek vështrimi gjallërues i natyrës dhe pamjeve planetare. Ndërsa si tipare të kompozicionit e të ligjërimit poetik, veçon fatalizmin, lirizmin, fragmentarizmin, lojën e nëntekstit, kombinimet zhanrore, në mjaft prej këtyre veprave. Kurse për nga aspekti i karakteristikave të tij origjinale, romantizmit shqiptar, ai i vë në dukje synimet konstante në krijimin e miteve në lëvrimin e temës historike, në kultin e gjuhës kombëtare, në kultin e ardhmërisë, në mbështetjen e fortë tek thesari i krijimtarisë popullore, në iluminizmin kombëtar, në didaktizmin dhe utilitarizmin e drejtpërdrejtë - për përcjelljen e ideve poetike. (shih po aty, f. 378)

Kontaktet dhe ndikimin më evident të romantizmit shqiptar prej atij evropian, studiuesi i vren tek letërsia arbëreshe, e sidomos tek Jeronim De Rada, Zef Serembe e Gavril Dara i Riu. Sigurisht, që vepra deradiane, e përfaqëson në mënyrën më të spikatur këtë dukuri të letërsisë shqipe romantike. E sidomos vepra e tij “*Kënga të Milosaos*”, sikundër e pati vënë në dukje edhe Eqrem Çabej, për soliditetin artistik që ajo vepër manifeston “*...mbetet një nga ato fort të pakta vepra të letërsisë shqiptare, që e bëjnë këtë të përfaqësohet në letërsinë botërore...*”

Veçanërisht kjo vepër, e dalluar qartazi për vlerat e saj të larta artistike, do ta rrëzonte edhe atë pikëpamje tashmë të tejkaluar, për gjasme “*romantizmin e vonuar shqiptar*”, kur ky romantizëm, rezultoi të jetë jo vetëm i njëkohshëm me atë të vendeve të tjera ballkanike, por edhe i denjë për t' u krahasuar me letërsinë evropiane, si në rastin e veprës së De Radës. Pra, kjo vepër mund të meritojë që të klasifikohet pa kurrfarë rezerve, jo vetëm si e para vepër në zhanrin e “*romanit të parë në vargje*” në letërsinë shqipe (1836), por që nga pikëpamja kronologjike, është e njëkohshme me aso modele të romantikëve të mëdhenj evropianë si: Viktor Hygo, Pushkin etj. (I.Kadare)

Sigurisht, që drejtimi i romantizmit nuk është një proces letrar statik. Ai u përgatit prej traditave paraprijëse, por edhe vet, krijoi premisa për lëvizjet e tjera të reja letrare shqiptare. Autorë të njohur të formatit romantik si: Asdreni, Çajupi, Ndoc Nikaj, Gjergj Fishta, Mihal Grameno, Hilë Mosi etj do të bëjnë sipas rastit, kapërximet e natyrshme estetike drejt krijimtarisë së tyre me prirje sipas rastit: realiste, neoklasiciste, simboliste...Në vitet '20-'30 të shekullit të kaluar, këto prirje të larmishme do të “*bashkëzërojnë*”, sikundër shprehet figurativisht studiuesi. Dhe ky bashkëzërim, shfaqet dhe është i pranishëm si dukuri: brenda procesit tërësor letrar, apo edhe brenda krijimtarisë së një autori.

Ky dimension “*pluri-estetik*” i letërsisë shqipe, nga pikëpamja e formacionit të metodave dhe shkollave letrare, i ka dhënë asaj një profil mjaft të larmishëm e origjinal. Vërtet është letërsi e një populli të vogël e me qendra të kufizuara kulturore, por që shfaqet me variacione impresionuese orientimesh stilistike. P.sh Lasgush Poradeci, Fishta, Migjeni, Fan Noli, Mitrush Kuteli, Faik Konica, Koliqi dhe autorë të tjerë, në krijimtarinë e tyre, përpara lexuesit dëshmojnë tekste, që janë të dallueshëm e të largët stilistikisht mes tyre. Edhe pse kulturalisht apo gjeografikisht ata mund të ishin të afërt, në krijimtarinë e tyre, shfaqnin formime dhe interesa të largëta estetike mes tyre dhe ky, ishte një “*largim pozitiv*”, që i sillte vlerë kësaj letërsie nga aspekti estetik.

Në konkluzion, mund të thuhet se interpretimi i romantizmit shqiptar tek studiuesi Rexhep Qosja, ka arritur që të realizojë një rrokje sa gjithëpërfshirës të këtij formacioni të fuqishëm letrar, aq edhe me sintheza të thella e bindëse. Ato janë piketa të forta e të sigurta për ta njohur dhe për ta interpretuar këtë formacion letrar. Por janë edhe nxitje për t' i çuar më tej hulumtimet rreth këtij argumenti. Duke qënë të autoritetshme për nga thellësia teorike dhe informacioni i pasur referues, këto teza e pikëpamje nuk duket se krijojnë kurfarë ndikimi frenues. Përkundrazi, ato nxitin dhe ndihmojnë debatin - për kërkime dhe rezultate të mëtejshme alternative. Sepse këto janë teza të begata *ndërtuese e jo rrënuese*, ku shfaqet filozofia e vështrimit me perspektivë e këtij fenomeni letrar. I cili, si krijimtari e begatë letrare, u krijua nga një varg krijuesish, veçse si projekt fort atdhetar dhe iluminist i realizimit të një endërrë.

Pra, i realizimit të një të ardhmeje për shqiptarët.

JULIAN BARNES FITON ÇMIMIN PRINCESHA E ASTURIAS

Julian Patrick Barnes (Leicester, Mbretëria e Bashkuar, 19 janar 1946) studioi Gjuhë Moderne në Magdalen College të Oksfordit. Më pas punoi për tre vjet si leksikograf për Oxford English Dictionary, si edhe si kritik letrar dhe televiziv dhe redaktor për New Statesman dhe Sunday Times. Ka qënë gjithashtu kolumnist për *The Observer* dhe *The New Yorker*. I cilësuar si postmodernist për romanet dhe tregimet e tij dhe i konsideruar si një nga zbulimet më të rëndësishme të letërsisë angleze në dekadat e fundit, Julian Barnes botoi librin e tij të parë, *Metroland* (1980), i cili fitoi Çmimin Somerset Maugham në vitin 1981. Dy vjet më vonë ai botoi *Before She Met Me* (1982). Në vitin 1984 ishte finalist për Çmimin Booker me romanin e tij të tretë, *Papagalli i Floberit*, i cili fitoi Çmimin Geoffrey Faber Memorial dhe Prix Médicis. Ai u rikthye në listën finale të Booker-it në vitin 1998 me *England, England* dhe në vitin 2005 me *Arthur & George*. Më pas botoi *Staring at the Sun* (1986), *A History of the World in 10½ Chapters* (1989), *Talking It Over* (1991) – dhe vazhdimin e tij, *Love, etc.* (2000) – si edhe *The Porcupine* (1992). Në vitin 2011 fitoi më në fund Çmimin Booker për romanin *Enigma e një fundi* (2011). *The Noise of Time* (2016), *The Only Story* (2018) dhe *Elizabeth Finch* (2022) janë ndër veprat e tij më të fundit.

Me pseudonimin Dan Kavanagh, Barnes ka shkruar edhe romane kriminale: *Duffy* (1980), *Fiddle City* (1981), *Putting the Boot In* (1985) dhe *Going to the Dogs* (1987). Ai ka botuar gjithashtu përmbledhje tregimesh si *Cross Channel* (1996), *The Lemon Table* (2004) dhe *Pulse* (2011). Ndër veprat e tjera të tij përfshihen *Letters from London* (1995), librat me ese *Something to Declare* (2002), *Through the Window* (2012), *Keeping an Eye Open: Essays on Art* (2015), *The Pedant in the Kitchen* (2003) dhe *Changing My Mind* (2025), si dhe librat me kujtime *Asgjë për t'u trembur* (2008), *Levels of Life* (2013) dhe *Departure(s)* (2026), me të cilin ka shpallur tërheqjen e tij nga letërsia. Ai është gjithashtu autor i biografisë së Samuel Jean de Pozzi-t, *The Man in the Red Coat* (2019).

I angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ai merr pjesë në veprimtarinë e organizatave Freedom from Torture dhe Dignity in Dying. Përveç çmimeve të përmendura më sipër, atij iu akordua Çmimi i Jerusalemit në vitin 2021 dhe ka marrë, ndër të tjera, Çmimin E. M. Forster të Akademisë Amerikane të Arteve dhe Letërsisë (1986), Prix Femina Étranger për *Love, etc.* (Francë, 1992), Çmimin Shtetëror Austriak për Letërsinë Evropiane (2004) dhe Çmimin David Cohen për Letërsi (Mbretëria e Bashkuar, 2011). Në vitin 2004 u nderua me titullin Kalorës i Urdhrit Francez të Arteve dhe Letërsisë.

Siç përcaktohet në Statutin e Fondacionit, Çmimet Princesha e Asturias synojnë të shpërblejnë “veprimtarinë shkencore, teknike, kulturore, shoqërore dhe humanitare të zhvilluar në nivel ndërkombëtar nga individë, institucione ose grupe individësh apo institucionesh”. Në përputhje me këto parime, Çmimi Princesha e Asturias për Letërsinë jepet në vlerësim të “veprës për nxitjen dhe zhvillimin e krijimtarisë letrare në të gjitha gjinitë e saj”.



Edicioni i parë i “Java e Muraleve Arbëreshe”, i organizuar nga shoqata Fili Meridiani APS dhe i mikpritur në Pallagorio nga data 3 deri më 9 qershor 2026, lindi për të forcuar lidhjet e thella që ekzistojnë midis Arbërisë kalabreze dhe Kosovës. Përmes artit bashkëkohor, kujtesës, gjuhës dhe traditës, ky aktivitet krijoi një hapësirë të rëndësishme dialogu dhe takimi. Ky shkëmbim vlerash artistike dhe njerëzore u mundësua nga prania e profesoreshës Lebibe Topalli — dekanë e Fakultetit të Arteve të Aplikuara në Universitetin e Ferizajt dhe drejtoreshë e Mural Fest Kosova — së bashku me katër studentë të këtij universiteti. Puna e tyre solli në jetë pesë murale të mrekullueshme në fasadat e disa shtëpive të fshatit, të frymëzuara nga traditat dhe motivet e përbashkëta mes Shqipërisë, Kosovës dhe botës arbëreshe. Këto vepra u konceptuan si pasuri e komunitetit dhe sollën një energji të re në këtë zonë të brendshme, duke nxitur një refleksion mbi identitetin e përbashkët dhe vlerën e kulturës që na bashkon.

Mes të pesë kryeveprave, murali i realizuar nga artistja e re Rema Salihu shpreh një lidhje mjaft intime midis artit dhe letërsisë. Vepra lindi me dy qëllime: të nderojë kujtimin e eksodit gjatë luftës në Kosovë dhe të vlerësojë Atë Elia (Sergio) Spezzano-n, prift dhe poet i lidhur me komunitetin e Pallagorio-s. Përmes poezisë së tij “Ai morti di Pristina” (“Të vdekurve të Prishtinës”), ai krijoi një urë vëllazërimi midis popullit arbëresh dhe komunitetit shqiptar të Kosovës.

Këtij bashkimi mes artit pamor dhe fjalës poetike mund t'i shtohet, si një zgjerim natyral, jehona e romanit *Bartësi i shpirtave të përzënë* dhe e tregimit me të njëjtin titull nga përmbledhja *Kthimi i babait - Tregime* e shkrimtarit Adil Olluri. Kur shikon pikturën, ndjen se si arti vizual materializon një moment të saktë të rrëfimit — atë çast dramatik të mbërritjes në kufi —, duke e kthyer bojën e shkrimit në ngjyrë dhe faqen e librit në vija me ndikim të fortë ekspresiv.

Motivi qendror i muralit është ikja. Vizualisht, në skenë dominon figura e një nëne që shtrëngon në krahë — ndoshta — një vajzë të vogël. Kësaj të fundit nuk i shihet fytyra, por vetëm një kapuç i kthyer prapa, sikur dëshiron të fiksojë në kujtesë, me çdo hap, tokën që po lë pas. Pranë tyre shfaqen dy fëmijë të tjerë: njëri i kthyer me shpinë dhe tjetri me fytyrë gjysmë të dukshme. Nuk mund të thuhet nëse ata janë pjesë e skenës kryesore apo fragmente të historive të tjera të dhimbjes, të shpërndara si kujtime të shkëputura. Pika qendrore e të gjithë vizatimit është vështrimi i gruas drejt së panjohurës, drejt një horizonti të papërcaktuar që mban brenda gjithë misterin e tij. Balli i saj i rënduar duket se mban peshën e madhe të shpirtit dhe trupit, pezull mes jetës dhe vdekjes.

Në sfond shfaqen disa figura grash të moshuara, edhe ato të kthyer me shpinë, sikur të ishin brenda një kampi refugjatësh duke parë rrobat e ndera; sikur të vështronin siguritë e tyre të brishta të varura në fillin e hollë të jetës. Duke analizuar pozicionin e figurave, del në dritë një detaj i rëndësishëm: e vetmja që tregon fytyrën e plotë është nëna, ndërsa nga figurat e tjera dallohen mezi profilet, supet ose shpina.

Megjithatë, një lexim ndryshe i veprës bën që piktura të kalojë edhe kufijtë e origjinës së saj. Edhe pse vepra lindi si homazh për kujtimin e konfliktit në Kosovë, imazhi hapet drejt një përmasë universale. Ai të kujton edhe një nënë arbëreshe të para gjashtë shekujve, të bllokuar në të njëjtën dramë, duke ikur drejt një destinacioni që nuk dallohet sepse është ende i panjohur. Kështu, në pamundësi për të pasur një përgjigje të sigurt, arti ngre një pyetje pa përgjigje përfundimtare: vështrimi i asaj

Përkthimi i ekzilit: piktura murale dhe letërsia, Kosova në ngjyrat e kujtesës arbëreshe në Pallagorio të Kalabrisë

Nga Federica De Bastiani

nëna ka humbur në zbrazëtinë e ekzilit apo ndjek horizontin e një shprese të mundshme? Rreth këtij dyshimi mund të imagjinojë lirishit çdo kalimtar: është figura ajo që kryqëzon vështrimin me të, apo është vetë kalimtari që dëshiron të kapet nga ata sy? Ky vështrim simbolizon mungesën e një mbërritjeje përfundimtare dhe tragjedinë e dëshpërimit përreth.

Sipas këtij interpretimi, nëse gruaja e pikturuar do të ishte një personazh i Ollurit — si nëna te tregimi ose vetë Valdetja në roman —, do t'i jepte formë momentit më të hapur të rrëfimit: atij çasti ku hapësira mbetet aq e gjerë dhe e turbullt, sa të duket si një hap në zbrazëti. Mund të jetë pika ku, me rrëmbimin në ëndërr të Bardhyllit nga rojet, bashkëshortja e tij Valdetja mbetet vetëm me vajzën, Jetën. Në atë moment, bëhet e pamundur t'u jepet zë pyetjeve të dhimbshme si: “Ku është burri yt?”, “Ku është Bardhyli?”. Në roman, madje

edhe rrëfyesi në vetën e dytë — me gjithë gjithëdijeninë e tij — duhet të heqë dorë nga pyetja e drejtpërdrejtë: “Bardhyl, ku je?”. Edhe pse ai di çdo detaj, vendi i rrëmbimit është një hapësirë pa identitet i kërcënuar nga shtypja e njerëzve pa shpirt. Këta njerëz, bashkë me pengjet, kanë zhdukur edhe atë pikë sekrete dhe të fshehur ku vetëm lexuesi mund të hyjë përmes faqeve të librit. Ajo hapësirë misterioze bëhet një zbrazëti ku dyshimi se ku ndodhet personazhi — dhe nëse është ende gjallë — mbetet i heshtur dhe pa zgjidhje. Megjithatë, nëse në roman kjo ndarje e dhunshme nuk shkon përtej dimensionit të pavetëdijshëm, në tregim ajo bëhet një realitet i ashpër tregimtar. Tragjedia e ekzilit shfaqet kështu në dy anë e të njëjtës dramë: në veprën e parë kalimi i kufirit bëhet me babanë, në të dytën ndodh pa të. Në të dyja rastet, figura e gruas mbetet shtylla qendrore e këtij

dialogu mes teksteve, pavarësisht pranisë ose mungesës së një figure mashkullore:

«E shihje kufirin tek të priste. Nuk ishte më larg se njëqind metra. [...] Me dorën e majtë e mbaje vajzën, ndërsa me të djathtën valixhen e stërm bushur. Po ashtu, edhe Valdetja ishte e ngarkuar dhe ecnit me një ngadalësi të padurueshme për ruajtësit e vijës ndarëse në mes të dy vendeve. Afër kufirit, sytë të panë edhe njerëz të tjerë [...]. Shihje pleq e plaka, të rinj e të reja, fëmijë që vajtonin, të renditur në rresht të gjatë [...]»¹.

Në tregim, përkundrazi, zëri i djalit përshkruan peizazhin e shkretë që ka përpara, duke ndier zbrazëtinë e mungesës së babait. Ky i fundit, deri pak orë më parë, mbante peshën e rëndë të valixheve dhe të familjes. Është sikur kjo peshë e padurueshme, fizike dhe shpirtërore, duhet të bjerë me dhunë mbi dikë, duke ngarkuar figurën e nënës që gjendet e vetme duke tërhequr fatin e saj:

«Unë dhe nëna, duke i bartur zhargas valixhet, që jo më shumë se para dy orëve i bartte babai, ngadalshëm hymë brenda saj, të cilën shiu lart nga qielli dhe loti poshtë nga njeriu e kishin lagur aq shumë, sa që e kishin shndërruar në një vend ku e merrte të ftohtën, nga koka deri te këmbët, çdo shpresë e të sapozbriturve. [...] Në këtë vend të zbylltë nuk shihje gjë tjetër pos njerëz të lodhur dhe të këputur në shpirt. Syri im shihte fëmijë duke qarë, burra duke vrapuar pas bukëve dhe mburojave të najlonta, gra e vajza të reja shkëlqimhumbura dhe pleq që bënin be e rrfë se këso lufte nuk kishin parë e nuk kishin përjetuar asnjëherë.»²

Murali sjell kështu ndjesinë e të njëjtit kalim. Në mur, nëna shfaqet duke larguar fëmijët për të mirën e tyre: një gjest mbrojtës dhe i vendosur që shkon kundër dëshirës së saj, në vuajtjen e thellë të dikujt që nuk di ku të shkojë dhe nëse ai vend do të jetë i sigurt. Kjo lëvizje e fortë emocionale merr formë në tensionin e ballit dhe të syve: është një vështrim fiks që përmbledh lodhjen e rrugëtimit drejt një shpëtimi, i cili nuk është mungesë rreziku, por një përpjekje ekstreme për t'i ikur vdekjes:

«Në mesditë e kape vajzën për dore dhe u nisem në drejtim të autobusëve. Assesi nuk donte të nisej. Frikësohej nga një rrugëtim i ri. [...] E vogla nuk bindej derisa Valdetja e tërhoqi aq përdhunshëm e aq fuqishëm, gjë që nuk e kishte bërë asnjëherë, edhe përkundër vajit të saj që nuk pushonte dot. Hipët në një autobus të kaltër [...]»³.

E njëjta dinamikë rishfaqet në kujtesën e protagonistit të tregimit:

«Në një mesditë nëna më kapi për dore dhe më tha se duhej të iknim në një vend tjetër. Nuk doja assesi të nisesha. Doja ta prisja trenin e babait, por ajo më tërhoqi aq përdhunshëm e aq fuqishëm, gjë që nuk e kishte bërë asnjëherë dhe përkundër vajit tim që nuk pushonte dot, më hipi me një autobus të kaltër [...]. Nuk e dija se ku po na dërgonte ai. Ndoshta në një luginë tjetër.»⁴

Kjo plagë e thellë gjen një zë shpirtëror dhe një urë vëllazërimi në poezinë e Atë Elia (Sergio) Spezzano-s. Nëse nga njëra anë poezia është homazhi i priftit për viktimat e Kosovës, nga ana tjetër murali bëhet homazh për vetë kujtimin e tij, duke shkruar vargjet e tij me të bardhë mbi një sfond blu paqësor. Siç thekson Fabrizio Centofanti në parathënien e përmbledhjes *Croci del Sud*, poezia e Spezzano-s është një «bukuri që ecën» drejt vuajtjeve njerëzore, e aftë t'u japë zë të shtypurve.

Fjalët e marra nga “Ai morti di Pristina” krijojnë një simbiozë me ngjyrat e vizatimit dhe kërkojnë të përcjellin një gjendje shpirtërore të kundërt me plagën e lënë nga lufta. Nëse konflikti sjell imazhin e errët të atij që ka «lyer / Me të zezë muret e [...] /



1 OLLURI, 2020, 111.

2 OLLURI, 2023.

3 OLLURI, 2020, 132.

4 Olluri, 2023.

Ndërgjegjes...»⁵ përgjigja e artit kalon errësirën e dhunës. Në këtë pikë, motivi i ikjes dhe i ndarjes kalon nga një formë në tjetrën: kufiri gjeografik i teksteve të Ollurit projektohet në kufirin vertikal të murit, ndërsa pesha e rëndë e ekzilit kthehet në shprehje pamore, duke u shfaqur në tiparet e markuara të nënës dhe në krahët e gjerë që mbrojnë fëmijën e saj të pambrojtur. Kjo dinamikë e dhimbjes mposhtet nga vargjet e shpresës së Atë Spezzano-s, të cilat gjejnë pasqyrim në gjuhën joverbale dhe në ngjyrat e zgjedhura. Në dominimin e toneve të ngrohta si rozë dhe e kuqe, në kontrast me blunë dhe të bardhën, del në pah zëri i një brezi artistësh të lindur pak vite pas përfundimit të konfliktit, që ruajnë kujtesën historike si një mësim të çmuar për të mos u harruar.

Edhe zgjedhja e hapësirës ndihmon në vlerësimin e mesazhit: murali u realizua në një kënd të veçar, i rrethuar dhe i mbrojtur nga shtëpitë përreth, gjë që e kthen sheshin në një vend reflektimi nën qiell të hapur. Ky dialog kujton vlerën e artit në hapësirat komunitare si një mundësi për reflektim të thellë. Edhe pse tiparet e nënës mbeten të shënjuara nga dhimbja, piktura dhe fjala duket se bashkohen drejt të njëjtit shpëtim. Mes vargjeve dhe harmonisë së ngjyrave ndodh një lidhje e thellë: të dyja format e shprehjes thërresin njëra-tjetrën si shenja të shpresës. Pikërisht si në shkrimet e Ollurit, edhe lirika e Atë Spezzano-s nuk ka ndjenja urrejtoje që e vrasin njeriun nga brenda, por shkon tërësisht drejt një perspektive rilindjeje: «Dashuria ime?... / E megjithatë unë e di se do të vijmë / Përsëri ditët në të cilat / Do të zgjasim duart tona të varfra / Për të kapur jetën / Dhe qenien e saj».⁶

Skena e lë të hapur fundin e rrëfimit, ashtu si imazhi në mur hap perspektivën drejt horizontit. Në asnjë nga këto gjuhë shprehëse — pikturë, prozë apo poezi — nuk vendoset fjala e fundit, dhe kjo zgjedhje është e qëllimshme: t'i lihet hapësirë imagjinatës për të shkuar përtej, edhe në tragjedinë më të madhe të ekzistencës njerëzore.

Forca më e vërtetë e këtyre veprave qëndron te aftësia e tyre për të aktivizuar atë shumëfishues kuptimor që është tipik për artin: të kalojë natyrën e vet dhe të dalë përtej shenjës. Kështu, atij që vëzhgon i ofrohet mundësia ta lexojë veprën nga bota e tij e brendshme. Në fund të fundit, pasurimi që bashkon artin pamor dhe atë të fjalës lind pikërisht nga dialogu i tyre i thellë, i aftë të gjenerojë kuptime unike dhe gjithmonë të reja. Përmes këtyre lidhjeve shpirti njerëzor mëson të njohë veten, duke mbajtur gjithmonë hapur një dritare drejt takimeve të reja. Kjo është ndoshta shprehja më e lartë e mrekullisë së brendshme që jeton te njeriu, e aftë të rezistojë edhe kur drama duket se nuk lë hapësirë për asnjë pritshmëri.

Siç tregon vepra e plotë e realizuar nga artistja e Mural Fest Kosova, mesazhi është i aftë të përmbysë perceptimin e kufijve të ngurtë të tragjedisë: pritet një ditë e re, një faqe e re për t'u shkruar, qoftë mbi një fletë letre apo mbi një mur nën qiell të hapur. Dhe kur të bjerë shi, pika të ngjashme me lot të vërtetë do të lagin fytyrat e shqetësuara të pikturës; kur të kthehet dielli, ngjyrat do të ndriçojnë vargjet e pritjes dhe të shpresës, të gatshme për të shtrirë krahët drejt një ylberi të ri vëllazërimi.

Bibliografia:
OLLURI, Adil (2020): Bartësi i spirtrave të përzënë. Roman. Tiranë: Onufri.
OLLURI, Adil (2023): Bartësi i spirtrave të përzënë. In: *Kthimi i babait. Tregime*. Tiranë: Onufri.
SPEZZANO, Padre Elia (2020): Croci del Sud. Poesia. Pasturana: Puntoacapo Editrice, Collezione Letteraria.

⁵ SPEZZANO, 2020, 62: «dipinto / Di nero i muri della [...] / Coscienza...».

⁶ SPEZZANO, 2020, 62: «Amore mio?... / Eppure io so che verranno / Nuovamente i giorni in cui / Tenderemo le nostre povere mani / Ad afferrare la vita / Ed il suo essere».

Mbi romanin *Droja* të Andreas Dushit

Me Drojën pranë

Nga Rubensa Ndreca

Embylla *Drojën* dhe për disa çaste më dukej sikur po largohesha me nxitim nga një bisedë që nuk kishte mbaruar ende.

Gjatë leximit më shoqëroi vazhdimisht një ndjesi e çuditshme afërsie me rrëfimtarin. Në shumë faqe harrova se po lexoja letërsi; më dukej sikur po dëgjoja dikë që po më besonte copëza të jetës së vet. Rrallë më ndodh t'i besoj kaq shumë një zëri rrëfimtari.

Ajo që më bëri më shumë përshtypje nuk ishte vetëm historia që tregohet, por mënyra si vështrohet bota. Më dukej sikur po hyja në mendjen e një fëmije që përpigjet t'u japë kuptim gjërave që janë më të mëdha se ai: vdekjes, Zotit, ndarjeve, mungesës, padrejtësisë. Dhe shpesh i kupton gabim. Por pikërisht në ato keqkuptime, në ato arsytetime plot drojë, gjendet një e vërtetë që vetëm fëmijëria di ta mbajë gjallë.

Por herët a vonë, kjo përsiatje e pafajshme ndaj botës përballet edhe me mungesën. M'u duk sikur *Droja* flet për atë çast të jetës kur kupton për herë të parë se njerëzit që do më shumë nuk do

të jenë përgjithmonë pranë teje.

Këtë e ndjeva veçanërisht te figura e nënës. Nuk ka asgjë të stisur në portretizimin e saj, asgjë që lyp emocionin e lexuesit. E megjithatë, faqe pas faqeje, ndieja se ajo ishte boshti i heshtur rreth të cilit rrotullohej gjithë ai univers fëmijëror, vendi ku ktheheshin të gjitha drojat, gëzimet dhe pasiguritë. Ndoshta për këtë arsye ajo më është dukur një nga ato prani që nuk e lëshojnë kurrë krejt rrëfimin, edhe kur heshtin.

Krahas saj, një vend të veçantë zë edhe figura e babait. Në rrëfim ai shfaqet në shumë trajta, jo gjithmonë të lehta për t'u pajtuar me njëra-tjetrën. Mes tyre gjejnë vend edhe gjeste të vogla, pothuajse të pavërejtshme: një tullumbace ditëlindjeje, një udhëtim me biçikletë në shi, një fjalë e thënë në çastin e duhur. Në to duket një anë e figurës së tij që rrëfimtari nuk e humb kurrë nga sytë, edhe pasi prania e tij nis të zbehet dalëngadalë.

Janë pikërisht kësi detajesh, të vogla në dukje, që endin atë tis njerëzor që e

përshkon romanin krye e fund dhe që të bëjnë të ndihesh pjesë e tij. Më kanë mbetur në mendje lutjet e përsëritura para gjumit, pyetjet në katekizëm, pasditet në kishë, CD-ja me këngën Refuzoj, bisedat me Andreasin, frikërat që duken të vogla për syrin e të rriturit, por që në shpirtin e një fëmije zënë gjithë vendin, madje dhe humori që shfaqet aty ku nuk e pret.

Dhe diku mes këtyre kujtimeve, pyetjeve, lutjeve e frikërave, fjala 'drojë' pushon së qeni vetëm një titull.



Kur e nisa *Drojën*, mendova se titulli i referohej një ndjenje. Kur e përfundova, m'u duk se ishte shndërruar në një mënyrë të qenit. Një prani e heshtur që nuk largohet kurrë krejt, por ndryshon trajtë me ne. Në disa çaste, ajo merr edhe formën e asaj shkëputjeje nga vetja që romani e shpreh aq bukur: "Pa qenë vetja ose, më mirë, pa qenë brenda vetes, sikur prej diku larg po kontrolloja me një telekomandë gjithë veprimet e asaj qenieje që rastësisht jam unë."¹

Por sa më shumë e njihja këtë drojë, aq më pak më dukej se ajo kishte të bënte vetëm me frikën. Shpesh, pas saj gjendet edhe dashuria. Rrëfimtari druhet pikërisht sepse do: prindërit, motrën, miqtë, Zotin, vajzën që dashuron. Frika e humbjes lind gjithmonë aty ku ekziston më parë lidhja. Prandaj droja nuk vjen si ndjenjë që mpak jetën, por si një nga mënyrat përmes të cilave ajo përjetohet më thellë.

Mbi të gjitha, më pëlqeu ndershmëria e këtij libri që nuk përpigjet ta zbukurojë fëmijërinë, por as ta rëndojë atë me më shumë errësirë sesa mbart. E lë të jetë ashtu siç është: e brishtë dhe e fortë njëherësh, e qeshur dhe dhembshme, e mbushur me dritë, por edhe me hijet e veta.

Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse, pasi e mbylla librin, nuk më mbetën aq ngjarjet sesa atmosfera e tij. Ajo drojë e heshtur, thellësisht njerëzore, që secili prej nesh e ka njohur dikur, qoftë edhe pa ditur t'ia vërë emrin.

¹ Dushi, Andreas. *Droja*, bot. Onufri, Tiranë, 2026, f. 142.



Balada e Bostonit

Në breg të oqeanit u ula dhe
qava.
Përpara - ujë i paskaj,
Përmbi - qiell pafundësie.
Unë, me zjarrin e mallit, mes ujit,
qiellit e tokës,
shoh zallin e kohës që bie.

Ja, i them vetes,
edhe ti u shkëpute nga kontinenti
plak,
diçka që aq shpesh kishe dashur ta
bëje;
kështu një ditë do të shkëputesh edhe
prej botës,
mes teje dhe asaj do të shtrihet një
oqean asgjëje.

Fus këmbët t'i lag me pak
Atlantik,
ndërsa memorja bluan psalmin
137,
e zemra ngatërron Jeruzalemin me
Kaçanik.

Sa sy e kanë parë këtë
pafundësi?
Sa lot janë derdhë në të dy
brigjet?
S'di a kam më shumë mall për të
ardhmen,
a për të kaluarën që më ndjek e s'më
hiqet.

Si një bard i ardhur prej Ballkani në
Boston,
me lahutë të padukshme, hallet e mia
i qaj.
Edhe pse nuk vij nga fushat e
pambukut,
me bluz e sfidoj edhe zotin Buddy
Guy.

Në këtë cep të Amerikës kujtoj vendin
tim,
atë guvë e atë grykë, ku vetë Justiniani
një ditë
kaloi me gjithë shkëlqimin e tij
bizantin,
pa e kuptuar si ngrihen e bien
perandoritë.

Kapitali që mban për kapistalli krejt
botën,
tani shtrihet e ngrihet pas shpinës
sime.
E nga një skutë e Evropës, me një vezë
e pak kripë,
krejt shoqërinë e konsumit e sfidon
nëna ime.

Kush di të ma thotë pse këtë natë
qershori
sytë e mi shkëlqejnë më shumë se yjet
e galaksisë,
ai mund ta kuptojë edhe dhimbjen e
kësaj bote,
edhe lumturinë e Leopardit para
pafundësisë.

Nuk e di a jam një pikë uji në
oqean,
a një kokërr zalli në tokën e
shkretë.
Ndoshta jam vetëm një pikë
pikëllim
që mes katër elementeve ka zënë
vend.

Në emër të atit, birit e shpirtit
t'shenjtë, lutem,

AG APOLLONI**Vetëm vdekja
nuk gënjen***Poezi*

sikur hodha hapin në dekadën e fundit
të jetës;
dhe vazhdoj të sillem si një zar në
duart e fatit
e t'i hakërrhem universit, oqeanit dhe
vetes.

Halloween në Harvard

Edhe sot shkova në Widener,
lexova nga koleksioni i Milman
Perry-t.

Dola nga arkivi, a nga arkivoli?
Te shkallët kishte nisë festa e
tmerrit.

Më prisnin një lugat, një kukudh,
një shtrigë, një vampir...
thujse ishin hapë krejt varret e
Bostonit.

U mbështeta në një nga kolonat
korintike,
i rrethuar si në *Thriller*-in e Michael
Jackson-it.

Çava turmën e të vdekurve
duke shikuar përpara,
jo anash, as mbrapa, as lart.
Pse të kem frikë?
A s'jam edhe unë njëri nga ata
që merret me varre e legjenda në
Harvard?

Ku shkon?
Më pyesin e më ndjekin si çakaj.
Më lini, u them,
se unë e kam dhënë besën dhe duhet
ta mbaj.

Vetëm vdekja nuk gënjen

Datën e lindjes
e kishte leje për të gënjer.

Thoshte: Do të bëhet mirë.
S'u bë.

Thoshte: Do të bëhemi të pasur.
S'u bëmë.

Thoshte, me kofër në duar:
Do të kthehem shpejt.
Prita tri ditë, katër muaj, pesë
vjet...

U lodha nga gënjeshtret e tij,
por kur një ditë më tha
se vdekja i trokiste në gjoks,
doja të ishte duke më gënjer
përsëri.

Heroi

Ai nuk e dëgjoi,
ai e ndjeu thirrjen për atdhe.

Shkoi në front
dhe u tregoi se me këmishë kishte
le.

Pasi e mbrojti tokën tonë,
iu kthye tokës së vet.

Pushkën e vari në mur,
dhe nuk e preku më.

Kulloste lopët n'katund,
shiste tambël n'qytet,
shkulte lisa, hapte male, rrafshonte
dheun.

Shokët e luftës s'pyesnin kurrë për
të,
ishin shumë të zënë duke e mjelë
atdheun.

Rrugët e Rrëshenit

Kujdes kur të shkoni në Rrëshen!
Pastroni këpucët, sandalet dhe
shputat,
si kur hyni në një vend të
shenjtë!

Ato rrugë i ka fshirë një
shkrimtare.

Ndalen hapin
dhe para se të vazhdoni tutje,
ndizeni një qiri,
ose, së paku, thuajeni një lutje!

Se aty ia përhitën fatin një
princeshe.

Lexonte rrëfenja *rreth vatrës*,
e nuk e dinte se fati rren,
se kot merr dafina në Romë,
të gjitha rrugët të çojnë në
Rrëshen.

Kur e di *sa iu tunt jeta*,
a s'të dridhet buza?
Më thuaj si ta fshijmë marren
tonë,
e mos të na mallkojë Muza!

Burgu i Burrelit

Një ditë,
në një qeli,
një i burgosur
gjeti një letër duhani.
E mbushi, mbështolli, e lëpiu dhe e
ndezi.

Kur poeti
ndërroi krah
mbi shilten e ndytë,
i tmerruar pa tjetrin me cigare në
buzë.

Tjetri sa hap e mbyll sytë,
i ndjeu gishtat e poetit në fyt.

S'e kuptonte çfarë gabimi kishte
bërë;
s'e kuptonte pse ish kaq e
tmerrshme
me pi duhan.
Dhe rrinte aty pa e ditur,
duke e parë mikun të çmendur;
duke e parë mikun të mërztur.

Heshtje.
Cigarja ishte fikur.
Në qeli qetësi dhe mërzi si pas një
tragjedie.

Në njërën anë poeti,
në tjetrën shoku i qelisë.
Mes tyre jepte shpirt një gjysmë
poezie.

Erotemë

Udhën kah ecje ti,
e mbështolla si qilim
dhe e hodha në shpinë;
do ta çoj ku të dua.
Si mund ta lë ta shkelin të tjerët
tokën që e preknin këmbët e
tua?

Ka një ngatërresë në të cilën nuk qorrollisen vetëm gazetarët axhami të terrenit, por edhe njerëz me një barrë mend e me përvojë. Kjo më shtyn të mendoj se, më shumë se ngatërresë, kemi të bëjmë me një padrejtësi të krijesës me emrin njeri. Thonë, bie fjala, natyrë e virgjër sikur vetëm njeriut ia paska dhënë Zoti të drejtën e natës së parë me natyrën, ndërsa krijesat e tjera, që lindin e vdesin po aty, që hanë e pinë, që dashurohen e shumohen mes tyre nuk paskan të drejtë të tundin flamurin e zhvirgjërimit. Këtë e dëgjoj përherë e më shpesh për plazhet. Madje këtu ngatërresa është edhe më trashanike. Thonë plazh *nudo*, sikur të jetë deti që del gollomesh para njeriut dhe jo ky i fundit para detit.

Këto mendoja teksa shkonim bashkë me Spiron tek ai gji i vogël. Më ka pëlqyer që kur isha fëmijë. Për të mos u ngrënë hakun, gjiret e shumta të detit në atë zonë janë një mrekulli, njëri më i bukur se tjetri. Po ky seç kishte diçka të veçantë që na marroste. Kush e mban mend, ndodhte njëllor si me ato fetat e bukës që na i lyenin gjyshet me vaj ulliri e me sheqer e ne ziheshim se cilën të merrnim. Ato njëllor të shijshme ishin. Lufta bëhej për më të madhen. Me këtë gji ndodhte e kundërta. Ai shijonte më shumë mbase ngaqë ishte më i vogli. Rruga për atje kalonte fillimisht përmes dunave të rërës, ku fjetet e drejta të zhukave zbardhnin deri në majë nga kërmij të vegjël si të shkuar në hell. Në dalje të një pylli me pisha ishte pusi, ku zakonisht pinim ujë kur ktheheshim nga plazhi e ishim të lodhur. Në mëngjes ndalonim aty vetëm për të luajtur me jehonën e zërit tonë. Mbat mend se njëherë u tallëm me dy kushërinjtë tanë të ardhur nga Vlora. Ata ishin pak më të vegjël se ne dhe u thamë të mos shikonin nga gryka e pusit se aty brenda rri shejtani. Ka rënë në pus që kur ishte i vogël dhe askush nuk e ndihmon të dalë sepse ai është i keq. Proveni po deshtë t'i flisni dhe do dëgjoni si përgjigjet. Sa lije pusin, po në të djathtë, ishte një liqen i vogël me ujë të ëmbël. Ndonjëherë hynim mospërmasë tij, se liqeni thahej në verë. Zinin peshk të trullorur në turbullirën e llucës dhe ngjala me pinca ose pirunë që i merrnim enkas nga shtëpia.

Nga e majta, pasi lije një gji të madh, ku thuhej se dikur ishte menduar të bëhej një port, shtrihej një kodër e butë e mbushur me manaferra dhe që kundërmonte rigon në verë. Vetë gjiri ishte fshehur mes dy kodrave që binin thikë mbi det, me ca shkëmbinj që dukeshin si skulptura me forma të çuditshme dhe pa kuptim. Gjatësia e tij nuk i kalonte të njëqind metrat dhe mbyllej aty ku fillonin shkëmbinj të dhe një shpellë jo më shumë se 10 metra e thellë që lagej nga uji deri në gjysmën e saj. E gjithë gjerësia që ndante detin me pjesën e veshur me gjelbërim të dendur shkurresh të ndryshme, pra i gjithë plazhi, nuk i kalonte 30 metrat dhe rërën kokërrmadhe të tij nuk e gjeje në asnjë nga plazhet e zonës.

Ne shkonim rrallë aty, se ishte larg nga fshati. Bëheshim gjithë-gjithë gjashtë çuna të një moshe. Më rrallë kalonim nga shkëmbinj të dhe mblidhnim guaska shumëgjyreshme e shumëformëshe. Një mëngjes fati më qeshi mua. Gjeta një top llastiku që e kishte nxjerrë deti. Në të ishin të stampuara fotografitë e futbollistëve të Milanit. E ruajta me fanatizëm për shumë kohë dhe nuk pranoja kurrë të luanim me të.

E bëra këtë përshkrim të gjatë në hyrje jo sepse desha t'ju jap kohën e duhur që të largoni fëmijët. Nuk është nevoja për këtë se ata, edhe pa ua kërkuar njeri, i rrinë larg leximit si djalli temjanit. Në këtë tregim mund të ketë ca rreshta të papërshtatshëm, por fëmijët e sotëm kanë parë nëpër ekranet e celularëve lloj-lloj skenash dhe dinë për lakuriqësinë ku e ku më shumë se vetë Adami dhe Eva. Edhe ju, pasi t'i keni shkuar tregimit në fund, ka gjasë të mos e merrni vesh arsyen e zgjatjes sime. Për të qenë i sqartë, nëse ka një arsye, as unë vetë nuk e di cila është. Spirua, miku im, më tha se e paskam bërë nga nostalgia për atë vend, për fëmijërinë, a për të dyja së bashku.

Mbase naiviteti i kujtimeve të fëmijërisë sime i rri ngushtë këtij rrëfimi, e sidomos titullit të tij, por më besoni, se edhe vetë do t'u kisha qëndruar larg atyre nëse nuk do të më ngacmonte historia që dua të ndaj me ju. E teprava që e teprava, tani bëni durim

JANI MALO

Lakuriq

Poezi

t'ju përmend edhe një detaj që më doli nga mendja dhe që për ne atëherë nuk thoshte gjë të veçantë, po është me vlerë për atë që do të tregoj më pas. Sa herë shkonim atje, ne luanim futboll pa brekë dhe pastaj, ashtu gjithë djersë siç ishim, kridheshim në det lakuriq. E bënim këtë thjesht se nuk kishim rroba banje dhe nuk donim të ktheheshim në shtëpi me brekë të qullura. Po edhe fare të pamëkat nuk ishim. Pasi dilnim nga deti, shtriheshim gollomesh në atë rërën kokërrmadhe që vërtet të përvëlonte, po edhe të joshte duke të gudulisur. Aty i turrnim historitë tona të para të dashurisë. Kush e kush ta nxirrte veten më të zotin – dhe kush pa, ne që ia njihim njëri-tjetrit dhëmbë e dhëmballë. Herë-herë shkriheshim së qeshuri teksa shihnim se si këto rrëfime të pafaja me seks zgjonin bilbilushin po aq të pafaj të ndonjërit prej nesh dhe e bënin të lëvizte aty ku fillojnë shalët. Ai turpërohej e përipiqej ta mbulonte, po cironka e tij përpëlitej më keq në rërën e nxehtë të mesditës. Qëllonte që kjo sëmundje të përhapej si epidemi e shpejtë e të na zinte të gjithë.

Por le të kthehem te ngjarja që zu fill tre vjet më parë. Edhe atë ditë, bashkë me Spiron, vendosëm të shkonim te gjiri i vogël e i fshehur. I kthyer nga emigracioni i gjatë në Greqi, Spirua kishte vite pa vajtur në ato anë. E lamë makinën gati tre kilometra larg dhe e bëmë rrugën me nge. Mblodhëm rigon, hëngrëm manaferra dhe kulumbri. Vetëm peshk nuk mund të zinin. Liqeni i vogël me ujë të ëmbël ishte bashkuar me detin me një kanal që gjarpëronte përmes pyllit me pisha. Kur dolëm te gjiri, ishte qetësi. E njëjta pamje përreth, me shkurre të gjelbra. Të njëjtët shkëmbinj në të dy anët. Vetëm plazhi na u duk ndryshe. Gjithandej gjembaçë të mbirë nëpër rërë dhe leshterikë e mbeturina që i kishte nxjerrë deti, ishin shpërndarë në të gjithë sipërfaqen. Befasia ishte te shpella në të djathtë tonë. Jo se kishte lëvizur nga vendi. Në hyrje të saj dikush kishte lënë rrobat. Aty pranë ishte një shkëmb që zgjatej në det, pak mbi ujë si kurri i ndonjë peshku gjigant. Rreth 100 metra më tej, atje ku kurri nuk dukej më, pamë një siluetë njeriu. Me sa dukej edhe ai na kishte vënë re, po çuditërisht nuk po dilte nga uji.

- Është lakuriq, - theu heshtjen Spirua. - Ikin më anën tjetër të plazhit.

Në të majtë, në fund, atje ku shkëmbinj të ishin edhe më të thepisur, dukej një lopë. Ngaqë edhe ajo pjesët intime i kishte të zbuluara, ne vendosëm të qëndrojmë në qendër të plazhit, aty ku ndaheshin gjurmët e njeriut dhe të lopës. Ishte ende herët dhe mbi rërën e njomur, në krahun e lopës, në largësi nga njëra-tjetra, nxirrnim avull ca bajga të mëdha të sapolëshuara. Tek-tuk zogj të vegjël, me puplat si e kaltra e detit uleshin, qëndronin pak sekonda mbi bajga dhe sakaq ngriheshin në fluturim me shpejtësinë e avionëve, derisa lartoheshin në qiell e dukeshin sa një pikë. Tej, në faqen e kodrës, në të majtë, dukej tufa e lopëve që kulloste.

Kur e pa se nuk kishte rrugë tjetër, burri u çua dhe e nxori gjithë trupin mbi ujë. Ishte lakuriq dhe ashtu bëri për nga bregu. Në dorë mbante një qese me midhje. Dy-tri minuta më vonë vumë re se burri ishte veshur dhe po vinte drejt nesh. Kur u afrua, e njohëm. Ishte Nakua. Ai është goxha më i vogël se ne në moshë dhe punën e loçarit ka bërë gjithmonë. Është i leshtë, thoshin për të. I mbahet edhe goja. Rrokjet i nxjerr si me darë, po duhet të jesh i vëmendshëm të kuptosh se çfarë thotë. Megjithatë zëri i tingëllon si kabanë. Fjalët i tërheq zvarrë si një karro e ngarkuar dhe ato kërcasin me një zhurmë bezdisëse për atë që e dëgjon për herë të parë. Po ai ka një të mirë. Flet rrallë dhe akoma më rrallë me të panjohur.



Gjithsesi ne jemi të mësuar me Nakon dhe atij me ne i zgjidhet gjuha.

- Pse nuk bëjmë këtu një plazh nudistësh, - tha Spirua papritur.

Unë ndalova për të kuptuar nëse e kishte seriozisht apo po tallej. Ndërkohë Nakua arriti dhe unë nuk pata kohë të përgjigjem.

- Nako, e bëke plazhin pa brekë, - i thashë.

Ai vetëm qeshi si i zënë në faj dhe mua m'u duk se u justifikua si ne dikur, *se nuk donim të ktheheshim në shtëpi me brekë të qullura.*

- Pse nuk e bëjmë këtu atë plazhin nudo?

- u rikthye Spirua te pyetja e tij retorike dhe i hodhi një vështrim tërthor gjithë gjirit. Sikur po përfytyronte si do ishte plazhi i tij *nudo*.

Pastaj u kthye nga Nakua dhe i tha me shaka:

- Hë, si është më qejf të laheshe, me brekë apo pa brekë?

Ai përsëri vetëm qeshi. Dhe uli kokën sikur të turpërohej. Kështu bën sa herë i zë në gojë martesën e i premtonte se do i gesh nuse. Aty për aty mendova të bënim një shaka me Nakon.

- Të kam gjetur një nuse të mirë nga Tirana, - i thashë.

- Mbeti tiranasja për mua, - tha me seriozitet dhe ngrysi vetullat e trasha.

Spirua u fut në lojë menjëherë:

- Ti je goxha djalë dhe pastaj ke goxha hallate. Po të pa ajo lakuriq, do çmendet...

Nakua lëpiu buzët dhe nxori e futi gjuhën nga goja dy-tri herë të mëshpejtësi. Sytë, madje edhe vetullat, i qeshën.

- Ik të shpella dhe zhvishu. Do të bëjmë ca fotografi dhe do t'ia tregojmë asaj tiranasës. Të dielën tjetër do ta sjellim këtu që ta njohësh, - thashë unë.

- Në darkë, te Jorgo, ke edhe dy kriko të mëdha me birra, - shtoi Spirua.

Nakua na pa me mëdyshje, po pastaj u kthye dhe të tre u nisëm për të shpella.

Ajo që ndodhi në ditët që pasuan me fotografitë që i bëmë Nakos i kaloi përmasat e një plazhi të vogël në një fshat të vogël. Ngjarja u vë *virale* falë rrjeteve sociale. Spirua e hodhi njëherë nga fotot në faqen e tij në instagram. Natyrisht, nuk dukej fytyra e Nakos, po peizazhi përreth të linte pa mend. Poshtë fotografisë shkroi: "Çmenden turistët. Plazh nudo në..."

Nëpër rrjetet sociale fotoja u shpërnda me shpejtësinë e dritës dhe akoma më shpejt e më shumë rritej pingu i komenteve. Tri pikat në fund nuk thoshin asgjë, nuk jepnin asnjë pikë referimi, por kjo nuk i pengoi fillimisht portalet e më pas televizionet lokale e kombëtare që ta bënë lajmin tërkuzë. U hamendësua për vendin, u tha se ishin turistë polakë që bënë orgji e të tjera e të tjera. Televizionet më të kamura dërguan grupe xhirimi në të gjithë Shqipërinë dhe zbuluan çdo cep ku bëhej plazh *nudo*. Këndvështrimet e ndryshme i

hutonin njerëzit. Diku kjo shihej si një risi që do ta çonte turizmin e vendit në një stad të ri. Diku tjetër si diçka që i duhej vënë fre sa më shpejt e pa u përhapur si epidemi. Jepeshin kronika nga Gjipeja, apo gjire të fshehura e me guralecë të bardhë në Karaburun që cilësoheshin si të virgjër. Nudistët u zbuluan edhe në rezervuarët në periferi të Tiranës. Populli vigjilent, i nxitur nga këto kronika, filmonte me celularë turistë *nudo* apo edhe *topless* dhe ua dërgonte televizioneve. Dhe ata nuk ngurronin t'i shfaqnin nëpër emisionet e lajmeve, krahas vrasjeve e vjedhjeve, apo një operacioni policor me emër të bukur për arrestimin në masë të shpërndarësve të drogës. Nëse do bëhej një sondazh, ato ditë ky qe *top lajmi*.

Nuk di të them nëse ishte kjo arsyeja që e vuri në lëvizje policinë, por një gjë është e sigurt. Ato tri pikat në fund të shënimit "Çmenden turistët. Plazh nudo në..." nuk kishin asnjë enigmë për policinë. Nuk e vë dorën në zjarr për t'ia dhënë meritën e zbulimit dy satelitëve që kemi lëshuar si zagarë gjahu në hapësirë. Përtej hamendjes sime, e rëndësishme është që një ditë dy makina policie shkuan te gjiri i fshehur. Ishte mesditë. Nakua kishte ikur tok me lopët se vapa nuk u bënte mirë. Në procesverbalin e konstatimit u shënuar se në vendngjarje nuk u gjet krijesë tjetër e gjallë veç karkalecave, ca fluturave, zogjve bishttundës e ndonjë korbi që vizitonte bajgat ende të freskëta të ndonjë lope. Nuk i shpëtuan përfshirjes në raportim edhe ca pulëbardha që e inspektionin bregun për arsyet e tyre si dhe dy topa të kalibrit të rëndë të ndryshkur, mbetur aty që nga koha e luftës me Italinë. Me kaq policët e quajtn misionin e tyre të kryer.

Kur shakaja jonë dhe lajmi që e pasoi po fashiteshin, shpërtheu papritur vala e dytë, më e fortë se e para. Siç ndodh me tërmetet. Disa nga portalet pranë opozitës shkruan se në një nga plazhet më të bukura e më të virgjëra të vendit u sajua kinse një histori me plazh nudo, se u filmua një fakir, kur në fakt i gjithë ai gji i mrekullueshëm i është dhënë një oligarku të lidhur me qeverinë për të bërë një resort luksi. Madje, sipas tyre, ishin parë edhe makineri të rënda, kishte filluar puna për të rrethuar vendin dhe askush nuk mund të hynte më atje.

Si kundërpërgjigje ndaj tyre, portale të tjera pranë partisë në pushtet folën për një bum të paparë të turizmit në atë plazh. Sipas tyre, dhjetëra kampera dhe qindra turistë e kishin zaptuar atë vend. Dhe si për ta bërë të besueshëm lajmin me nudistë, apo për të kundërshtuar kolegët e portaleve opozitare, ata shkruan se aty, veç polakëve, bënë orgji edhe ca ukrainas që i kishin ikur luftës. Për ilustrim u vu edhe një fotografi ku dukeshin dy të rinj hipur mbi grykat e atyre topave të luftës. Ajo që na bëri përshtypje ishte se askush nuk i mori seriozisht lajmet e portaleve, askush nuk pyeti ku ndodhet ky plazh, madje kësaj here as policia nuk e pa të arsyeshme ta krehë për herë të dytë terrenin.

Vetëm mua dhe Spiros, që shkonim thuhetse përditë atje, na vinte për të qeshur me ato që lexonim. Shakaja jonë ishte si ai zjarri që i vihet me dashje një kullote dhe merr përmasa të paparashikueshme, madje edhe të rrezikshme. Plazhi vazhdon të ishte bosh dhe Nakua e pastronte çdo ditë sa mundej – kishin kaluar dy javë – me shpresën se të dielën e radhës do t'ia sillnin aty nusen nga Tirana.

Dhe e diela erdhi. Unë dhe Spirua shkuam më herët atë ditë. Si dita e fundit e pushimeve të vitit. Po mendonim si do justifikoheshim para Nakos për nusen, ndërkohë që ai e kishte bërë detyrën e tij. Madje, veç leshterikëve dhe gjembaçëve, kishte hequr edhe bajgat e thara të lopëve. Të freskëta nuk bëhej më fjalë që ato të lëshonin buzë detit, sikur ta kishin besuar njëllor si Nakua që do ia sillnim një ditë nusen. I gjithë gjiri ishte bosh. Edhe të shpella nuk kishte njeri. As në kodrën në të majtë nuk dukeshin lopët. Na shkoj mendja se dikush i kishte treguar atij për shakanë tonë dhe Nakua kishte ndërruar kullotë për të mos u përballur me ne.

Të vërtetën do ta mësonim kur u kthëm në fshat. Në kafene flitej vetëm për Nakon. Policia kishte vajtur në mesnatë në shtëpinë e tij. E kishin arrestuar.

Se faji i vjetër pjell sërish
Te breza njerëzish fat të ri.

I.

Në prag të thyerjes së ditës, me të vënë re shfaqjen e tjetrit në cepin e udhës, shpejtoi të fshihej pas trungut të një peme, në pritje të avitjes së tij. Ai ecte me hapa të ngadaltë, dhe në pamje dukej sikur nuk ndjente asnjëfarë rreziku. Me siguri do të ketë qenë tek mamaja, mendoi me vete djali.

Kudo përreth sundonte një qetësi e pazakontë, e cila i dukej sikur mbahej pezull vetëm prej pushkës së tij, dhe sapo ajo të shkrepte, do ta çlironte gjithë atë zhurmëri të akumuluar përnjëherë. Vetëm mos shkojë huq, lutej ai. Në një rast të tillë zor se do të mund të shpëtonte pa u kapur.

E ndjente se po të qëndronte edhe më ashtu, do të mendohej më gjatë se duhej, dhe personi që synonte të vriste mund t'i shpëtonte. Ndaj, i doli me vrull përpara, i tha ato pak fjalë që kish mësuar përmendësh në gjuhën e huaj, dhe në çast, e qëllloi.

Me hapa të lëkundur, nisi ecjen drejt të porsavararit. Udhë, në të dyja anët e saj, vijonte të ishte krejtësisht e zbrazët dhe nuk lëshonte asnjë zhurmë. Ishin hapat e atij vetë, që pas së shtënës i dukeshin si gjëmime, njëri më i fortë se tjetri, duke mos e lënë të qetësohej.

I vdekuri kishte rënë përmbys. Drejt fundit të mundimeve për ta kthyer mbarë, u dëgjuan disa hapa të huaj, të cilët i afroreshin me shpejtësi. U ngrit në këmbë me ngut, dhe pa harruar ti mbështeste pushkën mbi krye u largua menjëherë përmes pyllit të dendur, në anën tjetër të së cilit e priste motra.

Disa çaste pasi ishte zhdukur nga ai vend, dëgjoi pas tij një klithmë të fortë.

Mjedisi përreth i dukej si i mbytur në një errësirë, kalimi në anën tjetër i së cilit do t'i kërkonte mohimin e botës përreth. Pylli, po ashtu si udha, ishte pa njeri, por djali vazhdonte ti hidhte sytë përreth, sikur të ishte në një vend të huaj nga ku nuk mund të dinte se çfarë e priste. Prej faktit se e kishte menduar me qindra herë atë shfaqje të tjetrit, dhe me skenarë nga më të ndryshmit, e gjitha i dukej ende si e pavërtetë, si ti kishte ndodhur në ëndërr.

- Orest! Këtej!

Zëri i motrës së tij, Elektrës, e zgjoi në atë çast nga përhumbja. Emri, pas asaj përvoje i tingëllonte i paplotë, sikur bashkë me atë pjesë të qenies së tij, që i duhej ta linte pas, të kishte shkuar edhe ai. Në përpjekje për ta ripërtërirë atë sërish, u mat të përqafohte të motrën. Vetëm pasi ajo befasisht ju spraps, ai e kuptoi se i kishte të dy krahët të mbuluar me gjak. I tërhequr edhe vetë pas, ndërsa përpiquej të rimerrte frymën, pyeti:

- U dëgjua?

- Besoj se në gjithë zonën përreth do jetë dëgjua. - u përgjigj Elektra me gjysmë zëri.

Ajo e kuptonte më së miri se i duhej ta ngushëllonte të vëllain. Ti afrohej, e ndoshta ta përqafohte vetë atë, por diçka brenda vetes nuk ja lejonte. Në sytë e saj ai dukej ndryshe.

- Krahët e tu, ata janë të mbuluar me gjak. - shtoi ajo me po të njëjtën ndjenjë, e cila i përcillej atij si një brengë e pashpjegueshme.

- Do të thotë se të gjithën e kam kryer siç kërkohet. - tha Oresti.

Ai u mat t'a nxiste të largoheshin sa më shpejt. Klithma që kishte dëgjuar pak më parë tregonte se aty pranë kishte njerëz, dhe me shumë gjasë mund t'i dallonin. Por duke vënë re gjendjen e vajzës, vendosi ta mbante këtë shqetësim për vete.

Megjithatë, vetëdija për gjendjen e saj nuk mjaftoi për t'ia fashitur pasiguritë. Pas një grime të ecuri në heshtje, me gjysmë zëri e pyeti:

- Duhej bërë, apo jo?

- Po, duhej bërë. - u përgjigj Elektra.

Ato fjalë iu dukën sikur me zor dolën prej gojës së saj.

- Këtë gjë na e kërkonte babai, apo jo? - pyeti ai sërish.

- Po! - u kthye sërish Elektra, këtë rradhë me një zë të lartë, gati në ulërimë, përpara se të shpërthente në lot. Bashkë me to, kishte filluar ti merrej edhe fryma, duke bërë që në të folurën e saj të humbisnin disa fjalë, dhe në fund të kuptohesh vetëm: *...po...babai...por mamaja...mamaja... ajo që...jo Egisti!*

Me këtë shpërthim u zbehën të gjitha fjalët midis tyre, dhe u duk sikur të gjithë rrugën drejt

ORIN MAXHARI

Të paftuarit

Tregim

veriu do e kryenin në heshtje të plotë. Thellë përbrenda, e dinin se do të afrohej një kohë e tillë, kur do ju duhej të lëviznin në këtë farë mënyre, por nuk do të donin që të niste kështu.

- A ndihesh e lodhur, Elektër? - pyeti Oresti, ndërsa përpiquej të shpëlante njollat e kuqe prej krahëve.

- Po. - u përgjigj ajo, e shpërqëndruar.

Kishte që prej nisjes së tyre që nuk i hiqte sytë prej krahëve të tij. Në fillim, me shpresën se ajo pamje e huaj do të largohej bashkë me njollat e lemerishme, ndërsa më pas, me dëshpërimin se as uji nuk i shpëlante dot plotësisht.

Ato njolla gjaku, të mbetura fare të mehta pas shpëlarjes me ujë, i faniteshin si një truk sysh i cili kërkonte ta gënjente prej së largu, duke i falur thërrime çastesh ku i dukej se ai i mëparshmi ishte kthyer. Por ky vegim vetëm sa ia thellonte vetminë, duke e bërë të ndihej edhe më e huaj pranë tij.

- A e beson ti me të vërtetë se ne do të jemi të sigurtë *andez*?

- Sigurisht që po, motër. - nisi ai, si në përpjekje për ta lehtësuar. - Dhe do të doja shumë që të më besoje kur të them se asnjë vend tjetër në botë nuk do të na priste më mirë *ne të dy*.

Pupu, ç'ishte ky grup fjalësh "*ne të dy*", nisi të mendonte Elektra, e tmerruar. Ndonëse nuk kishte dorë të drejtëpërdrejtë në vrasjen e kryer, ajo megjithatë e ndjente se nga tani e tutje, kundrejt dëshirës së saj, ishte po aq e përfshirë në të sa vetë vrasësi.

- Në mos gabohem, *andez* ka edhe një shprehje për këtë. Po, ata thonë se "*shtëpia e tyre është e Zotit dhe e mikut*". - vazhdoi Oresti, dukshëm i lehtësuar dhe shpërfillës ndaj gjendjes së motrës.

Mikut ë, epo, mik me ata mund të bëhesh ti, por unë kurrësesi! Në fund të fundit, ai vetë e kishte përmendur i pari vrasjen. Ajo vetëm sa nuk e mohoi idenë e tij. Gjë të cilën ai e kishte marrë për dakortësi. Dhe në të vërtetë e ndjente se do ta kishte pranuar atë gjithësesi, edhe si vrasës që ishte bërë, për aq kohë sa ai vijonte të ishte vetvetja. Por ajo vendosmëri dhe ai zell për kulturën e huaj nuk ja lejonin të menduarin për mirë.

- ...vetë kodi zakonor që ne do të përdorim, shumicën e vëmendjes së tijja kushton çështjeve të vrasjes, dhe mekanizmit të "gjakmarrjes"... - vazhdonte ai ndërkaq.

Mekanizëm...vrasje, përsëriste vajza me vete. Një mandat për të vrasë, i cili trajtohej sikur të ishte i pashmangshëm! Më e keqja për të ishte se po i bëhej e qartë arsyeja e asaj dëshirë të fshehtë e kobndjellëse të Orestit për t'u hakmarrë ndaj mamasë përmes Egistit.

O zot, ai mezi priste të bëhej si ata! Vetëm sa i duhej një shtysë...

*

...Një ngjarje e rëndë ka ndodhur ditën e djeshme, në shtetin fqinj të Greqisë, ku, në rrethinat e qytetit të Agrosit, njëzetvjeçari Orest A., ka qëlluar për vdekje me pushkë bashkëqytetarin, Egist T. Djali mendohet të ketë qenë i fshehur..., ishin të vetmet fjalë që qarkullonin në ato momente nëpër kafene "Malësia", ose së paku ashtu i dukej Lekës, ulur në një cep të saj, larg çdo zhurmërie tjetër.

...vendndodhja e autorit të krimit ende nuk dihet, por disa ekspertë sygjerojnë se ekziston një mundësi që ai të jetë nisur drejt vendit tonë. Kjo falë ngjashmërive të shumta midis asaj vrasje dhe gjakmarrjeve sipas kanunit...Për më shumë të reja qëndroni me ne në "Ereni 24". Faleminderit!...

Nga këndi ku qëndronte i ulur, Leka shihte njerëzit teksa largoheshin një nga një, duke i

zbuluar sërish pamjen e plotë të ekranit, i cili për fatin e tij të keq nuk e shfaqte më atë lajm. Rrallimi i tyre e bënte të ndihej më të vetmuar, por aspak të qetë. *Vallë a nuk e kuptonin ata rëndësinë e asaj që porsa kishin dëgjuar?*

Orvatej të arsjetonte me veten, duke u përpjekur disa herë ta mendonte si diçka të vogël, pa ndonjë domethënie të madhe, por kjo i zgjaste shumë pak, dhe pas pak momentesh i rikthehej përsëri ajo ndjesi tërësisht e kundërt.

Një vrasje sipas kanunit, në një vend të huaj. - murmuriste me vete ai. - Në një vend fqinj. Fqinj i cili ne nuk na ka dashur. Fqinj i cili mbase ka vjedhur prej nesh...

Dhe në fund:

- Fqinj i cili do të na vjedhë *vetë ne!*

Brofi menjëherë dhe me hapa të lëkundur u nis drejt banakut për të paguar.

- Turp i madh për ne kjo punë! - i tha papritur banakierit, i cili vetëm e kishte parë habitshëm gjatë daljes.

Prej majës së kodrës ku ndodhej kafeneja, dallonin mes pemëve disa pjesë të shkëputura të rrugës nacionale. Dikur këndeje kalonin malësorë të vërtetë, nisi të mendonte Leka, ndërsa sonte nuk kalon askush i denjë.

Nën këto mendime të shqetësuara hapat e tij gjatë zbritjes së dishezës ishin shpejtuar, aq sa disa herë iu duk sikur do të ngatërrohej me këmbët e veta. Dëshironte që kur të dilte në rrugë të shihte njerëz e të dëgjonte zëra që t'i jepnin të drejtë zemërimit të tij, dhe të kënaqej në miratimin prej tyre të besimit se jetesa në Bjeshkë mund të vazhdonte e pandryshuar, siç kishte qenë gjithnjë. Por sa më shumë zbriste, aq më tepër i dukej sikur gjithçka përreth po i largohej më shumë asaj që shpresonte. Vetëm zhurmat e makinave që kalonin përgjatë Autostradës së Veriut e nxorrën atë nga përhumbja. Nuk mund të ndjente veçse zhgënjim ndërsa i vështronte njerëzit duke ikur ashtu.

- Epo kjo nuk duhet toleruar aspak. - tha me vete.

Ndërsa ecte nën mbikalimin e autostradës, shtrëngonte fort duart në grusht brenda xhëpave të xhakëtës. Një betim i heshtur, i rëndë si gurët e maleve, gatitej në gjoks të tij. Ai do ta mbronte vetë kanunin, do t'i mbronte ato zakone me çdo kusht, duke filluar nga vatra e tij, përmes gjakut dhe familjes së vet.

Nëse bota jashtë kishte ndërmend të thërrmohej e të harronte se kush ishte, ai do të bëhej mburoja e asaj që kishte shpëtuar aq gjatë. Tekefundit, njerëzit e anëve të tij kishin jetuar në atë mënyrë prej shekujsh. Kishin mbijetuar përmes asaj rregullsie të rreptë e të lashtë, dhe nuk kishte asnjë arsye në botë pse kjo të ndalonte tani, sidomos kur përtej kufirit dikush kërkonte t'u vidhte mënyrën e jetesës.

II.

Të lodhur, ata vazhdonin të ngjisnin me vështirësi shtegun e pjerrët, i cili prej kohësh u dukej i pafundëm. Herë pas here Oresti vështronte shqetësueshëm fytyrën e së motrës. Ajo i dukej tepër e zbehtë dhe e përhumbur. Priste me padurim diçka prej saj, sa edhe të mundej të qetësonte veten, por ajo nuk jepte asgjë. Madje, prej një kohe të gjatë as nuk e vështronte në sy kur shkëmbenin fjalë.

- Elektër, shiko atje tutje. - i tha vëllai me zë të ulët, ndërsa i shkundte krahun.

Larg dallonte një hije e cila ishte duke ardhur në drejtimin e tyre.

- Malësor ky, apo jo? - pyeti mekanikisht Elektra.

- Po. - u kthye Oresti gëzueshëm.

Ky do të ishte malësori i parë që do të

shihnin gjatë rrugës së tyre. Sa më shumë dy palët i afroreshin njëra-tjetrës, aq herë më të qarta bëheshin edhe tiparet e "malësorit".

- Më duket mua apo është i kollarisur ai? - pyeti e habitur Elektra.

Ajo pamje i dukej aq e ndryshme në krahasim me përshkrimet që i kishte bërë i vëllai.

- Po, ashtu duket. - u përgjigj Oresti, dukshëm i zhgënjyer. - Nga i ka gjetur vallë?

Nuk e kishte menduar kurrë se do të gjente njerëz të tillë *këtej*. Kur më tutje u dallua një grup djemsh të rinj, të veshur me tuta dhe bluza të thjeshta, ndonëse u shtir sikur nuk i kishin lënë ndonjë përshtypje, i ndoqi me sy për një kohë të gjatë.

Kishin mbërritur tashmë pranë një mbikalimi. Ndërsa ecnin poshtë tij, Elektra i hidhte sytë nga vëllai. Fytyra e tij kishte marrë një çehre tepër të zymtë, gjë që e shqetësonte. Për ta larguar mendjen prej saj, u përpoq të mendonte për gjëra më të gëzueshme.

*

Leka qëndronte i shtrirë mbi divan, në pritje të përgatitjes së darkës. Nga kuzhina dëgjoheshin tashmë vetëm zhurmët e shapakave të gruas dhe vajzës. Me siguri do të jenë duke shtruar tryezën, mendoi. Duke qenë burri i vetëm i shtëpisë, i kushtonte mjaft vëmendje gjërave që ndodhnin brenda saj. Aq sa kishte mësuar të dallonte edhe ndryshimet midis hapave të Lirisë dhe Besianës. E para, e lodhur nga mosha, ecte ngadalë, dhe me hapa tepër të vegjël, ndërsa e dyta, vajza e tij e re, ecte me hapa të shpejtë, gati-gati në të kërcyer.

Ja, është duke u afruar Besiana, me siguri për darkën, mendoi ai, duke dëgjuar me vëmendje hapat, të cilët sonte i dukeshin edhe më të lirshëm se zakonisht.

- Është shtruar darka baba. - i tha ajo.

- Shumë mirë! Ja se do të vi.

Ai u ngrit në këmbë, dhe me hapa të lëkundur nga mpirja e këmbëve, u nis drejt kuzhinës.

Ndërsa ushqeheshin, e ndjente se të dyja ja hidhnin sytë shpesh reagimeve të tij, ndaj përpiquej të përmbante sa më shumë veten.

- Baba... - filloi Besjana.

Ja, për këto fjalë mund të kenë pritur gjithë mbrëmjen, tha me vete ai, tashmë i kredhur në mendime.

- Lekë! - u dëgjua më pas zëri i gruas, i cili edhe e nxori nga përhumbja.

- Po? - u përgjigj më në fund ai.

- Besjana dëshironte t'ju thoshte diçka. Thuaja, Besjana.

- Atëhere baba, - nisi tërë ndrojtje vajza e re. - disa shoqe dhe shokë nga shkolla do të dalin pas disa ditësh në qytet, a mundem dhe unë të shkoj me ta?...

Po ja si qenka puna, nisi të mendonte sërish ai, ajo dashka të na hedhë në baltë gjithashtu! I dukej sikur tashmë ajo "murtajë e re e moderizimit" po përpiquej të depërtonte dhe brenda gjakut të tij. *Kjo nuk duhej lejuar aspak.*

- Jo! - u përgjigj me zë të lartë Leka, duke ndërprerë fjalën e vajzës. Më pas vazhdoi duke bërtitur:

- Ti jo vetëm nuk ke për të shkuar asgjëkundi me *shokë* që ne s'i njohim! Por as edhe ke arsye për të shkuar më në qytet!

- O Zot! - murmuriti Liria, dhe u lëkund aq shumë sa i ra edhe luga nga dora.

- Kjo vlen edhe për ty grua!...

- O Zot! - murmuriti ajo sërish

-...sepse kjo punë fundja nuk mund të bëhet kurrësesi pa kujdesin e burrit! - vijonte ende ai.

Pasi kishte pushuar së foluri, kudo mbizotëronte një atmosferë mbyhtëse, dhe askush nuk ndihej sikur mund të merrte dot frymë rehat brenda asaj dhome. Gruaja nisi të mblidhte pjatat për tu shpërqëndruar, vajza u turr drejt dhomës së saj për të qarë, ndërsa Leka u kthye sërish tek divani i tij për tu shtrirë. Askush nuk do të donte t'i rikthehej atij momenti, por secili prej tyre e ndjente se diçka kishte ndryshuar përgjithnjë.

Papritur, u dëgjua disa të trokitura në portë. Prej gjendjes së krijuar brenda shtëpisë, asnjëra prej grave nuk dëshironte të kalonte përmes dhomës së ndenjes ku ndodhej Leka. Trokitjet ende vazhdonin, shoqëruara nga pas me disa fjalë, të cilat prej largësisë bëheshin të pakuptueshme. I acaruar ngaqë i duhej të linte

pas rehatinë e krijuar, Leka u ngrit dhe doli vetë tek porta e jashtme. Ishte errur dhe bënte tepër ftohtë. Më tu afruar, fjalët e njeriut prapa portës bëheshin gjithnjë e më të qarta.

- A pret miq o i zoti i shtëpisë?

Fytyra e Lekës mori menjëherë një pamje të gëzueshme. Ishte një zë i huaj, dukshëm jo prej atyre anëve, i cili kërkonte strehë. Me siguri kërkon ta bëjë si në kohët e vjetra, ndonëse nuk i njeh mirë ato, mendoi Leka. Zellshëm, i hapi derën.

- Pa thuaje edhe një herë more djalë se më kënaqe shpirtin!

Pas portës ishin dy të rinj, një djalë dhe një vajzë. Errësira nuk lejonte dukjen e qartë të tipareve të tyre, por ai arriti të dallonte menjëherë se ata ishin vëlla e motër.

- A pret miq o i zoti i shtëpisë? - pyeti sërish Oresti, këtë herë me më shumë ndrojtje.

- Po, sigurisht! E jani e jani. - u përgjigj Leka, gati me një frymë.

Pasi të dy u futën në oborr dhe i zoti i shtëpisë e mbylli derën pas tyre, ai eci sërish përpara dhe e thirri gruan nga pragu i derës.

- Grua! Sot presim miq. Shtroje dhe një herë tryezën!

Duke mos u besuar veshëve për atë që po dëgjonte, në fillim hezitoi. Më pas, kur u dëgjuan për herë të dytë po të njëjtat fjalë, doli me hapa të pasigurtë drejt dhomës së ndenjes për të pritur "miqtë". Obobo ky paska shkalluar, mendonte ajo, dhe dashka të na kthejë si nëpër kohët e vjetëra...

Drita pulsuese mbi korridor i jepte Orestit përshtypjen e një kohe të shkuar.

- Këtej, - tha i zoti i shtëpisë për të disatën herë, ndërsa përpiquej të mënjanohej për ti lënë më shumë hapsirë miqve. - Ja, këtu brenda.

Pa u ndezur ende drita e dhomës, brenda saj dallonte një tablo, në qendër të së cilës ndodhej një burrë me mjekër e përkrenare me brirë, duke drejtuar një ushtri të tërë në betejë. Ky duket si djalli vetë, mendoi Elektra, e tmerruar, dhe padashur i shpëtoi një zë. Ajo pa sytë e Orestit që u kthyen zemërueshëm drejt saj.

- Ja të ndezim dritat. - filloi sërish Leka, i pavëmendshëm. - Prisi pak këtu sa të vi e tu sjell edhe rrobat.

- Ç'pate? - pyeti Oresti me zë të ulët, pas një çasti heshtje mes tyre.

- Nuk e di. - u përgjigj Elektra. - Ajo tablo atje më tmerroi.

Oresti mori frymë thellë.

- Dëgjo, - nisi ai. - ne këtu jemi në shtëpinë tonë. Dhe për më tepër, as që besoj se do të duket në gjithë atë errësirë nën të cilën ne do të flemë. Mbase mund të shtremi sikur nuk e shohim fare...

Asaj i ishte bërë e dukshme se vëllai nuk kishte ndërmend ta qetësonte. Fjalët e tij nuk i vinin veçse si tentativa për të justifikuar vendin ku kishin zgjedhur të qëndronin. Vetëm kthimi i të zotit të shtëpisë i dha qetësinë që i duhej të merrte veten.

Ndërsa Oresti fliste me Lekën, vështrimi i saj ishte ndalur diku jashtë dritares. Atje ndodhej një grumbull gurësh në formën e një muri. E çuditshme vërtet, kujt mund ti ketë shkuar mendja të ndërtojë në një vend kaq të humbur, nisi të arsyetonte Elektra. Padyshim që do e kenë kuptuar se ky vend kaq i humbur nuk vlen për asgjë, prandaj duhet ta kenë braktisur.

Nga vendi ku qëndronte, mund të dallonte përmes pasqyrimin dritares edhe hijen e Orestit, i cili pasi kishte përfunduar së foluri me Lekën, ishte shtrirë dhe kishte ndezur një cigare. Ajo pamje e la të ngrirë në vend. I vëllai nuk kishte pirë kurrë më parë.

III.

Ndonëse nuk kishte asnjë mënyrë për të parë sa ishte ora, Elektra ishte e bindur se duhej të kishte kaluar mesnata. Gjumi nuk i vinte aspak, dhe sa herë që tentonte të mbyllte sytë, një vargan mendimesh të shqetësuara ja hapte sërish. Ajo e kuptonte se çdogjë i vinte prej asaj pikturë "djallëzore", e cila edhe pas shuajtjes së dritave, kundër fjalëve të vëllait dhe shpresave të saj, nuk ishte zhdukur. Një dritë fare e dobët, e cila hynte përmes dritares nga e cila dukej muri me gurë, e ndriçonte atë. Ajo përpiquej të arsyetonte se mos vallë kishte një lidhje midis burrit me brirë dhe gurëve, por mendohej kot. Gjendja e saj dhe të qenurit përballë pikturës

nuk e lejonin të mendonte kthjellët.

Për tu shpërqëndruar, kthehej nga Oresti, por as kjo nuk e ndihmonte. Atë e kishte zënë gjumi me kohë dhe fare lehtë, duke e lënë motrën të ndihej tërësisht e vetmuar. Braktisur nën mëshirën e djallit të ndriçuar. Në këtë pikë ajo mbyllte sytë sërish, kthehej në anën e kundërt, pra sërish atë të pikturës, dhe pas mendimeve të shumta, ky cikël torturues i niste sërish.

Kërkonte një shpëtim prej tij, i cili nuk mund të merrej veçse si një kërkesë për tu larguar sa më parë prej atij vendi, i cili kah shpirtit, po i merrte edhe vëllain. Mbase duke ja mbushur mendjen për tu larguar mund ta shpëtonte edhe atë...ta kthehte si më parë, i mbushi mendjen vetes Elektra...

*

Pikërisht ndër çastet kur Lekës po i mbylleshin sytë, nga ekrani u dëgjuan fare dobët fjalët: ... *njëzetvjeçari Orest A., ka qëlluar për vdekje me pushkë bashkëqytetarin...*

- Ti më ke sjellë mua vrasës në shtëpi! - ju drejtua menjëherë e tmerruar Liria.

Ato fjalë i ranë si një goditje e befte. U përpoq të përmendej duke shkundur kokën lehtë, sikur donte të largonte mjegullën e mendimeve që e kishte mbështjellë. Zhurmat e dhomës u bënë më të qarta, ndërsa vështrimi iu ngul në ekran. Dalëngadalë, fjalët e lajmit nisën të merrnin kuptim.

Pranë mbishkrimin të tij ishte shfaqur fotografia e një djali të ri, e cila e bëri të ngrinte në vend. Sytë tashmë i ishin hapur plotësisht, zemra i rrihte fort nën kraharor, dhe një ndjenjë krenarie e kishte pushtuar të tërin. Në ekran ndodhej ai, djali që porsa kishte pranuar si mik në shtëpinë e tij.

- Hël! Thuaj diçka, dreqi ta marrë! Përse e bërë? - vazhonte ajo mes lotëve.

- E bëra sepse ishte gjëja e duhur! - u kthye Leka ashpërsisht. - Dhe për më tepër, kjo nuk tregon gjë tjetër veçse fisnikërinë e tij.

- Po ai është vrasës!...

Pas këtij shpërthimi, gjithë fjalët pasuese të Lirisë i vinin turbull. Mëvetësisht të pakuptueshme, por me një mesazh të qartë, të vetëm: *Ti, Lekë, burri i shtëpisë, në këtë kohë të re je i humbur! Pranoje, dhe ndiq shembullin e gruas tënde, pasi ajo kohë që ti ëndërron nuk ka për tu dukur kurrë më!*

- Pusho! - e ndërpreu ai drejt fundit. - Nuk të jep kush të drejtën ty të flasësh ose vendosësh mbi mua!

Ndërkaq ishte afruar aq pranë fytyrës së saj, sa Liria mund të ndiente qartë erën e rëndë të alkoolit që i dilte prej gojës. Mbushur me frikë, ajo mbuloi menjëherë fytyrën.

Disa zhurma prej asaj që ndodhi më pas u dëgjuan edhe në dhomën e Besjanës, por fatmirësisht jo aq sa për ta zgjuar atë.

IV.

Ndërsa ecte drejt dhomës së miqve, Liria përpiquej të tregonte kujdesin më të madh për të mos u dëgjuar. Prej zërave që vinin nga kati i përdheshëm, kuptohej se Leka me Orestin tashmë ishin zgjuar. Nuk kishte një kohë më të

mirë për tu parë vetëm për vetëm me Elektrën.

Ajo hyri në dhomë ngadalë, pa trokitur, vetëm për ta gjetur vajzën e re syhapur duke vështruar tavanin. Me siguri që ajo do të kishte reaguar, edhe unë do të kisha trokitur, sikur të dyja të kishim fjetur sadopak gjumë, mendoi.

Pa thënë ende asgjë, iu afrua krevatit, dhe duke rënë në gjunjë, me kokën mbështetur ndaj këmbëve të saj, nisi të qante. Elektra, duke ndërë lëkundjet e trupit të tjetrës, menjëherë u avit për ta përqafuar.

- Dëgjo, - nisi ti fliste Liria. - Unë nuk kam asgjë kundër teje. Dua vetëm të kuptosh se unë e kam të pamundur të vazhdoj kështu. Do të më duhet të kontaktoj policinë. Prandaj, të lutem, largohu, shpëto dhe mos u kthe më.

Ndonëse nuk merrte vesh asgjë prej fjalëve të Lirisë, ajo i ndjente ato. Në gjuhën e saj vendase i tha se e kuptonte dhe e falenderoi.

Pas një qëndrese të gjatë ashtu, Liria u largua me ngut dhe Elektra u mat të rregullonte dhomën ku i vëllai kishte fjetur.

- A e di ti o Elektër, - kishte nisur ti fliste i vëllai disa orë më pas, kur ishte kthyer nga një shëtitje me Lekën. - se është ai mur me gurë atje jashtë?

Qysh në çastin që kishte kaluar pragun e derës, Elektra sipikati në të për herë të dytë aromën e duhanit.

- Të pyes sepse kam vënë re që e shikon shpesh... - vazhonte Oresti.

Në ato çaste ajo as që dëshironte ta shihte me sy, ndaj për t'ju shmangur i qëndronte e shtrirë me kurris.

- Epo, ajo është një muranë. Pra, një grumbull gurësh i cili vendoset në vendin ku është vrasë një njeri. Po ma tregonte Leka sot. A s'të duket e llahtarshme? Ha ha. - pyeti ai, me një qeshur e cila Elektrës i dukej e sforuar.

- Orest! - ju kthye ajo befasisht.

- Po?

- Nuk mund t'ia dal dot më këtu. Bën mirë të largohemi.

- Çfarë!

Lotët që më parë nuk e kishin lënë të shprehej siç duhej nuk e pengonin më. Megjithatë, ngutja për të nxjerrë gjithçka përnjëherësh bëri që arsyet e saj të ngatërroheshin me bringat e vjetra, duke u shkrirë në një rrëmujë fjalësh të paqarta. Në fund, mes gjithë atij pështjellimi, Oresti arriti të kuptonte vetëm se *ajo që duhej vrasë* ishte mamaja e tyre, Klitemnestra, e jo Egisti.

Menjëherë nisi t'i shpjegonte se kanuni nuk e lejonte një gjë të tillë, por asaj dukej se aq i bënte.

- Pa më thuaj Orest se çdrejtin kërkonte kanuni këtu? - pyeti ajo e mbushur me vrer. - A jemi gjë shqiptar ne?

- Epo në s'jemi shqiptarë atëherë ç'na mbetet të jemi! Sepse ti e di shumë mirë që në vendin tonë jemi në kërkim, dhe se askund tjetër nuk do të na pranoin po ta dinin se kush ishim! - iu kthye ai ashpër.

Me t'i dëgjuar ato fjalë, Elektra ngriu. Mendimet që deri atëherë i vërshonin pandërprerë iu shpërndanë menjëherë prej frikës ndaj vëllait.

- Orest. - u përpoq ajo të fillonte nga e

para, pasi kishte mbledhur sërish veten. Kësaj here zëri i saj vinte më i dobët, dhe i lëkundur gjithashtu.

- Ç'tjetër gjë ka?

- Ata e dinë, Orest. E dinë se kush jemi dhe ç'kemi bërë. - shprehu mundimshëm ajo.

Për habinë e saj, ai u përgjigj se atë gjë e kishte ditur që në mëngjes. Leka vetë i kish thënë dhe e kishte përgëzuar.

- Çfarë?

- Po po. Ma tha që me të parë. Mos u shqetëso, *jemi me njerëzit tanë këtu.*

Njerëzit tanë, përsëriste Elektra me vete, ndërsa i avitej mendimi i hershëm se fati i saj nga kjo pikë e tutje do të ishte i pandashëm nga ai i krimin të vëllait. Nuk mund të bënte gjë tjetër veçse të përloje nën mendimin se mund të ketë qenë vetë ajo përgjegjëse për të.

- Orest. - u përpoq ajo sërish.

- Po?

- Nuk, nuk është vetëm Leka ai që e di.

Fytyrën e Orestit e mbërtheu një shprehje habie, sikur edhe pa folur të ishte duke e pyetur se ç'donte të thoshte me ato fjalë.

- Liria. Ajo erdhi tek unë sot në mëngjes, kur ti me Lekën kishit dalë.

- Edhe?

- Edhe ajo, porsi unë, nuk mundej të duronte më gjatë.

- Ç'ka të bëjë kjo? - pyeti Oresti, tashmë dukshëm i irrituar nga fjalët e së motrës.

- Epo, ajo më shprehu se nëse ne nuk do të largoheshim prej këndeje, do të kontaktonte policinë.

Për një grimë Oresti u lëkund. Më pas, duke i shkëputur sytë prej saj, i tha në formë të prerë:

- Asgjë nuk ka për të bërë.

- Si?...Përse?

Sepse është grua, mendoi Oresti, ndërsa me zë nuk i tha asgjë.

Nga jashtë nisi të dëgjohej një zë i lartë burri, gati në këndim.

- A s'i trembesh atij? - e pyeti Elektra.

I vëllai nuk u përgjigj, por shprehja në fytyrën e tij e tradhtonte. Ajo çka po dëgjonin ishte thirrja për falje e një xhamie, e cila tingëllonte sikur të ishte fare pranë shtëpisë. Asnjërit prej tyre nuk i kujtohej ta kish parë atë përgjatë rrugës, e megjithatë zëri i saj u dukej aq i njohur.

Ishte po i njëjti zë me atë që kishin dëgjuar përpara se të ngjnsin bjeshkët, dhe kur kishin kaluar për herë të parë kufirin gjithashtu. Sikur ti kishte ndjekur nga pas përgjatë gjithë ngjitjes së tyre.

- Po a nuk do të ishte më mirë të largoheshim që të dy? Të shpëtonim, ja, prej atij për shembull?

- Pa pusho edhe ti pa ma hidhëruar zemrën më shumë! - iu kthye i vëllai. - Askund nuk kemi për të shkuar! Na kanë dhënë besën këtu!

Mos, më humbe mua dhe për vete je tretur i tëri, tha me vete Elektra, në të dëgjuar fjalët e fundit të vëllait.

- Si të dëshirosh, Orest. - i tha në fund, pas një grime tjetër heshtje, me zërin e dridhur dhe fytyrën e njomur tërësisht.

V.

Liria nuk i tha asgjë burrit të saj në lidhje me daljen e Besjanës, në mënyrë që ai të mos mundej dot ta ndalonte. Megjithatë, kur kishin nisur përgatitjet e darkës në kuzhinë, mungesa e atyre hapave të shpejtë e të shkujdesur ishte ndërë prej tij menjëherë:

- Ku ndodhet Besjana? - e kishte pyetur Leka gruan e tij, duke e tërhequr me forcë mënjane.

- Në dhomën e saj. - iu përgjigj ajo. - Nuk ndihej mirë për momentin...

Lekës i ranë menjëherë në sy manovrat e saj për t'ju shmangur vështrimin të tij. Ajo është duke më mbajtur fshehur diçka, mendoi.

- Mos të ka shkuar mendja të bësh lojëra me mua? - e pyeti kërcënueshëm, përpara se të nisej vetë drejt dhomës së vajzës.

Liria ndjeu këmbët t'i dridheshin dhe u mat të ulej diku pranë. Por kur pa Elektrën të hynte kokulur, me shpatullat e mbledhura dhe sytë përdhe, diçka iu përmbys brenda. Një valë inati ia përpiu frikën. U ngrit sërish në këmbë menjëherë dhe, bashkë me qëndrueshmërinë, gjeti edhe guximin t'i dilte sërish përballë të shqit.

- Ju të dyja mendoni se mund të bëni lojëra me mua!

- Ule zërin! - i ishte kthyer Liria, nëpër dhëmbë.




Elektra dhe Oresti (1879), John Flaxman

- Pse?
 - Si pse? Kanë për të dëgjuar ata. - tha ajo, duke bërë me shenjë nga Orestit dhe Elektra.
 - Ç'po flasin ata andej? - po pyeste ndërkaq Elektra vëllain.
 - Gjëra të kota. - Orestit përpiquej ta bënte sa më shpërfillës zërin e tij. - Vajza e tyre nuk dëshiron të dalë nga dhoma.
 - Oh. - reagoi e habitur Elektra. Ishte e bindur se e kishte parë Besjanën të largohej nga shtëpia jo shumë kohë më parë.
 Orestit kishte spikatur tashmë vështrimin dyshues të Lekës. Nga frika se mos tërhiqnin më shumë vëmendje të panevojshme, u shkëput ftohtësisht prej motrës dhe i bëri me shenjë atij të uleshin në tavolinë.
 Elektra ndërkohë vërente me bisht të syrit lëvizjet e Lirisë, e cila, sapo vëmendja e të shoqit u shpërqendrua, u nis me kujdes drejt shkallëve. Mbase vajza vërtet nuk kishte dalë prej dhomës së saj, nisi të mendonte.
 - Të falenderoj që më prite. - i tha Liria, duke e nxjerrë nga përhumbja e çastit. - Të lutem, nëse ke dëshirë sigurisht, eja më ndihmo të shtrojmë darkën.
 Teksa nxirrnin gotat e para të rakisë, Elektra mundohej të kuptonte diçka nga biseda në shqip mes Lekës dhe Orestit.
 - Këto ditë që kemi folur, e kam kuptuar mirë qëndrimin tënd ndaj të huajve, por më beso, ka më shumë ngjashmëri midis dy vendeve tona se mendon. - nisi Orestit, sytë e të cilit kërkonin vështrimin e Lekës, në pritje të ndonjë reagimi.
 - Vërtet?

- Posi jo.
 - Ku do të dalësh me këtë? - e pyeti sërish Leka, dukshëm i interesuar.
 - Dua të them se, duke i studiuar të dyja kulturat krah për krah, e kam të pamundur ta shoh kulturën greke si gjë tjetër veçse një zgjatim të asaj shqiptare.
 Pa humbur asnjë çast, i qeshur siç ishte, Leka zgjati dorën drejt gotës dhe më pas ia afroi asaj të Orestit.
 - Për këtë ja vlen ta bësh gëzuar!
 Gotat u përplasën lehtë në ajër. Leka e ktheu rakinë me një frymë, pastaj u përkul përpara dhe kryqëzoi krahët mbi tavolinë.
 - Pa hë. - vazhdoi Leka. - Nga të vjen kjo bindje.
 - Epo, gjithnjë më ka bërë përshtypje diçka. Rrjeta e cila është përdorur prej mamasë time në vrasjen e Agamemnonit, është ruajtur. E kam parë vetë, ja, me këta dy sy... Tani, me sa di unë, populli jonë nuk e ka një traditë të tillë, kurse i juaji po.
 - Po po është e vërtetë. - ndërpreu Leka gëzueshëm. - Ne ruajmë këmishën e të porsavrarit, dhe e varim atë.
 - Pikërisht.
 - Mendohet se kur njollat e gjakut në të marrin ngjyra të tjera, i vrari është duke shfaqur acarimin e tij me vonesën e marrjes së hakut...
 - Më falni që u ndërpres këtu, por gjithnjë kam qënë kureshtar... - foli Orestit me ndrojtje.
 - A është vërtetë aq e besueshme kjo? E them sepse ka edhe faktorë të tjerë, si ata natyrorë, për shembull, që mund të kenë ndikim të ndjeshëm

mbi të, apo jo?
 - Edhe mundet. - tha Leka, më i vrenjtur në fytyrë. - Por në të vërtetë nuk i dihet. Mua më pëlqen të besoj se janë vërtetë ata që na i japin këto shenja. Kështu edhe përshejtohet... procesi.
 Orestit nisi të fliste sërish, por në atë çast, diku jashtë shtëpisë u dëgjuan disa sirena të pazakonshme, dhe të gjithë i hodhën sytë nga dera. Sirenat nuk largoheshin. Përkundrazi, pas pak kohe ato u shoqëruan edhe me disa trokitje të forta.
 - Ç'është kjo kështu? - pyeti Leka, i drejtuar nga gruaja e tij.
 - Nuk e di. - i ishte përgjigjur ajo shkurtimisht. Trokitjet u dëgjuan përsëri, këtë rradhë duke lënë të kuptohet se prapa derës kishte më shumë se një person.
 - O Zot! - klithi Elektra.
 Të gjithë tashmë vështronin reagimin e saj. Liria, duke përfutur prej shpërqendrimit të çastit, shpejtoi të hapte derën. Mos, tha me vete Orestit.
 U dëgjua hapja e zhurmshme e portës, dhe pas saj disa hapa të shpejtë që i aviteshin derës së shtëpisë.
 - Kush jeni ju? - pyeti Leka.
 - Policia. - i ishte përgjigjur me një zë të prerë njëri prej tyre.
 - Jemi thirrur këtu për të arrestuar shtetasin grek Orest A., i shpallur në kërkim, i cili akuzohet për vrasje me dashje. - tha dikush tjetër.
 - Jo! - thirri Leka mërishëm, duke bërë disa hapa përpara drejt efektivit.

U sul drejt policit me të cilin kishte folur, me synimin për ta shtrirë përtokë, mirëpo nuk arriti as ta prekte. Dy efektivë të tjerë u hodhën menjëherë përpara, e kapën nga krahët dhe e përplasën me forcë pas murit. Leka u përpoq të lirohej, duke u përdredhur e duke sharë me zë të lartë, por duart iu mbërthyen pas shpine dhe pas pak sekondash dëgjoji kërcitjen metalike të prangave që iu mbyllën rreth kyçeve.
 Ndërkaq, disa policë të tjerë ishin afruar tek Orestit. Ndryshe nga Leka, ai nuk kishte bërë as përpjekjen më të vogël për të kundërshtuar. Qëndronte i palëvizur në vend, me sytë të ngulur tek toka, sikur njoftimi i sapodëgjuar të mos i kishte sjellë asnjë habi. Kur njëri prej efektivëve i kapi duart, ai i zgjati vetë pas shpine. Prangat iu vunë pa asnjë rezistencë, ndërsa vështrimi i tij kërkoi për një çast Elektrën mes të pranishmëve, përpara se policët ta shtynin drejt derës së jashtme.
 Pasi policia u largua me dy burrat në pranga, Liria dhe Elektra mbetën duke vështruar njëra-tjetrën.
 - Ç'do të bëjmë ne të dyja tani? - e pyeti Elektra, duke u dridhur e tëra.
 - Do të të kthejmë ty në shtëpi. - u përgjigj e përloitur Liria.
 - Por, por unë nuk kam shtëpi. Nuk kam vend ku mund të shkoj.
 - Kthehu tek mamaja jote, e thuaji se ishe ti ajo që kontaktove policinë.
 - Jo! - u kthye me zë të lartë Elektra. - Nuk mundem... A mund të qëndroj këtu me ty?
 - Nuk e di. - i ishte përgjigjur Liria, përpara se të shpërthente duke qarë.



Karikaturë nga Arben Mexsi

Sapo doli nga shtypi libri i poetit Dhimitër Pojanaku titulluar “Gli ultimi dadi” (Zaret e fundit) përkthyer nga poetja dhe përkthyesja e njohur Irma Kurti. Libri mban logon e Shtëpisë botuese “Ukiyoto Publishing”. Në parathënien e shkruar nga Dr. Ardian Christian Kyçyku lexojmë: “Ajo që tek shumica e poetëve të tjerë është thjeshtë mungesë sistemi poetik, – me ravgime të dukshme për ta paraqitur si liri tematike e stilistike, – tek Pojanaku është vepër e hapur. Një zë që nuk mbart fort parasysh gjeografinë, shtypjen e ushtruar nga tekat e historisë, dhe që zgjatet deri në kufijtë e mbramë të shqipes, aty ku rrijnë të ngujuara fjalët e ndaluara dhe hapësirat e këtyre fjalëve.

Pojanaku nuk di të qahet, nuk di të ndërkryhet sipas kanuneve letrare tashmë të mykura, nuk synon të shndërrojë këtë botë të ndërtuar keq, apo të rrënuar mirë. Hidhërimi i tij krejt i veçantë, thelbësisht poetik, e fton lexuesin në fortesën e Poezisë dhe, që brenda saj, i hap një sy nga ku bota mund të shihet vetëm nëpërmjet shpirtit të poetit.”

Përmbledhja poetike “Zaret e fundit” është një himn për dashurinë dhe natyrën, ku elementët natyrorë ndërthuren me ndjenjat njerëzore në mënyrë fluide dhe spontane. Autori, me një stil të thjeshtë dhe të kuptueshëm, arrin të prekë akordet më të thella të shpirtit njerëzor, duke treguar se thellësia e vërtetë nuk kërkon kompleksitet stilistik. Në vargjet e tij, ai u këndon yjeve, trëndafilave të varrezave dhe tulipanëve, duke i personifikuar dhe duke biseduar me ta sikur të ishin qenie njerëzore. Ky personifikim jo vetëm që i sjell në jetë elementët natyrorë, por e fton lexuesin të reflektojë mbi marrëdhënien e tij me natyrën dhe dashurinë që ajo frymëzon.

Vargjet zbulojnë dashurinë romantike, por në to zbulohen gjithashtu edhe tema të rëndësishme jetësore, brishtësitë njerëzore dhe lufta kundër fatit dhe vdekjes. Pojanaku u dedikon vargje rrugëve të heshtura dhe qetësisë në varreza, duke eksploruar dualitetin e ekzistencës: dashurinë për jetën dhe vetëdijen për përkohshmërinë e saj.

Çdo poezi lexohet me një frymë duke lënë një ndjesi bukurie që gjendet tek thjeshtësia dhe thellësia e mendimit. Autori rrok thelbin e poezisë, duke treguar se edhe fjalët më të thjeshta mund të fshehin të vërteta të mëdha. Kjo përmbledhje poetike që tashmë është në duart e lexuesit italian është një reflektim për jetën dhe një udhëtim emocional që e lë lexuesin plot me mbresa dhe ndjesi pozitive.

Poezi nga libri

RRUGËT NATËN

Ti s`ke që s`ke gjumë, më namatisin rrugët mbështetur, varur, te parvazi i dritares,
Vish ç` të veshësh dhe
Dil!
Netëve jemi të vakëta,
Të ftohta si shtretërit në dhomat bosh.
Të harruara jemi,
Si lokalet e plazheve në dimër.
Vish ç` të veshësh dhe
Dil!
Ti s`ke që s`ke gjumë,
Rrëshqit mbi trupin tonë
Si harku mbi violinë,
Atëherë do na e dëgjosh këngën si
Simfoni lumi në prag shirash.

LE STRADE DI NOTTE

Tu non dormi, mi incitano le strade mentre
sto appoggiato
al davanzale della finestra.
Indossa quello che puoi
Ed esci!
Siamo tiepide di notte,
Fredde come i letti nelle stanze vuote.
Siamo lasciate nell'oblio,
Come i locali sulle spiagge d'inverno.
Indossa quello che puoi
Ed Esci!



Tu non hai nemmeno un po' di sonno,
Scivola sul nostro corpo,
Come l'arco sul violino,
E allora ascolterai la nostra canzone,
Come la sinfonia del fiume sulla soglia delle
piogge.

KËRKOJ...

Të mbështetem sonte kërkuj, diku,
Si dita e lodhur lëshohet mbi muzg,
Si mali i zhveshur,
Diellit djegur,
Çlodhet nën hijen e resë.
Për vështrimin e rrëzuar,
Kërkuj një dorë të ngrohtë,
Të ma ngrejë, rrëmbejë e si
Inxhi,
Ta qepë me gaz
Mbi të palltos jakë,

Se nënën, eh nënën,
Nuk e kam.

CERCO...

Vorrei appoggiarmi da qualche parte
stasera,
Come il giorno stanco scende sul
crepuscolo,
Come la montagna nuda,
Bruciata dal sole cocente,
Riposa all'ombra della nuvola.
Per il mio sguardo rattristato,
Sto cercando una tenera mano,
Di ammorbidirlo, afferrarlo
E, come una perla,
Cucirlo con gioia
Sopra il bavero del cappotto.
Perché la mamma... eh,
La mamma,
Non ce l'ho più.

YJEVE QË BIEN

Ku bini kur e zbraz kupa e qiellit
Ku?!

Rënçi në det,
Të shuheni përnjëherë!
Se do jetë tmerr të vdisni ngadalë,
Qielli duke parë.

Nuk e kam.

ALLE STELLE CADENTI

Dove cadete quando il firmamento si
svuota?
Dove!
Se cadeste nel mare,
Vi sareste spente subito!
Sarà orribile morire lentamente,
Contemplando il cielo.

TULIPANI I ZI

Dita vodhi mbrëmë kopshteve të natës një
tulipan të zi.
Në mëngjes e vuri në gjoks
Dhe asnjëherë më parë nuk ish dukur
Aq e bukur,
Aq e djallëzuar

Dhe aq e bardhë!

IL TULIPANO NERO

Ieri sera, il giorno ha rubato nei giardini
notturni
un tulipano nero.
Al mattino se l'è messo sul petto
E non era mai sembrato prima
Così furbo
così bello,

E così bianco!

FLAKËRIMA TË ÇASTIT

Fishekjarrët duan t'u ngajnë yjeve
Dhe shpikin mijëra ngjyra prej inatit.
Por yjet, janë yje!
Nuk kanë nge të shohin flakërima të çastit.

BAGLIORI ISTANTANEI

I fuochi d'artificio vogliono assomigliare
alle stelle
E, per dispetto, inventano migliaia di colori.
Ma le stelle sono stelle!
E di vedere i bagliori istantanei non hanno
tempo.

KUR TË VISH...

Kur të vish këtë herë pranverë,
Të pret ajo gonxhja e kopshtit tim
Që vjet,
Nuk çeli dot.
Ndoshta nga gëzimi i tepërt,
Nga ndonjë dhimbje e vjetër,
Po të pret...
Është ajo gonxhja që rrinte vetëm
në qoshen e djathtë të kopshtit,
Të kujtohet?!

QUANDO ARRIVERAI...

Quando arriverai, primavera, questa volta
Ti aspetta quella gemma del mio giardino
Che non è riuscita a sbocciare
L'anno scorso.
Forse per troppa gioia,
Forse per qualche vecchio dolore,
Ti aspetta...
È quella gemma che rimaneva appartata
Nell'angolo destro del giardino,
Te la ricorderai senz'altro.



Marfa Maksimovna Peshkova është mbesa e shkrimtarit të madh rus Maksim Gorki. Është 94 vjeçe. Jeton e vetmuar dhe me modesti në rrethinat e Moskës; është krejtësisht e hapur për të biseduar, por thuhet nuk ka fare bashkëbisedues. Biseda jonë është për jetën e familjes së saj.

- Një jetë kaq e gjatë... As nuk di nga t'ia filloj...

- Nga gjyshi, sigurisht. Tek ne nuk ka gjë që s'e kanë emërtuar me emrin e Gorkit. A nuk ju duket e çuditshme? Për shembull, të kaloni pranë monumentit në Belorusskaja, nuk ju habit?

- Jam mësuar. Pastaj, monumenti është aq i stërmadh, sa nuk i dallohet as fytyra. Ai nuk është gjyshi im, por njëfarë blloku i madh guri.

- Po gjyshi i vërtetë, si ishte?

- I pëlqente të shëtiste me ne, me mua dhe me Darjën, motrën time më të vogël. Shëtisnim dhe ai na tregonte për fëmijërinë e vet. Tani as vetë nuk e dalloj më se çfarë kam mësuar prej tij dhe çfarë kam lexuar më vonë në librin e tij. Ishin shëtitje të mrekullueshme. Kishin nisur që në Sorrento, ku lindëm unë dhe Dasha. Jetonim atje si një familje e madhe — edhe mamaja me babanë ishin gjithmonë pranë nesh. Shtëpia ndodhej jo larg detit; përreth ishte aq bukur, kishte diell, ngrohtësi dhe gjelbërim. Deri më sot nuk kam arritur ta dua Moskën; shpirti më ka mbetur atje, në Itali.

Që në mëngjes vraponim për t'u larë në det dhe nganjëherë kalonim gjysmën e ditës në plazh. Gjyshi, përkundrazi, rrinte shumicën e kohës në kabinetin e tij të punës. Nuk lejohej ta shqetësonim. Detyra jonë ishte ta thërrisnim për mëngjes dhe për drekë. Dreka shrohej në një orar të caktuar dhe gjyshit nuk i pëlqenin vonesat, prandaj edhe ne duhej të ktheheshim në shtëpi në orën e përpiktë. Unë dhe Darja vraponim në kabinetin e tij dhe i thoshim: «Dreka është shtruar». Të njëjtën gjë bënim edhe në mëngjes, kur e thërrisnim për të ngrënë.

Mbaj mend se, sapo na shihte, afrohej te pasqyra, krihej dhe vetëm pastaj dilte. Kur shkonim ne, ishte gjithmonë i veshur me kostumin e tij të parapëlqyer gri. Në përgjithësi, i pëlqente shumë ajo ngjyrë. Dhe kostumi, me sa duket, ishte aq i rehatshëm, sa e mbante përherë veshur dhe ndërrohej vetëm kur na vinin mysafirë të rëndësishëm. Vetëm mos më pyesni cilët ishin, sepse, sigurisht, nuk më kujtohet; për më tepër, atëherë ata njerëz nuk na interesonin aspak. Zakonisht na largonin dhe na thoshin se gjyshi kishte biseda serioze. Dhe ne gëzoheshim! Kishim jetën dhe lojërat tona.

Jeta ndryshoi rrënjësisht në vitin 1933. U shpërngulëm në Moskë. Unë isha shtatë vjeçe, pikërisht në moshën për të filluar shkollën.

- A jua shpjeguan juve dhe Darjës arsyen e shpërnguljes?

- Na thanë se Josif Visarionoviç Stalini thjesht e kishte ftuar gjyshin të vinte, sepse ai kishte një kohë mjaft të gjatë që qëndronte në Itali. Pastaj ndodhi pikërisht ajo së cilës i druhej aq shumë: nga Bashkimi Sovjetik nuk e lanë më të kthehej në Itali. Në fakt, nuk mund të udhëtonte më askund.

«Përse ju duhet Sorrentoja? Ne kemi Krimenë; do t'ju japim një shtëpi pushimi atje», i thoshin Gorkit. Për jetën e Gorkit në BRSS, më saktë se kushdo është shprehur Romen Rolani, kur në ato vite ishte mysafir te ne, në shtëpinë e pushimit: një ari i lidhur me zinxhir të artë. Pikërisht kështu ishte.

Mendoj se Stalinit i duhej gjyshi në Rusi, që, si të thuash, të bënte punë të mira nga brenda. Të gjithë thoshin gjithashtu se Stalini e kishte shkëputur gjyshin nga Italia dhe e kishte sjellë në Moskë që ai të shkruante një libër për të. Stalini i dërgonte materiale, dokumente arkivore, ndërsa gjyshi nuk i thoshte «jo», por thjesht e zvarriste çështjen. Në fund nuk shkroi asgjë; që në fillim kishte vendosur se nuk do të shkruante për Stalinin.

90-vjetori i vdekjes së Maksim Gorkit (28 mars 1868 - 18 qershor 1936)

KTHIMINË SORRENTO:

Mbesa e Maksim Gorkit mbi Stalinin, gjyshin e saj dhe dashurinë

Teksti: Larisa Maksimova

Por nuk kishte si të mos kthehej në BRSS; ashtu qenë krijuar rrethanat në atë kohë. Dhe ne të gjithë shkuam në Moskë.

Sorrentoja mbeti për mua qyteti i fëmijërisë, një ëndërr e paarrtshme për shumë vite. Munda të kthehesha atje vetëm pas shumë dekadash, si një turist e zakonshme. Nuk më lanë as të shkelja në pragun e shtëpisë sonë. Në atë kohë aty jetonte një familje angleze. Shtëpia u përkiste atyre. Nuk e di se çfarë ka tani atje, por, nëse më ka mbetur ende ndonjë ëndërr, ajo është të kthehem në Sorrento. Thjesht ta shoh gjithçka edhe një herë me sytë e mi.

- A mbani mend nëse, pas shpërnguljes në Moskë, Gorki ishte i dëshpëruar apo i rënduar? Çfarë atmosfere mbizotëronte përgjithësisht në rezidencën në Nikitskaja?

- Mua më dukej i kënaqur dhe gjithmonë me humor të mirë. E rrethonin njerëz interesantë dhe punonte shumë. Kushtet tona të jetesës ishin të mrekullueshme; këtë mund ta shihni edhe sot, po të vizitoni Muzeun Gorki. Qeveria sovjetike tregonte qartazi se nuk kursente asgjë për një klasik rus me famë botërore.

Kujtimi im më i gjallë nga fëmijëria është shkalla prej mermeri dhe llambadari i stërmadh. Ajo shkallë i mahniste të gjithë; skaji i saj valëzohej. Në fillim, unë dhe Darja jetonim në të njëjtën dhomë, por më pas, kur fillova shkollën, secila prej nesh pati dhomën e vet. Unë ngrihesha më herët, ndërsa ajo mund të flinte edhe pak. Na mësonin të luanim në piano dhe secila kishte orarin e vet.

Aty pranë, në krahun tonë të shtëpisë,

ndodhej dhoma ku jetonte kujdestarja jonë gjermane, Magda Aleksandrovna Ginken. Falë saj, unë dhe Darja flisnim mirë gjermanisht. Dhoma ime kishte një ballkon shumë të bukur, që shihte nga Nikitskaja. Pikërisht në atë ballkon dëgjova një ditë nga Svetlana Alilujeva, e bija e Stalinit, fjalët që ma përmbysën tërë jetën.

- Svetlana ishte shoqja juaj e ngushtë?

- Po, mësonim bashkë në shkollë dhe uleshim në të njëjtën bankë.

- Ishte ndonjë shkollë e veçantë?

- Jo, fare e zakonshme. Por, sa për faktin që u bëra shoqe pikërisht me Svetlanën, mendoj se Stalini kishte një synim të vetin. Që përpara se të filloja shkollën, kur Stalini vinte për të vizituar gjyshin, e sillte gjithmonë me vete të bijën dhe na thoshte: «Shkoni, luani!» Qartazi donte që të bëheshim shoqe. Kështu, kur e pashë për herë të parë, nuk kisha filluar ende shkollën; ndërsa miqësia jonë zgjati shumë, deri në largimin e saj nga BRSS-ja.

Më kujtohet madje se si, të vogla, rrinim ulur në ballkon dhe bisedonim. Të rriturit merreshin me punët e tyre, kurse ne flisnim gjatë për gjithfarë gjërash dhe mua më pëlqente shumë ta dëgjoja. Svetlana më dukej shumë e veçantë dhe e konsideroja shumë më të zgjuar se veten. Në të vërtetë, ishte shumë e zgjuar dhe lexonte shumë; dinte tashmë jashtëzakonisht shumë gjëra, prandaj, natyrisht, ishte interesante të rrije me të. Unë dhe Darja kishim jetuar shumë të izoluar kur ishim të vogla, ndërsa prej Svetlanës mësoja një mori gjërash të reja.

Pastaj, në shkollë, nuk mund të ëndërroja shoqe më të mirë. Unë isha shumë e ndrojtur

dhe e heshtur. Kurse Svetlana ishte e spikatur, e guximshme; i pëlqente shumë kur e nxirrnin në dërrasë. Prej andej mund të fliste gjatë e me zë të lartë, pa u ngatërruar dhe pa u turpëruar. I pëlqente t'i mahniste dëgjuesit. Në përgjithësi, Svetlana mësonte mirë, kurse mua mësimet më mundonin. Prandaj kopjoja shpesh prej saj; më jepte përgjigjet fshehurazi dhe më nxirrte jo rrallë nga situata të vështira.

- Ju ftonë në shtëpi?

- Sigurisht, madje dërgonte makinë që të më merrte. Ose shkonim bashkë pas mësimet, në daçën e tyre të afërt apo në Kremlin. Apartamenti i tyre në Kremlin nuk më pëlqente aspak; veçanërisht dëshpëruese ishte pamja nga dritarja mbi sheshin e brendshëm. Edhe në përgjithësi kishte një atmosferë të ftohtë, institucionale. Svetlana nuk e kishte më të ëmën dhe, në ato dhoma të zymta, më vinte veçanërisht keq për të.

Në daçë ishte shumë më mirë. Ja, tani m'u kujtua hera e dytë kur shkova tek ajo në daçë. Dy vajza të vogla: rrimë ulur në heshtje dhe nuk dimë ç't'i themi njëra-tjetrës. Svetlana mbante diçka në duar dhe qepte. E pyeta:

- Çfarë po qep?

M'u përgjigj se po qepte një fustan për kukullën. U habita që ishte i zi. Svetlana tha se po e qepte nga fustani i së ëmës. Pastaj më pyeti:

- Vërtet nuk e di se mamaja ime ka vdekur?

Dhe shpërtheu në dënësë.

- Mua më ka vdekur babai, - i thashë dhe fillova të qaja edhe unë.

Meqë ra fjala, Svetlana e mësoi vetëm gjatë luftës, në Kujbishev, se si kishte vdekur në të vërtetë e ëma. Atje kishte nisur të mësonte anglisht dhe dikush i kishte futur në dorë një revistë amerikane ku kishte një artikull për këtë. Ma ka treguar vetë Svetlana. Në revistë ishte një fotografi e Nadezhda Sergejevna në arkivol dhe shkruhej se kishte vrarë veten. E pyeta nëse e besonte. Svetlana tha një «po» të prerë, megjithëse deri atëherë i kishin thënë se e ëma kishte vdekur pas një operacioni të pasuksesshëm për apendicitin.

- Çfarë bënit zakonisht në daçë?

- Hanin drekë dhe pastaj dilnim për shëtitje.

- Bashkë me Stalinin?

- Epo, ai nuk shëtiste me ne, sepse në atë moshë ende nuk dinim të ecnim ngadalë; më shumë hidheshim e kacavirreshim. Ose shëtisnim me biçikleta. Kurse në drekë, natyrisht, ulej me ne në të njëjtën tryezë.

- Dhe çfarë ndienit?

- Nuk ndieja ndonjë gjë të veçantë. Që ai ishte Stalini e kështu me radhë... Ishte thjesht babai i Svetlanës. Çdo fëmijë ka një baba. Në përgjithësi, më la përshtypje të mirë; bënte shumë shaka dhe dukej qartazi i lumtur që Svetlana më në fund kishte gjetur një shoqe. Ushqimin e sillnin në tryezë dhe thjesht e vendosnin aty. Pastaj i shërbenim vetes.

Stalini ishte me shtat mesatar. E vetmja gjë që më ka mbetur në kujtesë janë sytë e tij, me një ngjyrë të verdhë krejt të pazakontë...

Më kujtohet mirë dita kur vdiq Stalini. Nuk qava, por më vinte shumë keq për Svetlanën. Unë dhe Sergioja ishim në funeral. Svetlana dhe Vasja rrinin pranë arkivolit. U afruam, qëndruam pak...

Meqë ra fjala, në shkollë Svetlana mbante mbiemrin Stalini; ashtu e thërrisnin edhe kur e nxirrnin në dërrasë.

- Çfarë bisede patët me Svetlanën që ndikoi kaq shumë tek ju?

- Kjo ndodhi shumë më vonë, kur ishim rritur. Më kujtohet se më tha: «Eja të dalim në ballkon, dua të flas me ty». Dhe atje Svetlana m'i hapi sytë. Më tha: «Ti shumë gjëra nuk i sheh, shumë gjëra nuk i di. Këtu te ne po ndodhin gjëra të tmerrshme». Të gjitha këto i thoshte me pëshpërimë dhe pastaj shtoi: «Do të doja të largohesha. Vetëm, sigurisht, mos i thuaj askujt; por, po ta marrësh vesh, duhet ta kuptosh pse».



Gjithçka që më tregoi për atë që bëhej në majat e pushtetit dhe për atë që po ndodhte në vend ishte një zbulim për mua. Vërtet nuk dija asgjë të tillë. Por e besova menjëherë. E besoja gjithmonë, sepse ishte i vetmi njeri aq i afërt për mua; për më tepër, asnjë nga të rriturit, natyrisht, nuk fliste me mua për këto tema. Kurse ajo dinte vërtet shumë. Svetlana nuk më kishte gënjyer kurrë dhe nuk ishte njeri që fantazonte. Aq më pak mund të shpikte gjëra të tilla! Mbete e tronditur.

- Kjo bisedë shënoi fundin e miqësisë suaj?

- Jo. Por u larguam paksa nga njëra-tjetra. Nuk isha dakord me atë që po bënte dhe, si të gjithë atëherë, kjo më indinjoi. Po, mendoja se njeriu mund të largohet. Pse jo? Edhe unë ëndërroj të shkoj në Sorrento. Por jo me atë gjendje shpirtërore, jo me aq urrejtje ndaj gjithçkaje që mbetet këtu. Të mallkoje fëmijërinë tënde, rininë, absolutisht gjithçka që kishte qenë...

- Atëherë, çfarë e shkaktoi prishjen përfundimtare?

- Undamë përfundimisht kur ajo u largua. Por pati edhe një histori tjetër personale që e errësoi miqësinë tonë. Në shkollën tonë, një klasë më lart se ne, mësonte Sergo Beria, i biri i Lavrenti Berias. Sergioja ishte shumë i bukur; ishte e pamundur të mos dashuroheshe me të. U pëlqente shumë vajzave dhe, me sa mendoj, edhe Svetlanës.

Por, ndërsa unë, nga ndrojtja, nuk guxoja as të mendoja për ndonjë romancë, aq më pak me Sergon, Svetlana nuk dyshonte se mund të pushtonte këdo. Mirëpo me Sergon nuk i eci. Madje më duket se ai, përkundrazi, nuk e pëlqente, ndonëse nga mirësjellja nuk e tregoi kurrë. Sergioja ishte jashtëzakonisht i edukuar dhe i zgjuar.

Meqë ra fjala, u takuam për herë të parë te Svetlana, në Soçi. Ekziston madje një letër që Svetlana i dërgoi të atit nga Soçi, ku shkruan: «Ti mos eja, pishina nuk është ende gati... Marfa është ulur në një pemë dhe të dërgon të fala».

Sergoja ishte pikërisht ai lloj burri që më pëlqen shumë, por unë nuk shpresoja aspak se ndjenjat e mia mund të ishin të ndërsjella. Prandaj, përfytyroni habinë time kur doli se ai ishte i dashuruar me mua.


- Dhe si u mor vesh kjo? Ai ju foli për dashurinë?

- Po a është patjetër e nevojshme të flasësh? Ka vështrime që e bëjnë fjalën të panevojshme. Ne e ndienim njëri-tjetrin. Dhe kaq. Pas shkollës u martuam. Na lindën dy vajza dhe një djalë. Djali tani jeton në Ukrainë, ndërsa vajzat në Moskë. Kam edhe nipër e mbesa.

Në fillim jetuam mrekullisht, dhe Lavrenti Pavloviçi, edhe Nina Tejmurazovna më adhuronin. Me Sergon udhëtuam shumë. Thjesht hipnim në makinë dhe niseshim drejt detit, ai në timon. Tani, kur kujtoj jetën time, e kujtoj se nuk do të doja të ndryshoja asgjë në të. Ka qenë e larmishme. Sepse ndodh që njeriu ta dijë çdo ditë çfarë do të ndodhë nesër dhe çdo të vijë më pas. Tek unë gjithçka ishte ndryshe. Pati edhe shumë hidhërim, natyrisht. Ishte lufta, evakuimi në Tashkent, arrestimi i Sergos... Shumë gjëra, sigurisht. Por tani, kur kujtoj, ndonjëherë madje më vjen mirë të shtrihem e të sjell ndër mend.

- I kujtoni shpesh prindërit?

- Mamaja ime, në rini, ishte një bukuroshe e famshme moskovite; me babanë u njohën në pistën e patinazhit te Pellgjet e Patriarkut. Ai bëri përpjekje të jashtëzakonshme për ta fituar dhe për ta bindur të shkonte jashtë vendit. Në çastin kur u njoh me babanë, mamaja, në fakt, po bëhej gati të martohej me një njeri tjetër, një pronar të pasur manufakture. Martesa u prish. Por mamaja nuk merrte guxim të shkonte jashtë vendit, ku deri atëherë nuk kishte qenë kurrë. Atëherë babai im, i dashuruar marrëzisht pas saj, iu lut mikeshës së saj, Lidija Shaljapinës, vajzës së Fjodor Shaljapinit, ta bindte mamanë të nisëj.



«Thuaji Nadjës se edhe ti po vjen me ne. Do të jetë shoqëri e madhe, do të shohë botën, do të jetë interesante».

Dhe mamaja pranoi. Meqë ra fjala, bashkë me Lidën, mamaja ëndërronte të luante në skenën e Teatrit Vahtangov; ato njiheshin me Ruben Simonovin dhe madje kishin ndër mend të hynin në studion e tij. Udhëtimi me Gorkët ua ndryshoi të gjitha planet. Në fund, Lida Shaljapina përfundoi në Amerikë, ndërsa mamaja dhe babai u martuan zyrtarisht në Berlin. Në fillim jetuan në Shvarcvald, pastaj shkuan në Çekoslovakia dhe, më në fund, përfunduan në Sorrento.

Atje mamaja u dha pas pikturës. Më pas, për shumë vite, e siguroi jetesën duke pikturuar dhe shitur tablo. Tema e saj ishte rrethi i Gorkit. Siç dihet, pikërisht për mamanë time Anna Ahmatova ka thënë dikur: «Një nga tragjeditë e pashkruara të shekullit të njëzetë është historia me titull "Timosha"». Kështu e quanin mamanë në shtëpi, dhe këtë nofkë ia kishte vënë gjyshi im. Tregonin se një ditë, ajo doli për drekë, hoqi kapelën dhe mysafirët panë se, në vend të gërshetit të zakonshëm, kishte prerje të shkurtër flokësh. Madje flokët i rrinin të ngritura në të gjitha anët.

«Te ne kështu e mbante karrocieri», tha Gorki.

«Vërtet, Timosha fiks», shtoi Maksimi.

Në atë kohë, kështu u drejtoheshin karrocierëve.

Në fëmijëri nuk më ndahej ndjesia se mamaja dhe babai e donin shumë njëri-tjetrin. E dini sa e nevojshme është për një fëmijë ta dijë se mamaja dhe babai do të jenë gjithmonë bashkë? Unë gjithmonë kështu mendoja. Mamaja ishte bukuroshe dhe bashkë ata ishin një çift shumë interesant. Pastaj ndodhi diçka. Nuk e di çfarë, por shumë vite më vonë, Nastja Pyshkalo, një mikeshë e mamasë, më tregoi se, me sa duket, Jagoda ishte dashuruar pas mamasë dhe kishte bërë

gjithçka për ta larguar babanë tim prej saj. Dhe, duhet thënë, ia doli: bashkimi i tyre nisi të shkatërrohej. Mamasë, natyrisht, Jagoda nuk i pëlqente aspak, por, nëse ka qenë ashtu siç tregon Nastja, atëherë ai e arriti qëllimin e vet: i ndau nga babai, në mos formalisht, faktikisht.

Dhe, sigurisht, ndihmoi që babai të sëmurej, megjithëse ai vërtet u ftoh; por se përse mbeti në rrugë, kjo është punë e errët. Babai ishte kthyer nga Jagoda, i cili e thërriste vazhdimisht dhe e dehte... Doli nga makina dhe u drejtua nga parku. U ul në një stol dhe e zuri gjumi. E zgjoi dajda. Xhaketa i rrinte varur më vete. Kjo ndodhi më 2 maj. Babai u sëmur dhe, pak më vonë, vdiq nga pneumonia e dyanshme.

E kam shumë të vështirë të flas për këtë, sepse kujtesa, natyrisht, të tradhton. Unë shkoja në shkollë kur u zhvillua procesi gjyqësor, gjatë të cilit Jagoda dhe Kriučkovi pranuan vrasjen e Gorkit dhe të babait tim. A e besoja këtë? Nuk e di. Stalinit, sigurisht, Maksimi i pengonte, sepse ishte i vetmi që e lidhte gjyshin me botën e jashtme. Të gjitha lidhjet e tjera kontrolloheshin dhe filtroheshin.

Nëse mamanë e mbaj mend shumë mirë, babanë e kujtoj më pak, sepse ai ose merrej me mysafirë, i priste, sillte dikë, përcillte dikë, ose zhvillonte biseda të ndryshme. Pra, ishte gjithmonë me punë, si të thuash. Kurse mamaja më mësonte pikturë, kalonte shumë kohë me mua, sidomos më vonë, kur u rrita. Prej saj mësova shumë gjëra, por i premtova se nuk do t'ia thosha askujt. Për babanë, mamasë nuk i pëlqente të fliste. Mendoj se kjo ishte dhimbja e saj. Përsëriste: «Humbëm Italinë, dashurinë tonë dhe njëri-tjetrin».

Babanë e varrosën në varrezat Novodeviçje, ndërsa gjyshi, pa Maksimin, jetoi vetëm dy vjet; edhe ato vite ishin thjesht ekzistencë fizike. Sa shumë donim që ta varrosnin pranë të birit! Por Stalini tha «jo»:

vetëm te Muri i Kremlinit!

Monumentin e babait tim në varrezat Novodeviçje e bëri Muhina, por ideja i përkiste vetë Gorkit. Pas kokës së babait është një bllok i stërmadh guri, që sikur e shtyp pas tokës. Gorki e konsideronte veten këtë bllok. Po të mos kishte qenë kërkesa që i biri ta ndiqte gjithmonë Gorkin si hije, babai mund ta kishte realizuar veten ndryshe; ishte i talentuar, i zgjuar, interesant...

E kujtoj shumë shpesh jetën tonë me gjyshin. Jo vetëm në Itali, por edhe në daçën në Gorki. Megjithëse as daçë nuk mund ta quash tamam: ishte një shtëpi me kolona dhe dy anekse. Në njërin ishin kuzhina dhe tri dhomat e atyre që shërbenin. Në tjetrin ndodhej tavolina e bilardos dhe dhoma e mysafirëve, në rast se donin të rrinin për të fjetur. Kurse në pjesën qendrore, në katin e dytë, në të djathtë ishte dhoma jonë e fëmijëve, ndërsa në të majtë dy dhomat e gjyshit.

Atëherë, për ndonjë arsye, të gjithëve u pëlqente të mblidhnin kërpudha. Edhe gjyshit i pëlqente. Por zakonisht, deri në çastin kur ai dilte nga shtëpia, të gjitha kërpudhat ishin mbledhur tashmë. Dhe unë me Darjën shpikëm këtë marifet: i mblidhnim kërpudhat që herët në mëngjes dhe pastaj, duke ditur se gjyshi do të bëhej gati nga çasti në çast për të dalë për kërpudha, i vendosnim shpejt e shpejt përgjatë rrugës që ndiqte zakonisht. Pastaj dilnim bashkë me të dhe, si pa të keq, i thoshim:

«Ja, ndoshta duhet parë pak andej. Ndoshta duhet parë pak këtej».

Është e qartë se gjyshi e kuptoi shpejt mashtrimin tonë — kërpudhat nuk ishin futur thellë në tokë — por nuk e jepte veten. Gëzohej bashkë me ne për korrijen e pasur. Ose, më shumë gjasa, thjesht për gëzimin tonë.

- Nga ato që ka shkruar, cilat doni më shumë?

- Sigurisht, i doja tregimet e tij; më interesantet për t'u lexuar ishin të hershmet, ato që zbulonin edhe karakterin e tij, edhe të bënin të kuptoj se kush e rrethonte.

«Në familje nuk ka pasur kurrë kult të ushqimit. Dhe sporti, natyrisht. Ja gjithë sekreti i jetëgjatësisë sime». (M. Peshkova)

Qëndrimi ndaj Gorkit në vendin tonë ka ndryshuar tashmë tri herë. Në fillim e lartësonin dhe e përfshinin në programet shkollë, pastaj e damkosën si shkrimtar bolshevik. Sot po flitet sërish për dhuntinë e tij të madhe letrare. Po ju ç'mendon?

- Unë e konsideroj, para së gjithash, njeri të mirë, sepse ka bërë shumë të mira. Duhet thënë se shumë njerëz në gjendje të dëshpëruar i drejtoheshin atij për ndihmë, shihnin tek ai shpresën e fundit. Dhe ai përpiqej t'i shpëtonte nga arrestimi, nga ndonjë telash i madh; me urdhrin e tij u jepnin diçka ose i dërgonin jashtë vendit.

- Por edhe gjyshen tuaj shumë njerëz e quanin «njeri të shenjtë».

- Ne e quanim babunçik. Gjyshja-babunçik. E kam të vështirë të flas për të; ajo jetonte jetën e vet. Jekaterina Pavlovna jetonte veçmas, kishte apartamentin e saj. Dhe ndoshta e dini se me të jetonte një djalë që quhej David Klyshko. Ishte i braktisur. Në fakt, kishte edhe një vëlla, Mishën, por ai po mbaronte shkollën. Kurse ky kishte mbetur krejt vetëm. Dhe gjyshja e mori pranë vetes; ai jetonte në një dhomë më vete.

Gjyshja ime ka shpëtuar shumë njerëz, shumë. Ajo gjithmonë përpiqej të bënte gjithçka që varej prej saj.

- Duke parë pas, a mund ta quani veten njeri të lumtur?

- Sigurisht që mundem. Jam e lumtur, sepse në jetën time mund të ndodhte gjithçka. Dhe kam parë njerëz të tillë... Si askush tjetër. Njerëz unikë. Kurse sot kam fëmijë dhe nipër e mbesa. Kjo është më e rëndësishmja. Dhe natyrën përreth. Prandaj jetoj shumë bukur, madje. E shihni sa këndshëm e kam këtu?

Enver Kushin e njihja nga shkrimet dhe parë nga larg. Më ndodhi dy herë t' ma kalonte pranë dhe isha unë, që i dhashë të njohur. Herën e tretë e lamë të takoheshim e të pinim një kafe njohje, e cila ia vlente. Në fund më dhuroi tre librat e tij. E prisja të ndodhte kështu. Edhe takimi ynë i shërben njohjes së shpirtave.

1

S'është e lehtë të përfshish tre libra në një shkrim, në rast se nuk të ndihmon dhe autori i tyre, i cili, ndoshta pa e kuptuar dhe vetë, i ka të lidhura me fije të padukshme. Dhe ajo që i lidh të tri librat e Enver Kushit: "Zonja nga Parga"-novelë, "Më Moikomin"-ditar, letra e shkrime dhe "Apokalips 6" në prozë, është nekromantia. Ç'është nekromantia? Vendi ku mund ta flasësh me shpirtat e të parëve të tu, të cilët mund të jenë familjarë, etër shpirtëror, shkrimtarë, etj. "Shko në Nekromantia dhe fol me shpirtat e të parëve të tu."-shkruan autori dhe për të rizgjuar një nga ato qindra histori, që i ruante një e mbijetuara e vitit 1944 niset për në Parga, kur "drita që vinte nga deti, dukej sikur largonte të shkuarën". (Nga Parga e Elena Gjiksës, Kol Idromenos, Mitrush Kutelit.) "Kishte të drejtë një nga kolegët e tij në Athinë, kur i kishte thënë se Epiri dhe qytetet e tij kanë një shpirt tjetër të paprekshëm, që vjen nga thellësia e shekujve dhe ka mbetur i njëjtë deri në ditët tona." Nëse nuk do ekzistonte ky shpirt i mbetur deri në ditët tona s'kishte me kë të flisje në nekromantia.

Në kopshtin e Zonjës nga Parga kishte disa pemë të mbjella nga frutet e të cilave ajo bënte likora dhe limonata, ku tek limoni ishte gjyshi i saj, tek qitro gjyshja, tek nërënxa nuja e saj, tek një tjetër babai, motra, vëllai, nusja. Të gjithë i kishte në kopësht. Gjyshi i saj kishte miq myslimanë, çamë e të krishterë, grekë, vllahë, hebrej, evgjitë jo vetëm në Parga, por një ditë krijohet një çetë, që u thonin partizane e se ata ishin mpleksur me komunistët grekë, për të luftuar gjermanët. Në Gumenicë vrasin Kristo Pitulin. Flitej, se e kishte marrë në mbrojtje agai Hizër Ahmeti, por ai rikthehet në Gumenicë dhe e vrasin. Vëllezërit e tij betohen mbi varr, se do ia merrnin hakun, s' do të linin këmbë çami myslimanë pa i prerë kokën. Nuk e besoj që Pitulin ta kenë vrrarë çamët, thonte gjyshi i zonjës nga Parga, kujton autori. (Në librin "Qyteti dhe krijuesi i tij" shkrimtaria greke Popi Pituli shkruan se Kristo Pituli ia bleu Igumenicën në vitin 1905-1908 Hamdi Beut, gjeneral turk.) Në Parga qarkullonin fjalë: "Do bëhet hataja!" dhe "Dhe ty, moj Adile, të kanë lënë këtu. Pse të kanë lënë, të qashë Pargën?!" Ushtarët e Zervës futen në shtëpi dhe e përdhunojnë. Dhe kur ata e lanë Pargën dhunuesit i vinin shpesh në ëndërr. "Dhe ndjeje se si ulurijne kujtesat e plagosura. Ka ditë që i dëgjoj." Kjo është novela që pasqyron një nga tragjedit çame.

Fol me shpirtat e të parëve të tu

Nga Fatbardh Amursi



2

"Unë, Enver Kushi, rob i bindur i librave dhe i të shkruarit, këtë ditar për Moikom Zeqon, fort të ndritshmin shkrimtar erudit dhe jo vetëm, nisa ta hedh në ca letra të vogla..." e nis ai librin kushtuar mikut të tij, i cili merr formën e plotë në botimin e librit me titull "Me Moikomin"-ditar letra, shkrime. E merr në telefon Thanas Dino dhe i thotë se në Gjirokastër ishin rikthyer një çift lejkësh dhe se në Divjakë u çiftuan 33 lejkë, ndërkohë që poeti bëhej gati t' i bashkohej qiellit. Më parë Moikomi i thotë: "Kiço Blushi këtë sëmundje kishte. E takova paradite. Pimë bashkë kafën, siç bënim përditë. Bëri humor, sic bënte ai. Pasditë pati temperaturë dhe...kështu shkoi... E vetmja gjë që nuk po më lë është kujtesa. Edhe zemrën e kam të fortë.

-Ty nuk të munda i keqja, sepse nuk bëre kompromos me të.-i jep kurajo miku çam.

-Në përgjithësi, me përjashtime të rralla, shkrimtarët dhe intelektualët shqiptarë, kanë qenë dhe janë klientelist. Ah! Migjeni i madh. Ai nuk bëri asnjëherë kompromis.-i shprehet Moikomi. Dhe më tej: "Unë jam djalë partizani, që vdiq i ri nga plagët e

marra në luftë." Këtë çast autori do e shoqëroj me këtë dialog:

-Ti po dridhesh,-tha djali.

-M' u kujtua babai,-tha vajza.

-Më ke treguar,-tha djali.

-Ai kishte tri plagë dhe vdiq me plumba në trup,-tha vajza."

Moikomi i flet shpesh për miqtë: "Petro Çerkezi më ka bërë një nder të madh, duke përkthyer dhe botuar në Greqi një libër timin me poezi.", sikurse në një letër të shkruar më 5 janar 1973: "Letërsia e vërtetë është gjithmonë e shqetësuar. Pse jam gjithmonë i shqetësuar? Gjëja më e pabesueshme sot ishte celja e luleve të mimozave në lulishten e klubit të Lidhjes. Atmosfera letrare është e shqetësuar, ka debate të mëdha, kontradikta." Ndërkohë librin "Dimri i madh" të Kadaresë do e quaj një çudi letrare. "Gjithë këto ditë kam ndjerë peshën e madhe të letërsisë si kurrë ndonjëherë." Nuk mund të bëj përshtypje, që nga Uashingtoni ku Moikomi ndodhej pas viteve '90-të, për ta gëzuar do i shkruajë mikut të tij: "Shuteriqi më shkruante një letër për një takim që pati me ty." Ndërsa autori i librit do shpreh këtë vlerësim: "Që kur u ka hipur kuajve të hazdisur të metaforave, Moikom Zeqo është kalorsi më i madh dhe më i çuditshëm i poezisë shqipe dhe asaj botërore."

Dhe e gjithë kjo miqësi e madhe, do mbyllet më fjalët pikëlluese, kur shkrimtari dergjej në shtrat: "I putha duart dhe dola."

3

"Apokalips 6" është libri i tretë Ai botuar nga Petraq Risto, me redaktor Moikom Zeqon dhe korektore letrare Vllasova Mustën. Dikush i hipur në një pemë i bën atentat mbretit, i cili për të pushuar në det kalonte përmes një pylli, nis proza e parë e tij. Pas pushimit mbretit i duhej të kthehej në kryeqytet, që të ushtronte detyrën. Urdhëroi që pemët në të dy anët e shtegut të priteshin. "Drurët binin një e nga një, duke lëshuar ca "Ah! Ah! Ah!" Mendo sikur ato të ishin dru ahu, të cilat mbreti i kishte mallkuar, duke i kthyer në trungjë, që dukeshin si gërmadha shpirti. Nga trungjet e prera do të vinin të qara burrash.

Në tregimin që pason: disa udhëtarë që do ta fluturonin drejt Tiranës binin në sy për moshën e madhe, mbi 60 vjeç. "Ndoshta shkojnë për të vdekur, mendoi vajza që shërbente tek sporteli i pasaportave." Princi nuk e mbante mend se kur i qe shfaqur aftësia për t' i dalluar ditët nga aroma e tyre. Nga gërmadhat e shpirtit kalohet varrezat e kryeqytetit,



ku me një urdhër qeverie varrezat zhvendosen në periferi. Bëhet fjalë për "Varrin e Bamit". Gjynaf me i luejt të vdekurit, le ta fillojnë me rrugët që janë beterr. Nuk i kanë hije një kryeqytetit me i patë varret në mes të sheshit, duhen çuar në periferi, shfaqen reagimet e para. Kjo histori e kohës së mbretërisë vazhdon dhe kur në pushtet vijnë komunistët. Më parë vjen lajmi: banorët që jetojnë pranë Varrit të Bamit nuk duhet të pijnë ujë nga puset. Thoshin se po rënkonte dheu. Për ustan e puseve, Zenel Lalën, thoshin se ai para se të gërrmonte flinte tërë natën në tokë. Nuk shtronte asgjë. Rrotullohej e rrotulloj në atë vend, vinte veshin në tokë, fliste me veten dhe kur bindej, me të aguar dita e re, thoshte "këtu". Dhe ata e hapnin pusin aty thoshte ai, duke dalë garant, se uji s' ishte i infektuar. Nëse do ishte i ndotur rënkimi i pusit do thoshte "jo". Aty ku do ngrihej pallati parafabrikat, banorët e kateve të para do vuanin nga problemet psiqike. Duke lexuar këto episode, ku dhe të vdekurit s' i lënë rehat m' u kujtua libri i Spiro Kondos "Shqiptarët dhe problemi pellazg", ku shkruan këtë episod të çuditshëm: "Pranë Vlorës ruhet dhe sot një varg gurësh, që quhet Varri i Kadmit. Ky është prijsi i stërlashtë pellazg, që futi në popull alfabetin e parë. Sipas dëshmive të kohës na bëhet e ditur: që, varri i Kadmit, të shpëtohej nga ndonjë dhunim i mundshëm i armiqve të tij, u kall nën shtratin e lumit Vjosë, ujë i të cilit u devijua paraprakisht dhe, më vonë, u rilëshua në shtratin e vet." Klithmën për dhunimin e varreve e ndjejmë dhe tek "Eposi i kreshnikëve", ndaj na duhet Nekromantia, si një nevojë për të folur me shpirtrat e të parëve tanë...



ROLAND GJOZA

Ana Dolce & Gabbana

Tregim



Gjithmonë e më shpesh po dëgjoj se duhet fituar para. Money. Në një qytet me banka si Nju Jorku, me një Wall Street të famshëm, kjo mund të duket e zakonshme, po jo në gojën e një gruaje që unë mendoja se pothuaj i kishte të gjitha. Dhe mbi të gjitha unë e dashuroja.

Të kesh një shtëpi të madhe me kopsht në një lagje të pasur, buzë oqeanit. Të kesh një burrë praktik, aspak xheloz, që të del krahu, tre fëmijë që të sjellin çdo javë në shtëpi nga një dashnore dhe kanë ëndërra të marra e prapsepapë të kërkosh para?

Gjithçka i del e i tepron. Po atëherë pse i duhen kaq shumë para?

Ana, ku do ta kalosh këtë fundjavë?

Jam kaq e ngatërruar me veten sa nuk di çdo të bëj. Pse më pyet?

Instinkti i femrës është i pagabueshëm.

Dua të më kushtosh pak kohë dhe mua, e dashur!

Sigurisht, e di që të kujtoj kur jam bosh?

Ajo dridhet, nuk është kurrë e qetë, rri shumë jashtë nëpër rrugë dhe përherë shton listën e miqve, shtron dreka e darka, ndërron punët për të fituar sa më shumë para.

Shkon kur e kur në Ballkan, në vendin e saj krejt papritur me një avion që e zë dy tre orë përpara, sa për të nuhatur ndonjë aferë me leverdi, siç shprehet duke qeshur, në kohën e zgjedhjeve parlamentare dhe kthehet pas njezetë e katër orëve duke u zhytur sërish në jetën e stuhishme njujorkeze. Burrin e shikon përskithtazi, pa fare vëmendje, ndoshta një herë në muaj, po ai mjaftohet me depozitën e fryrë në bankë, ose dhe ai kështu bën, ndjekin të dy po atë rreth që i kthen sërish te zeroja.

Tre djemtë bëjnë jetën e tyre. Djali i tretë lindi aksidentalisht në kulmin e kësaj etheje për "money." Ia plasën në duar bebisiter-es dhe ia dhanë vrapit nëpër takime.

Tani ajo bëhet gati të marrë policinë se në shtratin bashkëshortor gjen një burrë të huaj, për më tepër, të dehur. Vjen policia dhe konstaton se ai është i shoqi, që ka lënë mjekër, ajo kujtohet, u thotë një "thank you" dhe mendon se është vërtet e trishtueshme kur pikas një të huaj në shtratin e zbrazët prej vitesh.

Pas një kohe u kthye përsëri në shtëpi dhe gjeti një grup djemsh dhe vajzash që po darkonin duke diskutuar për dashurinë. I vështrroi me kujdes dhe më në fund pyeti se përse ndodheshin aty. Ata i thanë se ishin miqtë e Benit dhe ajo i pyeti se kush ishte Beni. Ai i tha "mama" dhe qeshi. Ajo e nervozuar mori në telefon policinë, të cilët

konstatuan se Beni ishte djali i saj i tretë.

Nuk ka kohë. Ajo është vërtet tërheqëse dhe vishet me shumë shije. E bën në këmbë. Në metro në një cep, në park, në një sallon, në banjo, kalon në orgazëm dhe përmendet se është femër dhe ajo punë mbaron vetëm duke i kënaqur instinktin. Kjo e trishton. Po s'ka kohë. Kjo botë ka burra të fuqishëm. Ata e joshin kushdo qofshin, sepse nuk kanë veshur kostume e mbathur këpucë firmato, po "money," që i mbulojnë krejt dhe iu vezullojnë nëpër trup.

Vetëm me mua s'ka bërë gjë. E di që më ndjen, nganjëherë, rrallë, ndoshta vërtet më kërkon, po është një kohë e shkurtër kjo që ikën shpejt harrueshëm.

Ajo është kaq e hutuar kohët e fundit sa i jepet një koti, ngaqë nuk e ka mendjen dhe i duket se ai është mister Xhefri Xhejms, menaxheri i madh i firmës, por kjo nuk e zhgënjën dhe aq shumë, se ajo nuk ka kohë t'i analizojë kaq hollësisht gjërat.

Një natë e gjeta në orë të mira dhe ngjethshëm mendova se ajo femër ngjallte marrëzishëm epsh rrënues. Më dëgjoji deri në fund dhe, asaj perçapjes sime për të shijuar gjërat e vogla të jetës, ku ndoshta fshihet një gëzim i rrallë, ajo iu përgjigj, se i duheshin para, "më duhen shumë para," shqiptoi sikur e nxori këtë zë nga fundi i barkut. Kur e pyeta përse i duheshin kaq shumë para, më tha se kjo s'kishte pikë kuptimi, ato, paratë, s'dilnin kurrë dhe përherë duheshin më shumë. Pastaj sikur u përmend për diçka, më pëshpëriti me një zë të ngjirur përplot epsh; më merr, më çoi ku të dush, i dashur!

Erdhi dhe rasti im më në fund. E dija ku do ta çoja, në një motel të këndshëm me orë. Në makinë më kafshoi dorën, ia bëri, ah, me atë profilin e bukur prej skifteri si në vizatimet egjiptiane dhe, në çast, vijat përvëluese të kurmit të saj që do të më dorëzohej, bënë spikamë nën fustanin e shkurtër dhe bluzën e ngushtë që ishte zbërthyer deri poshtë.

Zgjata dorën dhe ia futa midis shalëve, pastaj ia ngjasha aty thellë duke i shtrënguar e shtrydhur mishin e ardhangët si të një çupke, ia çova më lart te piçka, po kjo ishte e rrezikshme për mua, se vetëm një dorë e mbaja te timoni, ia hoqa shpejt dhe ia futa te gjinjte e vegjël e të fortë.

Kisha kaq kohë që e prisja këtë marrëdhënie të nxehtë, më kishte kërcyer gjaku në kokë, nuk po më durohej gjersa t'ia rrasja dhe ta shtypja nën vete, t'ia bëja disa herë atë punë, të dëgjoja kur të më fliste me një gjuhë banale për gjëra të rëndomta të

seksit, siç ndodh dendur me çdo zuskë, t'ia ndaloja kohën e saj të çmendur në shtratin e paqtë të epshit.

Ajo uli me rrëmbim zinxhirin e pantallonave të mia, nxorri me rrëmbim karin tim të fryrë me ato gishtërinjtë e saj të thatë e të shkathët, e fërkoj fort me fërgëllima ngjethëse, u përku dhe e futi në gojë.

Mbërritëm. U ngjitëm shpejt lart dhe, ndërsa kapërcenim shkallët dy e nga dy, asaj i ra zilja e celularit, ngriu në vend, u ngjesh në një cep dhe nisi të flasë shpejt me një zë tmerrësisht në ethe.

Ai, ai, pëshpëriti, o zot, çfarë shansi, shpejt më çoi në Battery Park, atje më pret..

S'kishte më asgjë nga një femër që pret të bëjë seks, në atë fytyrën e saj të hequr, si pa ngjyrë, të tendosur, të ftohtë, të largët, kishte vetëm ngulmim për të ikur shpejt diku ku e priste ndoshta një fat i madh. Ishte e kotë t'ia hyja një diskutimi me të. Edhe unë vetë ndieva shtendosje të menjëhershme, flashkje e bjerrje dëshpëruese, një mbresë zhgënjyese kaq të hidhur të një seksi të pa bërë me një femër që e dëshiroja prej kohësh dhe që më ishte kthyer në një qëllim ngulmues e gërryes.

Nuk e pashë për një kohë të gjatë. Kishte humbur nëpër valët e Nju Jorkut.

Atëherë ime shoqe ishte kashiere te Dolce & Gabbana dhe Ana shkoi atje të bënte shopping, ngaqë ajo mund t'i zbriste 20 përqind të çmimit. Bleu një qerre me rroba. Iku me celular te veshi, krejt e hutuar pa u përshëndetur me të.

Pas ca kohësh një mik më tha se gruaja i kishte sjellë në shtëpi një thes plot me rroba të reja që mund të kushtonin gjer në pesë mijë dollarë. Patën qenë të Anës, po kur i kish provuar në zyrë i patën dalë nga qejfi dhe i kish hedhur në koshin e plehrave të ndërtesës ku punonte. I kishte hedhur, mik, a të besohet? Gruaja ime i kishte gjetur bashkë me fletë pagesën, teksa ndërronte qeset e koshave, ia kishte çuar në zyrë me një frymë duke menduar se mund të kishte ndodhur ndonjë ngatërresë, por e kishte pritur çuditërisht një sy i veleritur dhe një gjest trushkulës duke ia bërë të qartë se ajo i kishte flakur vetë ato, ngaqë ngjyra e kaltër që kish qenë në modë gjer atëherë kishte ndërruar atë mëngjes fatal me një të verdhë gold të ndritshme. Ishte koha kur asaj i thërrisnin Ana Dolce & Gabbana.


Është zhdukur prap. Thonë se ka shkuar në luftë. Në Afganistan, me një mision të OKB-së. Prej andej ka marrë disa herë në telefon shtëpinë e saj, po nuk i është përgjigjur njeri. Nga puna e kanë hequr. Në Kabul është zhdukur sërish. Misioni është kthyer, ndërsa ajo ka humbur.

Në një emision televiziv të kohëve të fundit flitej me fakte të llahtarshëm se trafiku i bebove nga Afganistani në Amerikë, ia kishte kaluar disa herë atij të hashashit.

Ana u shfaq një mëngjes më e bukur se kurrë, më njohu, ma bëri me dorë, unë nxitova ta takoj, kurioz si gjithmonë për fatin e saj dhe, ndërsa m'u hodh në krahe dhe më puthi duke m'i lënë shpengueshëm e si me tepri të gjitha ato hire sensuale nëpër duar, më pëshpëriti sikur të më pranonte për një takim diskret;

Ku kam qenë? Ti më pyet ku kam qenë gjithë këtë kohë? Ah, s'po fitoj gjë, duhen para, shumë para, miku im!..S'të lënë ujëqirit e Nju Jorkut me kipa në kokë.. Jo, këtu s'fitohet gjë..

Ishte e kotë t'i thoja që të shkonim diku, ose të prisja si atëherë që ajo të kërkonte me epsh të gjeja një vend ku mund të bënim dashuri, sepse ajo ishte bërë vërtet shumë e bukur dhe s'kishte fare kohë. Kjo dukej nga celulari që mbante në dorë, të cilin e kontrollonte vazhdimisht me ngut e lakmi si dhe nga një dritë e çuditshme në sytë e mëdhenj që i digjeshin përplot ethe të egër që, veç prej dashurisë, nuk mund të digjeshin ashtu.



Libri hap botën.

**PANAIRI
I LIBRIT
EDICIONI 26**
17–21 QERSHOR / JUNE
PALLATI I RINISË

**SHOQATA
E BOTUESVE
TË KOSOVËS**
www.panairilibr.it


Republika e Kosovës
MINISTRIA E KULTURËS
RINISË DHE SPORTIT


PRISHTINA


PALLATI
I RINISË